ENTI SHTËTEROR I REVIZIONIT

# RAPORTI VJETOR

PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN
E ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION

## PËR VITIN 2019

PËRMBAJTJE


FJALIM HYRËS I RKSH 3

RRETH ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION 4

MISIONI VIZIONI DHE OBJEKTIVAT 5

TË PUNËSUARIT DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE 6

TEKNOLOGJIA INFORMATIKE 8

RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËROR 9

DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE METODOLOGJIKE 10

BURIMET FINANCIARE 15

AKTIVITETET E REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE 16

REVIZIONE, SUBJEKTE, GJETJE, REKOMANDIME 17

PROKURIMET PUBLIKE
---------
OPINIONET E REVIZORIT 20

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET 22

REKOMANDIME DHE ZBATIMI I TYRE 23

REVIZIONET E KRYERA 25

NJOFTIM PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE 66

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE 2019 67

REFERENDUMI 2019 68

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR 69

KOMUNIKIMI, TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E ESHR-së 72

BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE 74

DOBËSITË SISTEMORE 76




Të nderuar,



Para ju është Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2019, në të cilin i paraqesim rezultatet e punës sonë dhe revizionet e kryera në vitin 2019.

Kemi kënaqësinë të themi se Programi Vjetor për Punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2019 është plotësisht i implementuar edhe përkundër sfidave me të cilat u përball institucioni në tremujorin e fundit të vitit.

Në vitin 2019 u ndërmorën më tepër aktivitete për zhvillimin e mëtutjeshëm të institucionit dhe përmirësimin e proceseve të revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian përmes zbatimit të tvining projektit, të financuar nga fondet evropiane.

Në bashkëpunim me partnerët tanë të tvining projektit dhe ekspertë të shumtë evropianë, morëm rekomandime të rëndësishme për përmirësimin e akteve tona strategjike dhe metodologjike, organizuam trajnime të shumta, stazhim dhe vizita studimore për të përmirësuar aftësitë profesionale të revizorëve tanë dhe njohjen e përvojave evropiane, vendosëm bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mënyrë që të vendoset praktikë e mirë, raportet e revizionit, të jenë lëndë e shqyrtimit të rregullt në seancat parlamentare dhe të marrim mbështetje në zbatimin e rekomandimeve të revizionit.

Në veçanti jemi krenarë që e hapëm institucionin për mediat dhe publikun duke ndërmarrë një qasje strategjike, nëpërmjet hartimit të Strategjisë së Komunikimit të Entit Shtetëror për Revizion, e cila u mbështet me projekt të financuar nga Qeveria Britanike, në mënyrë që media dhe qytetarët të jenë aleatët tanë për të arritur qëllimet tona strategjike në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në përdorimin e mjeteve publike, gjegjësisht përdorimin e mjeteve të tatimpaguesve.

Sa i përket treguesve për punën tonë, me revizionet në vitin 2019 kemi rritur përfshirjen e shpenzimeve të reviduara në raport me mjetet e përgjithshme buxhetore, ndërkaq në mënyrë të konsiderueshme janë përmirësuar treguesit për zbatimin e rekomandimeve të revizionit që sugjeron në faktin se kontributi i Entit Shtetëror të Revizionit në drejtim të forcimit të institucioneve dhe përgjegjësisë menaxheriale, është gjithnjë e më e rëndësishëm në shoqërinë tonë.

Në raportet tona të revizionit, pavarësisht nga lloji dhe objektivat e revizionit, përveç për gjendjet të cilat i konstatojmë te subjektet lëndë e revizionit, vëmë në pah edhe dobësit sistemike, përkatësisht dobësit dhe paqartësit në aktet ligjore në fusha të caktuara. Duke vepruar në bazë të sugjerimeve të dhëna dhe me ndërmarrjen e aktivitete nga autoritetet kompetente për të tejkaluar situatat e përcaktuara, Enti Shtetëror i Revizionit kontribuon në forcimin e sistemit juridik dhe krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të institucioneve tona.

Enti Shtetëror për Revizion, si institucion suprem i revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është anëtar i organizatës evropiane dhe ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit, i cili gjithashtu bashkëpunon edhe me organizata të rëndësishme ndërkombëtare. Së këndejmi vëllim i konsiderueshëm aktivitetesh në vitin 2019 u zhvilluan në planin ndërkombëtar.

Periudhën në vijim, do të vazhdojmë me përkushtim angazhimet tona drejt pavarësisë së plotë kushtetuese, financiare dhe operative të Entit Shtetëror për Revizion, në mënyrë që të forcojmë kapacitetet tona dhe të implementojmë vlerat e kërkuara etike, të bëhemi transparent dhe të bashkëpunojmë me institucionet kompetente, në drejtim të zhvillimit të institucionit tonë, në institucion suprem evropian modern dhe mbrojtjen e mjeteve publike.

Revizori kryesor shtetëror



mr. Maksim Acevski

# RRETH ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION

Enti Shtetëror për Revizion (në tekstin e mëtejmë: ESHR) është institucion suprem i pavarur i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cili për më shumë se 20 vjet ka informuar në mënyrë transparente, në kohë dhe me objektivitet publikun për konstatimet nga revizionet e kryera.

ESHR si revizor i pavarur i jashtëm, kryen revizion në përputhje me standardet e revizionit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), duke aplikuar kualifikime të larta profesionale dhe trajnim të vazhdueshëm për punonjësit që janë vlera thelbësore në punën tonë.

Pavarësia e institucionit është përcaktuar me Ligjin për revizion shtetëror, në të cilin janë rregulluar kompetencat e ESHR-së, është përcaktuar edhe mandati i gjerë në kryerjen e revizioneve të rregullshmërisë dhe të revizioneve të suksesit, me qasje të pakufizuar drejt të gjitha informacioneve, dokumentacion dhe evidencë për kryerjen e revizionit shtetëror. ESHR përcakton në mënyrë të pavarur Programin Vjetor të Punës për secilin vit rrjedhës, vendos në mënyrë të pavarur për temat dhe subjektet që i nënshtrohen revizionit, si dhe për mënyrën, përmbajtjen e raportit për revizionet e kryera, duke kryer funksionin e tij në mënyrë të paanshme dhe pa ndikime të jashtme.

Me këtë Raport vjetor, para së gjithash theksojmë në konstatimet e rëndësishme nga revizionet e kryera, mangësitë në punën e subjekteve që i nënshtruan revizionit, dobësitë e identifikuara në legjislacion, gjendjet aktuale në aplikimin e sistemeve të informacionit, rekomandimet përkatëse të dhëna që paraqesin vlerë të shtuar nga revizioni, e që kanë për qëllim përmirësime në nivelin e duhur në funksionimin e subjekteve. Me Raportin vjetor informojmë edhe për aktivitete dhe nisma të tjera nga funksionimi i ESHR-së, qëllimet tona strategjike, bashkëpunimin me institucionet e tjera të revizionit në nivel ndërkombëtar, bashkëpunimin me mediat dhe natyrisht informimin e publikun.

Së këndejmi ESHR, njihet për vlerat e larta, që janë vendosur në institucion dhe ato do të vazhdojë t›i kultivojë dhe mbi ndërtojë, siç janë: aftësitë profesionale, kryerja e detyrave të punës me përgjegjësi, puna në ekip, ndërgjegjja dhe etika profesionale, si dhe integriteti profesional dhe personal i revizorëve të autorizuar shtetëror dhe revizorëve shtetërorë në kryerjen e funksioneve të tyre në fushën e revizionit shtetëror.



# MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

## Misioni

Enti Shtetëror për Revizion është institucion i lartë i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili ka për qëllim në kohë dhe në mënyrë objektive të informojë Kuvendin e RMV-së, Qeverinë e RMV-së, bartësit të tjerë të funksioneve publike dhe publikun për konstatimet e revizorit nga revizionet e kryera. Enti Shtetëror për Revizion siguron mbështetjen e Kuvendit të RMV-së në përmbushjen e kompetencave të tij nëpërmjet identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, rasteve të punës së kundërligjshme dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të funksionit. Nëpërmjet rekomandimeve të qarta dhe efektive, ESHR-ja siguron mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesve të mjeteve publike për avancimin e menaxhimit me to. Në këtë mënyrë, ESHR kontribuon në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Vizioni

Për të përmbushur me sukses qëllimin tonë - të kujdesemi për mjetet publike dhe të kontribuojmë në avancimin e menaxhimit të tyre, vizioni ynë është të sigurojmë vazhdimisht cilësi të punës, me çka do të ruanim epitetin e një partneri të pavarur dhe profesional, me integritet të lartë i cili njëkohësisht është edhe bartës i progresit në menaxhimin e mjeteve publike, llogaridhënies dhe transparencën në përdorimin e tyre.

## Q GLLIMET 2018 - 2022

- Rritja e transparencës në përdorimin e mjeteve publike
- Përmirësimi i punës së shfrytëzuesve të mjeteve publike
- Sigurimi i ambientit të përshtatshëm për punë
- Përmirësimi i cilësisë së funksionimit të ESHR përmes trainimit të vazhdueshëm profesional të revizorëve
- Përmirësimi i rezultateve të punës nëpërmjet forcimit të komunikimin dhe bashkëpunimit ndërmjet revizorëve dhe institucioneve

# TË PUNËSUARIT DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE

➢ **Skema organizative dhe struktura e të punësuarve**




Vendet e punës të plotësuara









- **Përfaqësimi etnik**




- **Përfaqësimi gjinor**




- **Struktura e moshës së të punësuarve**



## TEKNOLOGJIA INFORMATIKE

Zhvillimi dhe përdorimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi racional dhe efikas i tij në revizion, janë pjesë e qëllimeve strategjike të ESHR-së. Prandaj, ESHR monitoron në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e teknologjisë informatike dhe bazuar në analizën aktuale dhe përvojat e mëparshme, rregullisht investon në azhurnimin e teknologjisë informatike, me qëllim revizionet të kryhen pa pengesa.

Është siguruar funksionimi pa ndërprerje i infrastrukturës së sistemit informatik dhe sistemeve të implementuara për ruajtje të centralizuar dhe shkëmbim të të dhënave, me vëmendje të veçantë mbi shërbimet dhe proceset kryesore, siç janë posta elektronike, funksionimi i arkivit, sistemi informativ i integruar financiar, sistemi i analizës së të dhënave nga raportet e revizionit dhe Sistemi për Menaxhim me Procesin e Revizionit (Audit Management System (AMS)). Sistemet dhe aplikacionet janë zhvilluar duke u kujdesur për parimet dhe rregullat për: aksesin në të dhënat për përdoruesit e autorizuar, konfidencialitetin, integritetin, ruajtjen e sigurt të të dhënave në një vendndodhje qendrore, harmonizim me ligjet, kopjimi i rregullt rezervë (backup), mbrojtjen nga qasja fizike dhe logjike në të dhënat.

АЗР
AUDIT MANAGEMENT SYSTEM
СОФТВЕР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО РЕВИЗИЈАТА

Sipas strategjisë së TI-së në vitin 2019 janë kryer dhe realizuar prokurime të programeve të specializuara softuer për antivirus dhe bekap mbrojtje, bazuar në analizat e kryera paraprakisht, në lidhje me nevojën për zgjidhje përkatëse softuerike, si dhe për përcaktimin e qartë të karakteristikave të tyre teknike dhe verifikimin dhe unifikimin e sistemit operativ, të të gjitha stacioneve të punës, që i përdorin të punësuarit.

Për kryerjen e papenguar të aktiviteteve të revizionit, për secilin ekip të revizionit janë siguruar: internet qasje nga celulari, i pavarur nga kushtet e subjektit, pajisje portative për sigurimin digjital të provave, si dhe qasje të pandërprerë dhe të sigurt të VPN në sistemin e informatik të ESHR. Revizorët përdorin teknika të mbështetura kompjuterike të revizionit (CAAT›s) gjatë procesit të revizionit, ndërsa revizorët në Sektorin e revizionit të sistemeve të informacionit përdorin gjithashtu softuerin IDEA për të analizuar të dhënat nga të cilat gjenerohen raportet financiare dhe për zgjedhjen e mostrës për nevojat e procesit të revizionit.

Përdorimi i teknologjisë informatike, veçanërisht në revizionin shtetëror, bazohet në monitorimin e vazhdueshëm të Politikës së Sigurisë së Sistemit Informatik të Entit Shtetëror për Revizion, si dhe në procedurat e aplikuara për TI të sigurt dhe procedurat e TI për zbatimin e Sistemit për Menaxhim me Procesin e Revizionit (AMS). Ato i nënshtrohen analizës vjetore në mënyrë që gjithmonë të jenë në hap me zgjidhjet e reja në këtë fushë.

## RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËROR

ESHR-ja si institucion i lartë i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një nga prioritetet e saj strategjike, gjithmonë ka kapacitetet e revizorëve shtetëror dhe përsosjen e tyre profesionale.

Në pajtim me «Planin Vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional në vitin 2019», u mbajt një trajnim me temë: Hyrje në revizionin shtetëror si profesion në Republikën e Maqedonisë, legjislacioni, zhvillimi i revizionit shtetëror, subjekt i revizionit shtetëror, hyrje në INTOSAI kërkesat profesionale, standardet e punës dhe Kodi i Etikës dhe llojet e revizioneve. Trajnimi ishte i dedikuar për revizorët shtetërorë me statusin e revizorëve më të rinj, grup i synuar prej 21 të punësuar dhe punësuar në sektorët për ndihmë administrative, të cilët u pajisën me certifikata për nivelin e trajnimit të përfunduar me sukses.

Gjatë vitit 2019, vazhduam të implementojmë disa tema të reja me qëllim të realizimit të Planit Vjetor për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe trajnime të ESHR-së, për vitin 2019. Temat e këtij sesioni ishin Bazat e Konceptit INTOSAI dhe Kodi i Etikës, njoftim me konceptin e kontrollit të cilësisë dhe sigurimin e cilësisë - si të përmirësohet hartimi, përkatësisht përpilimi i Raporti të revizionit, për sa i përket konceptit, përmbajtjes, përdorimit të gjuhës dhe stilit të shkrimit, me qëllimin e vetëm që revizori përmes raportit të përcjellë mesazh të qartë dhe pa mëdyshje për ata që janë lëndë e revizionit dhe për publikun më të gjerë, në mënyrë që të informojë në lidhje me gjendjet e konstatuara te subjektet juridike të reviduara. Kjo temë përfshiu të gjitha llojet e revizioneve të cilat ESHR i kryen në përputhje me rregullativën ligjore. Gjatë trajnimit, gjithashtu u prezantuan risi në drejtim të mjeteve të avancuara për 3 E (efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet) në revizion.

Trajnimi u realizua dhe ishte dedikuar për të punësuarit në ESHR në nivele dhe tituj të ndryshëm dhe në të morën pjesë 65 persona nga Enti Shtetëror për Revizion.

Në vitin 2019 u mbajt një trajnim dy-ditor në të cilin morën pjesë të punësuarit në ESHR, si dhe të punësuar në Trupin e revizionit për revizionin e instrumentit për ndihmë para aderuese. Grupi i synuar i ESHR-së, përfshiu revizorë shtetëror me titullin revizorë të rinj dhe revizorë. Trajnimi u realizua me një qasje interaktive për temat siç janë: llojet e revizioneve, fazat e revizionit sipas llojeve të revizionit dhe specifikat e llojeve të revizionit.

Gjatë trajnimit, u prezantuan dhe u diskutuan llojet e revizioneve sipas INTOSAI standardeve, si dhe llojet e revizioneve sipas mandatit të cilin e ka ESHR-ja, në pajtim me ligjin. Fazat e revizionit u prezantuan dhe u përpunuan në detaje sipas llojeve të revizioneve, me çka u diskutua edhe për analizën krahasuese të specifikave, ngjashmërive dhe dallimeve midis llojeve të ndryshme të revizioneve nga aspekti metodologjik dhe zbatimit. Disa ushtrime u kryen individualisht dhe në grupe, duke përdorur shembuj nga përvojat e fituara përmes punës praktike.

Trajnimet në vitin 2019 u hartuan dhe u realizuan me pjesëmarrjen e përbashkët dhe kontributin e trajnerëve të brendshëm, të cilët janë revizorë të autorizuar shtetëror, përfshirë një magjistër në fushën e revizionit dhe trainer i certifikuar INTOSAI, një kontabilist i certifikuar dhe një magjistër në fushën e revizionit të TI.

Rritja e njohurive, aftësive dhe kapaciteteve të të punësuarve në ESHR, përveç nëpërmjet burimeve të tyre vetanake, njëkohësisht u relizuar edhe me zbatimin e:

- Tvining projektit të BE-së - Forcimi i mëtejshëm i kapacitetit dhe efikasitetit të Entit Shtetëror për Revizion për kryerjen e revizioneve të jashtme;
- Projektit me Qeverinë Britanike - Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në Maqedoni përmes zbatimit të përmirësuar të rekomandimeve të ESHR-së, të elaboruar me detaje në pikën 6.2. të këtij raporti.

# DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE METODOLOGJIKE




## Strategjia për zhvillimin e ESHR 2018 - 2022

Në Strategjinë për zhvillimin e ESHR-së 2018 - 2022, e cila u miratua në dhjetor të vitit 2017, janë paraqitur angazhimet për promovimin dhe përmirësimin e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Revizionit (ISSAI), për forcimin e pavarësisë dhe integritetin si parakushte për arritjen e profesionalizmit dhe kredibilitetit në punë, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të efekteve të revizioneve të kryera dhe shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të përfshira në raportet e revizionit nga subjektet lëndë e revizionit. Qëllimet strategjike u morën në konsideratë në hartimin e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2019, për realizimin e të cilit, raportojmë në këtë Raport vjetor.

## Metodologjia e revizionit dhe aktivitetet e projektit

Aktivitetet e projektit të ESHR-së i referohen realizimit të dy projekteve të rëndësishme, si më poshtë:

- Tvining projektit të BE-së - Forcimi i mëtejshëm i kapacitetit dhe efikasitetit të Entit Shtetëror për Revizion për kryerjen e revizionit të jashtëm.
- Projektit me Qeverinë Britanike - Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në Maqedoni përmes zbatimit të përmirësuar të rekomandimeve të ESHR-së.

## Tvining projekti i BE-së

Që nga 14 shtatori 2019, Enti Shtetëror për Revizion zbatoi tvining projektin «Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe efikasitetit të Entit Shtetëror për Revizion për kryerjen e revizionit të jashtëm», i financuar me mjete të fondeve të BE-së, i cili filloi në dhjetor të vitit 2017 dhe zgjati 21 muaj.

Tvining partnerët tanë në zbatimin e projektit ishin Enti Nacional i Revizionit të Republikës së Bullgarisë dhe Enti Shtetëror i Revizionit të Republikës së Kroacisë, si dhe ekspertë nga vendet e tjera evropiane dhe Gjykata Evropiane për Revizion që u angazhuan në projekt.

Tvining projekti u realizua në 4 komponenta. Të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara nga tvining projekti, janë zbatuar me sukses. Realizimi i 25 rezultateve të detyrueshme të projektit në përputhje me planin e punës së projektit, së bashku me rezultatet shtesë, rezultuan në arritjen e qëllimeve të projektit.

Zbatimi i rezultateve do të ndihmojë në rritjen e efekteve të projektit, në mënyrë që të përmirësohet puna e revizionit të ESHR-së, në vitet e ardhshme. Për të zbatuar rezultatet e projektit, janë planifikuar aktivitete me tvining projektin e ri të financuar me mjete të BE-së, i cili pritet të fillojë në shtator të vitit 2020.

Rezultatet më domethënëse të aktiviteteve brenda secilës komponentë janë dhënë në paraqitjen grafike më poshtë:





## K 1
## PËRMIRËSIMI I PROCESEVE TË REVIZIONIT NË PAJTIM ME ISSAI

Rekomandime për përmirësimin e proceseve të revizionit në pajtim me ISSAI

Rekomandime për vendosjen e planifikim strategjik të revizioneve në ESHR

Trajnim për planifikim strategjik
(80% e të punësuarve)

Rekomandime për përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për mbikëqyrje mbi financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore

Tryezë e rrumbullakët për revizionin e partive politike dhe fushatave zgjedhore

2 pilot revizione të rregullshmërisë

Stazhim dhe vizita studimore







## K 2
## FUQIZIMI I KAPACITETIT TË ESHR-së PËR REVIZION

Rekomandime për përmirësimin e kapacitetit institucional dhe kadrovik të ESHR-së

Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe plan për trajnime të punonjësve

Trajnime për revizionin e suksesit dhe BE (50% e të punësuarve)
janë zbatuar 4 pilot revizione të suksesit

Konferenca për prezantimin e rezultateve të pilot revizioneve

Trajnim për zbulimin e mashtrimeve dhe keqpërdorimeve

Rekomandime për përmirësimin e kontrollit dhe sigurimin e cilësisë së revizioneve

Stazhim dhe vizita studimore



## FUQIZIMI I MËTEJSHËM I KAPACITETEVE DHE EFIKASITETIT TË ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION PËR KRYERJEN E REVIZIONIT TË JASHTËM





# К 3

### PËRFORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET ESHR DHE KUVENDIT



Rekomandime për zhvillimin e diskutimit cilësor parlamentar për raportet e revizionit

Vlerësimi i nevojave për ngritjen e vetëdijes së
deputetëve për raportet e revizionit

Tryezë e rrumbullakët për bashkëpunimin e ESHR me Kuvendin

Stazhim dhe vizita studimore







# К 4

### PËRMIRËSIM NË MENAXHIMIN ME TI DHE KOMUNIKIME VEBURIMET NJERËZORE



Rekomandime nga vetëvlerësimet e zbatuara të TI sistemeve në ESHR (ITSA)

Rekomandime nga vetëvlerësimet e zbatuara të TI revizionit (ITASA)

Rekomandime për përmirësimin e uebfaqes së ESHR

Rekomandime për përmirësimin e komunikimit të ESHR

## Projekt me Qeverinë e Britanisë

Në kuadër të mbështetjes së reformave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes Fondit për Qeverisje të Mirë të Mbretërisë së Bashkuar, siguroi mbështetje për Entin Shtetëror për Revizion, për zbatimin e projektit „Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në Maqedoni përmes përmisimit të implementimit të rekomandimeve të ESHR".

Projekti, i cili zgjati nga korriku i vitit 2018 deri në mars të vitit 2019, u zbatua me ndihmën e Pricewaterhouse Coopers Macedonia, Westminster Fondacionit për Demokraci, në bashkëpunim me Qendrën për Analizë Ekonomike dhe Institutin për Kërkime të Zhvillimit Social - RESIS, dhe kishte për qëllim përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të ESHR-së, duke vlerësuar dhe forcuar mekanizmat institucionalë për monitorimin e tyre. Kjo do të arrihet përmes prezencës më të madhe në opinion dhe përfshirjes më të madhe të publikut të gjerë dhe palëve të tjera të interesuara në punën e ESHR-së.

Projekti ishte fukususar në tre rezultate kryesore:




Gjatë projektit, u mbajtën një serë takime, intervista, punëtori dhe tmbledhje me stafin e ESHR-së, përfaqësuesit e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorinë Publike dhe Ministrinë e Financave, përfaqësues të mediave dhe organizata të shoqërisë civile për të përforcuar procesin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Enti Shtetëror për Revizion, gjatë të cilave janë përgatitur disa dokumente të rëndësishme: analiza dhe rekomandime për përmirësimin e procesit të revizionit duke përdorur praktikat e mira të fituara nga analiza krahasuese teILR të tjera; Strategjia e komunikimit e ESHR me përfshirjen e të gjithë palëve të interesuara përfshirë publikun / qytetarët; Strategjia për prezantimin e raporteve të thjeshtuara të revizionit për palët e tjera të interesuara.

Në projekt gjithashtu janë përfshirë edhe pesë gazetarë nga media të ndryshme të cilët, me mbështetjen e institucionit tonë, zhvilluan me sukses storje kërkimore bazuar në gjetjet e raporteve të revizionit të Entit Shtetëror për Revizion dhe të njëjtat i publikuan përmes mediave.

# BURIMET FINANCIARE

Në pajtim me Ligjin për revizionin shtetëror, mjetet financiare për punën e Entit Shtetëror për Revizion sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet e nevojshme për punën me propozim të Entit Shtetëror për Revizion i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në pajtim me Ligjin e vitit 2010, mjetet për punën e Entit Shtetëror për Revizion sigurohen vetëm nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.




Buxheti i përgjithshëm në vitin 2019 ishte 99.757 mijë denarë. Nga këto, 93,99% ose 93.757 mijë denarë janë mjete të siguruara nga buxheti themelor i llogarisë (637) dhe 6,01% ose 6.000 mijë denarë nga llogaria e buxhetit themelor (631) të cilat i referohen të ardhurave të arkëtuara nga organet në bazë të revizioneve të kryera para ndryshimeve në Ligjin për revizionin shtetëror në vitin 2010. Plani financiar i aprovuar i llogarisë së buxhetit bazë (637) ishte 86.633 mijë denarë.

Në periudhën raportuese nga llogaria e buxhetit themelor (637) janë kryer gjithsej shpenzime në shumë prej 85.960 mijë denarë, nga të cilat 69.011 mijë denarë ose 80% kanë të bëjnë me pagat dhe kompensimet për të punësuarit dhe personat e zgjedhur dhe të emëruar, 14.806 mijë denarë ose 17% për mallra dhe shërbimeve, për subvencione dhe transferime janë paguar mjete në shumë prej 989 mijë denarë ose 1%, ndërsa për shpenzime kapitale janë shpenzuar 1.154 mijë denarë ose 1,35%.




Në vitin 2019, në strukturën e shpenzimeve për mallra dhe shërbime pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për rrugë dhe shpenzimet ditore me shumë prej 4.339 mijë denarë, shpenzimet për shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport janë në shumë prej 5.100 mijë denarë, për materiale dhe inventar të imët në shumën prej 764 mijë denarë, për riparime dhe mirëmbajtje në shumën prej 1.862 mijë denarë, shërbime kontraktuale në shumën prej 1.654 mijë denarë dhe shpenzime të tjera rrjedhëse në shumë prej 1.087 mijë denarë. Për shpenzimet për subvencione dhe transferime, shumica e pagesave i referohen transferimeve të ndryshme në vlerë prej 311 mijë denarë dhe pagesa në bazë të dokumenteve ekzekutive në vlerë prej 678 mijë denarë. Ndërsa te shpenzimet kapitale, shpenzimet i referohen blerjes së pajisjeve informatike dhe investimeve në mjete jo financiare.

Në periudhën raportuese, nga llogaria e buxhetit themelor (631) janë shpenzuar gjithsej 6.000 mijë denarë në bazë të dokumenteve ekzekutive për pagimin e pagave për të punësuarit për muajin 10-2019. Në strukturën e të ardhurave të kësaj llogarie janë 6.237 mijë denarë i referohen të hyrave të transferuara të tepërta mbi shpenzimet e vitit të kaluar dhe 313 mijë denarë në bazë të të ardhurave të mbledhura nga vitet e kaluara nga organet për revizionet e kryera para ndryshimeve në Ligjin për revizionin shtetëror në vitin 2010. Teprica e transferuar e të ardhurave dhe shpenzimeve në fund të periudhës raportuese është 550 mijë denarë.

# PROGRAM VJETOR PËR PUNËN
# AKTIVITETET E REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE

**RAPORTET E REVIZORIT PËR REVIZIONIN E RREGULLSHMËRISË**
74

**RAPORTET E REVIZORIT PËR REVIZIONIN E SUKSESIT**
6

**REVIZION I PAJTUESHMËRISË SI LLOJ I VEÇANTË I REVIZIONIT**
5

**REVIZION I ELEMENTËVE SPEÇIFIK, LLOGARIVE DHE ZËRAVE NË RAPORTET FINANCIARE**
3

**FOLOW-UP REVIZIONET**
2

**RAPORTET E REVIZIONIT TË DORËZUAR TE PËRFAQËSUESI LIGJOR I SUBJEKTIT, QË KA QENË LËNDË E REVIZIONIT**
90

**RAPORTET E REVIZIONIT TË DËRGUARA TE PROKURORI PUBLIK I RMV**
3

**RAPORTET E REVIZIONIT TË DËRGUARA TE KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT NË RMV**
1

**SUBJEKTET E PËRFSHIRA ME REVIZIONIN**
174

**RAPORTET E REVIZIONIT TË DËRGUARA TE KUVENDI I RMV**
90

**GJETJET NË RAPORTET E REVIZIONIT**
826

**REKOMANDIMET NË RAPORTET E REVIZIONIT**
498

**SHPENZIMET PUBLIKE TË PËRFSHIRA ME REVIZION (NË MILION DENARË)**
161.586

**TË ARDHURAT PUBLIKE TË PËRFSHIRA ME REVIZION (NË MILION DENARË)**
247.997

## REVIZIONE, SUBJEKTE, GJETJE, REKOMANDIME

Enti Shtetëror për Revizion me Programin Vjetor të Punës, dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara për zgjedhjen e subjekteve dhe temave të revizionit, në nivel vjetor përcakton entitetet dhe fushat ku do të kryhet revizion.

Fushëveprimi i revizionit shtetëror, për sa i përket numrit të subjekteve të reviduara, gjithashtu përfshin subjektet që duhet të revidohen çdo vit, në përputhje me Ligjin.

Në përputhje me kompetencat ligjore dhe kapacitetet e disponueshme, Enti Shtetëror për Revizion në Programin Vjetor për vitin 2019 planifikoi 56 revizione.

Në vitin 2019 janë përfunduar 54 revizione (2018 - 66 revizione), nga të cilat 38 revizione të rregullshmërisë, 5 revizione të pajtueshmërisë si një lloj i veçantë i revizionit, 6 revizione të suksesit, 2 revizione për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve (folow - up revizione) dhe 3 revizione të elementëve specifik, llogarive ose zërave në raportet financiare. Nga gjashtë revizionet e suksesit të përfunduara në vitin 2019, 4 ishin pilot revizione të suksesit në kuadër të tvining projektit të fondeve të BE-së, teknologjisë informatike, realizimit të të diplomuarve në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe prokurimet publike, të cilat përfunduan në vitin 2019, dhe që dukshëm kontribuan në përmirësimin e kapaciteteve të ESHR për kryerjen e revizioneve të suksesit. Në të njëjtën kohë, në vitin 2019, filluan 2 revizione të suksesit, përkatësisht revizioni ndërkombëtar paralel i suksesit në fushën e revizionit të punës dhe revizionit të TI, të cilat do të përfundojnë me zbatimin e Programit Vjetor të Punës për vitin 2020.

Nga revizionet e kryera, janë lëshuar 90 raporte të revizionit (2018 - 117), nga të cilat 74 raporte për revizion të rregullshmërisë, 5 raporte për revizion të kryer të pajtueshmërisë, 6 raporte për revizione të kryera të suksesit, 2 raporte për folow - up revizione të kryera dhe 3 raporte për kryerjen e revizionit të elementëve specifik, llogari dhe zëra në raportet financiare.

Për arritjen e objektivave nga revizionet e kryera, në varësi të asaj nëse kryhet revizion i rregullshmërisë ose revizion i suksesit, gjatë vitit 2019, me revizion janë përfshirë 174 subjekte nga të gjitha revizionet e kryera, që paraqet 70,58% më shumë në krahasim me vitin e kaluar.

Në vitin 2019, Enti Shtetëror për Revizion kreu 38 kontrolle për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up) të lëshuara në vitin 2018 dhe 2019, me qëllim të përcaktimit të shkallës së zbatimit të tyre dhe lëshoi 71 raporte.

Gjatë zbatimit të Programit Vjetor të Punës për vitin 2019, revizorët e autorizuar shtetëror dhe revizorët shtetërorë në raportet e revizionit kanë konstatuar 826 gjetje / gjendje gjatë kryerjes së revizionit shtetëror, edhe atë si vijon:

- 40 gjetje me revizionin e Buxhetit Themelor;
- 600 gjetje me revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë;
- 01 gjetje me revizionin e suksesit ;
- 65 gjetje me revizionin e pajtueshmërisë si një lloj i veçantë i revizionit dhe
- 20 gjetje me revizionin e elementëve të veçantë, llogarive ose zërave në raportet financiare.


Revizion i 174 subjekteve
70,58% më shumë se në vitin 2018
Janë rrevizuar 161,586 milion denarë shpenzime publike ose 12% më shumë shpenzime në krahasim me vitin 2018
Janë revizuar 247.997 milion denarë, të ardhurave publike
Janë lëshuar 90 raporte të revizionit
Janë kryer 38 kontrolle mbi statusin e rekomandimeve dhe janë lëshuar 71 raporte
826 gjetje të konstatuara
498 rekomandime
Revizioni në vitin 2019
Revizioni i suksesit
Bletari
Bashkëpunimi ndërkufitar me R. e Bullgarisë
Prokurimi publik në NP në Shkup
Kuadri me arsim të lartë në tregun e punës
Ndërtimi i sallave sportive
Revizioni i pajtueshmërisë
Buxheti themelor i RMV-së
Pushteti gjyqësor
Avokatia e shtetit
Specializime mjekësore
Revizioni i TI
Sistemi informativ për burimet njerëzore
Revizioni i qëllimeve specifike
FSSHRMV
FSPIM
Banka Popullore e RMV-së
Revizion i rregullshmërisë
Presidenti i Republikës së Maqedonisë
Ministria e Financave
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
Ministria e Ekonomisë
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Enti Shtetëror për Statistikë
Drejtoria për Rezerva të Detyrueshme të Naftës dhe Derivateve të Naftës
Byroja për Zhvillim Rajonal
Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike
IN Muzeu i Luftës së Maqedonisë për Shtetësi dhe Pavarësi - Shkup
Qendra Shtetërore e Provimit
IN Teatri Nacional i Maqedonisë
IN Qendra për Kulturë
Universiteti Nënë Tereza në Shkup
Partitë politike (VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, PP Lëvizja Besa)
Referendum Kuvendi i RMV-së
Zgjedhjet Presidenciale (Komisioni Shtetëror Zgjedhor, Kandidatët presidencialë)
NjVL (Gostivar, Strugë)
SHA Agjencia Informative ieMaqedonisë Shkup
NP Parkingu i Qytetit - Tetovë
SHA Posta - Shkup
SHA - NAV
Agjencia e Planifikimit Hapësinor - Shkup
Agjencia për Supervizion të Sigurimeve
Agjencia për Punësim
ISHP Qendra për Gastro-entero-hepatologji-Shkup
ISHP MB për Neurokirurgji - Shkup
ISHP Spitali i Përgjithshëm - Kavadar
Klinika Universitare e Sëmundjeve Kirurgjikale Shën Naumi i Ohrit-Shkup
Follow up dhe kontrollime
Flota e automjeteve në SHPP
PP PDSH
Follow up dhe kontrollime të raporteve nga PV 2018 dhe 2019
Revizione të transferuara në PV 2020
Shërbime të cilat NjVL –të ju ofrojnë portaleve
Planifikimi i qeverisë për tregun e punës
ISHP Enti për Parandalimin, Trajtim dhe Rehabilitim të Sëmundjeve Kardiovaskulare Ohër


826 gjetje
Revizioni i rregullshmërisë (rishikimi i raporteve financiare me revizion e pajtueshmërisë)
Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
Revizioni i elementeve specifike, llogarive, ose zërat në RF
Revizioni i pajtueshmërisë së Buxhetit themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Revizioni i suksesit
600
65
20
40
101
Gjetjet që lidhen me sistemin e kontrolleve interne
30
Gjetjet në lidhje me pajtueshmërinë me legjislacionin dhe rregullat ligjore
217
Gjetjet në lidhje me raportet financiare
159
Gjetjet në lidhje me përdorimin e fondeve në përputhje me rregulloret ligjore
14
Gjetjet në lidhje me prokurimet publik
35
Theksimi i çështjeve të pavarësisë dhe vazhdimësisë
110
Çështje të tjera
131
Gjetjet në lidhje me TI
1
Përgatitja e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
5
Realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
22
Menaxhimi me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut
1
Gjetje në revizionet e suksesit, në përputhje temën e revizioneve
101
29
151
154
61
14
35
98
119
1
5
5
4
4
4
1
5
22
101

## PROKURIMET PUBLIKE

Revizioni i shfrytëzimit dhe shpenzimit të mjeteve për prokurime publike nga organet kontraktuese në përputhje me Ligjin për prokurimet publike, kryhet nga Enti Shtetëror për Revizion. Gjatë vitit 2019, Enti Shtetëror për Revizion, në kuadër të kryerjes së revizioneve të planifikuara, bëri edhe revizionin e prokurimeve publike te subjektet lëndë e revizionit dhe përcaktoi 35 gjetje në raportet përfundimtare të revizionit. Pesë parregullsitë, të cilat përsëriten më tepër në raportet janë dhënë në pasqyrën më poshtë.




## OPINIONET E REVIZORIT

Qëllimi kryesor në procesin e revizionit të rregullshmërisë, është t›i mundësojë revizorit të shprehë opinion nëse:

- raportet financiare shprehin me saktësi dhe objektivitet situatën financiare dhe rezultatin e aktiviteteve financiare dhe
- aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara në raportet financiare janë në përputhje me legjislacionin përkatës, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara.

Në bazë të qëllimeve të përcaktuara në raportet e revizionit, janë shprehur opinione në lidhje me raportet financiare dhe për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret, të cilat janë paraqitur më poshtë.



Struktura e opinioneve të dhëna mbi raportet financiare dhe pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret për vitin 2018, të grupuara sipas grupeve të përdoruesve është paraqitur në dy grafikët në vijim.

Opinionet mbi raportet financiare




Opinion mbi pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret



# TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Shuma totale e të ardhurave publike të reviduara, të cilat janë përfshirë me revizionet e kryera të raporteve financiare me Programin Vjetor në vitin 2019 është 247.997 milion denarë, ndërsa totali i të ardhurave publike të reviduara me Programin Vjetor në vitin 2018 arrin vlerën prej 255.335 milion denarë. Struktura e të ardhurave publike të reviduara në vitin 2019 dhe 2018 sipas grupeve të shfrytëzuesve është paraqitur në grafikun vijues.




Shuma e përgjithshme e shpenzimeve publike të reviduara, të mbuluara me revidimin e raporteve financiare me Programin Vjetor 2019 është 161.586 milion denarë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme të reviduara për vitin e kaluar është 119.586 milion denarë, që është 35% më shumë shpenzime publike të reviduara. Struktura e shpenzimeve publike të reviduara në vitin 2019 dhe 2018, sipas llojeve të shfrytëzuesve është paraqitur në grafikun vijues.



Buxheti i përgjithshëm i realizuar në vitin 2018 është 298.792 mijë denarë, ndërsa buxheti i reviduar për vitin 2018 është 161.586 mijë denarë, që paraqet 54% nga buxheti i përgjithshëm. Në krahasim me të dhënat nga një vit më parë, kemi një rritje në përfshirjen e shpenzimeve të reviduara, në vlerë prej 12% në krahasim me buxhetin e realizuar një vit më parë.




## REKOMANDIME DHE ZBATIMI I TYRE

Përveç misionit themelor të Entit Shtetëror për Revizion, si institucion i lartë i revizionit për të informuar me kohë dhe në mënyrë objektive bartësit e funksioneve publike dhe publikun për gjetjet e revizionit nga revizionet e kryera, po ashtu qëllimi i revizionit është të ofrojë rekomandime të qarta dhe efektive me çka ESHR siguron mbështetje për institucionet shtetërore dhe shfrytëzuesit e mjeteve publike për avancimin në menaxhimin e tyre.

Në pajtim me Ligjin për revizionin shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i detyruar të informojë Entin Shtetëror për Revizion dhe organin përgjegjës për mbikëqyrje dhe kontroll, për masat e ndërmarra në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet në raportet e revizioni, në afat prej 90 ditë nga pranimi i raportit përfundimtar.

Enti Shtetëror për Revizion monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e revizionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të rregullta, revizioneve të veçanta dhe kontrolleve mbi zbatimin e rekomandimeve, si dhe përmes informacionit të siguruar nga subjektet. Grafiku i mëposhtëm jep të dhëna për kategoritë e statusit të masave të ndërmarra pas rekomandimeve të dhëna për programet vjetore 2018 dhe 2019.

Me revizionet e kryera të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2018 dhe 2019, janë dhënë gjithsej 1030 rekomandime, për të cilat ka kaluar afati prej 90 ditësh për paraqitjen e informacionit kthyes nga subjektet që i janë nënshtruar revizionit dhe pas së cilës janë ndërmarrë masat për 789 rekomandime ose veprimi në lidhje me rekomandimet është 76,6%.




## Struktura e rekomandimeve të dhëna sipas llojeve të revizioneve dhe sipas llojeve të gjetjeve






# REVIZIONET E KRYERA

## BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut pasqyron lëvizjet e pritshme fiskale, të ardhurat publike për financimin e politikave dhe objektivave prioritare, me qëllim të ruajtjes së rritjes ekonomike dhe mbrojtjes sociale. Prioritetet strategjike të Qeverisë së RMV-së, strategjia fiskale, propozimi i planeve strategjike të shfrytëzuesve buxhetor dhe prioritetet e komunave janë bazë për hartimin e Buxhetit të RMV-së.

Gjatë hartimit të Buxhetit të RMV për vitin 2018, afatet e përcaktuara për aktivitetet kryesore në procesin e planifikimit strategjik nuk janë respektuar, përkatësisht, Vendimi për Prioritetet Strategjike të Qeverisë së RMV-së për vitin 2018 është miratuar me vonesë prej 3 muaj, ndërsa Strategjia Fiskale për vitin 2018-2020 e RMV-së me vonesë prej 5 muaj. Kjo situatë është për faktin se pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016, u formua Qeveria e RMV-së dhe filloi të punojë me një vonesë gjashtë mujore.

Në mungesë të strategjisë fiskale, Ministria e Financave dorëzoi njoftim te shfrytëzuesit buxhetor, që propozimet për buxhetet për vitin 2018 të përpilohen brenda shumave maksimale të shpenzimeve të përcaktuara nga Buxheti i RMV-së për vitin 2017. Revizioni konstatoi se disa shfrytëzues buxhetor kanë dorëzuar kërkesa të paplota buxhetore, pa plan për vende pune të sistematizuara dhe të plotësuara, plan për prokurime publike dhe plane strategjike tre-vjeçare, të cilat janë bazë për përgatitjen e buxheteve të tyre.

Mjete të kërkuara, propozim buxhet dhe mjetet e aprovuara të përdoruesve buxhetor



Buxheti i RMV për vitin 2018 është miratuar në shumë prej 154.890.936 mijë denarë, që është për 21.281.702 mijë denarë më i ulët në krahasim me mjetet e kërkuara nga shfrytëzuesit buxhetor, por në krahasim me vitin 2017 shënon rritje për 5,95%.

Për tejkalimin e dallimeve të tilla midis fondeve të kërkuara dhe atyre të aprovuara, është e nevojshme të intensifikohet procesi i harmonizimit të Ministrisë së Financave me udhëheqësit e shfrytëzuesve buxhetor.

Në gusht të vitit 2018, u bënë ndryshime dhe plotësime në Buxhetin e RMV-së dhe i njëjti shënoi rritje për 4,3%, për shkak të reterimeve ndërmjet lëvizjeve fiskale dhe shumave të planifikuara si në anën e të ardhurave ashtu edhe të shpenzimeve të buxhetit si dhe për shkak të nevojës për të siguruar mjete për politikat dhe masat e reja të Qeverisë së RMV-së.

Me rishikimin e shpenzimeve, më e rëndësishme ishte rritja e pagesës së kryegjësë 25,52% dhe te subvencionet dhe transferimet 24,57%, ndërsa shpenzimet kapitale u ulën për 18,44%.

Pjesëmarrjen më të madhe në të ardhurat e Buxhetit Themelor të RMV kanë të ardhurat tatimore me 65,70%, realizimi i të cilave është kryesisht në kompetencë të Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë Doganore. Në vitin 2018, këto të ardhura janë realizuar në shumën totale prej 111.427.122 mijë denarë dhe shënojnë rritje të vogël prej 1% në krahasim me 2017-ën.

Me revizionin është konstatuar se detyrimet tatimore në bazë të TVSH-së, së papaguar, tatimit mbi fitimin dhe tatimit personal nga persona juridikë dhe fizikë, të cilët janë në kompetencë të administrimit të Drejtorisë së të Ardhurave Publike, më 31.12.2018 janë në shumën totale prej 31.144.013 mijë denarë, ndërsa detyrimet për rimbursimit të TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin arrijnë shumën prej 6.330.673 mijë denarë, gjë që mbështet faktin se shteti ka të ardhura latente që pritet të arkëtohen në vitin e ardhshëm kalendarik.

Duke pasur parasysh kompetencat e Drejtorisë në lidhje me administrimin dhe kontrollin e të ardhurave tatimore dhe detyrimeve publike, është konstatuar nevoja për të forcuar burimet kadrovike dhe burimet teknike, si dhe përmirësimin e sistemeve informatike të Drejtorisë.

Sa i përket të ardhurave tatimore, kompetencë e Drejtorisë Doganore të RMV-së, është konstatuar se në vitin 2018 janë arkëtuar akcizat në shumën totale prej 23.745.094 mijë denarë, që është 8,2% më shumë se në vitin 2017, që pjesërsht bazohet në rritjen e akcizës për vajrat minerale. Në strukturën e akcizave sipas mallrave të akcizës, pjesëmarrje më të madhe kanë akcizat e derivateve të naftës dhe produkteve të duhanit.

Detyrimet dhe tarifat e importit janë arkëtuar në shumën prej 5.603.709 mijë denarë, që është 8,3% më shumë se në vitin 2017. Pjesën më të madhe e zë arkëtimi i taksave doganore në komunikacionin rrugor me 96,86%, komunikacioni ajror merr pjesë me 2,61% dhe komunikacioni hekurudhor me 0,29%. Sa i përket kompletësisë dhe saktësisë në administrimin e të ardhurave tatimore, kemi dhënë rekomandim për zbatimin e plotë dhe përdorimin e sistemit të integruar për arkëtimin e doganës dhe detyrimeve doganore dhe përpunimin dhe arkëtimin e akcizave.

Të ardhurat nga kompensimi për përdorimin e ujit, shkarkimi i ujërave dhe nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurit si pjesë e të ardhurave tatimore në vitin 2018, janë arkëtuar në vlerë prej 86.810 mijë denarë, që është 19% më pak se të ardhurat e mbledhura në vitin 2017. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, si organi kompetent për arkëtimin e plotë dhe me kohë të këtyre të ardhurave, duhet të krijojë një libër uji dhe evidencën e duhur të lejeve të lëshuara për të drejtat e ujit, me të gjitha të dhënat e nevojshme.

Me revizionin e organeve shtetërore përgjegjëse për të ardhurat nga toka ndërtimore dhe toka bujqësore në pronësi të RMV, si dhe dhënia e koncesioneve për kërkime të detajuara gjeologjike dhe shfrytëzim të burimeve minerale, kemi konkluduar se Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, duhet të vendosin evidencë të plotë të detyrimeve në bazë të qiradhënies së tokës ndërtimore dhe tokës bujqësore.

Ngarkimi me borxh në vend bëhet duke lëshuar letra me vlerë afatshkurtra ose afatgjata, të lëshuara nga RMV, me qëllim sigurmit të mjeteve pagesore. RMV në mënyrë të vazhdueshme lëshon letra me vlerë, siç janë bono shtetërore si afatshkurtra dhe flet obligacione shtetërore si letra me vlerë afatgjate. Gjatë vitit 2018, në tregun e brendshëm të kapitalit janë lëshuar 41 letra me vlerë afatgjate - obligacione shtetërore

dhe 28 letra me vlerë afatshkurtra - bono thesari shtetërore, mbi bazën e të cilave janë realizuar hyrje në shumën totale prej 56.566.252 mijë denarë, të cilat në krahasim me vitin 2017 është për 2.313.072 mijë denarë më pak ose 4%. Hyrjet nga ngarkimi me borxh i vendit për vitet 2018, 2017 dhe 2016 janë paraqitur në grafikun vijues:

Të ardhura nga ngarkimi me borxh në vend




Në vitin 2018, në bazë të huamarrjes jashtë vendit, për llogari të Buxhetit Themelor, janë realizuar të ardhura në shumën 30.290.546 mijë denarë, në bazë të letrave me vlerë shtetërore të emetuara në tregun ndërkombëtar të kapitalit - Eurobond i RMV.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve të kryera dhe shpenzimeve të tjera, u konstatua se pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet për transferimet rrjedhëse ndaj fondeve jashtë-buxhetore të cilat marrin pjesë me 22,32% dhe shpenzimet për beneficione sociale të cilat marrin pjesë me 17,83% në raport me shpenzimet e përgjithshme.

Struktura e shpenzimeve dhe shpenzimeve të Buxhetit Themelor të RMV-së për vitin 2018




Shpenzimet e realizuara dhe daljet e tjera në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, u rritën për 12%. Sipas strukturës së shpenzimeve të realizuara, rritja më domethënëse në krahasim me vitin 2017 vërehet në pagesën e kryegjësë 60%, subvencione dhe transferime me 43%, ndërsa rënia më e konsiderueshme paraqitet tek shpenzimet kapitale me 17%.

Sa i përket shumës së planifikuar për vitin 2018, shpenzimet totale dhe daljet janë realizuar në shumë më të vogël për 4.025.174 mijë denarë ose 2%.

Gjatë vitit 2018, nga Buxheti Themelor i RMV-së në Fondin për SPIM janë transferuan mjete në shumën 29.397.989 mijë denarë, përkatësisht 3,29% më shumë se në vitin 2017. Fondet e transferuara kanë për qëllim të mbulojnë detyrimet në bazë të sigurimit të pensionit dhe sigurimit invalidor, për faktin se Fondi i SPIM ka mungesë mjetesh për pagimin e pensioneve.

Shpenzimet për subvencione dhe transferime në vitin 2018 janë realizuar në shumë totale prej 18.809.305 mijë denarë që paraqet 11,94% të shpenzimeve totale. Në krahasim me vitin 2017, këto shpenzime janë më të larta për 5.629.639 mijë denarë ose 43%. Në vitin 2018, një pjesë e këtyre mjeteve, në vlerë prej 3.032.383 mijë denarë, u transferuan për mbështetje financiare ndaj komunave në përputhje me Ligjin për mbështetje financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe përfituesve individualë të krijuar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, për financimin e detyrimeve të maturuara dhe të pa arkëtuara. Ligji në fjalë mbulon financimin e 51% të shumës së raportuar të detyrimeve të maturuara dhe të papaguara të komunave dhe njësive shfrytëzuese në Sistemin elektronik për raportimin dhe regjistrimin e detyrimeve, përfshirë muajin shtator të vitit 2018.

Në vitin 2018, tek partitë politike nga ky zë u transferuan mjete në shumën totale prej 281.102 mijë denarë, që është 162,82% më shumë se në vitin 2017, për shkak të ndryshimit në përqindjen e përcaktuar me ligj nga 0,06% në 0,15% nga të ardhurat totale të Buxhetit të RMV-së.

Me qëllim sigurimit dhe ruajtjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe forcimin e përgjegjshmërisë gjatë përdorimit të mjeteve publike, organet e pushtetit shtetëror, NJVL, drejtoritë dhe institucionet që kryejnë veprimtari me interes publik, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare, entet, agjencitë, fondet dhe subjekte të tjera juridike, themeluesi i të cilëve është RMV ose NJVL kanë detyrimin të raportojnë për detyrimet e marra për shkak të evidentimit të tyre në Sistemin Elektronik për raportimin dhe regjistrimin e detyrimeve, të cilin e menaxhon dhe mirëmban Ministria e Financave. Nga gjithsej 1.371 subjekte, përfshirë muajin dhjetor të vitit 2018, në sistem janë raportuar detyrime prej 1.108 subjekte, në shumën totale prej 18.740.493 mijë denarë. Plotësia dhe afati kohor i të dhënave për detyrimet e subjekteve, është një nga parakushtet për përgatitjen e dokumenteve strategjikë që janë, të domosdoshëm për fillimin e procedurës për planifikimin dhe miratimin e Buxhetit.

## AGJENCIA PËR PUNËSIM E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV) është institucion publik kompetent për pagesën e rregullt të të drejtave në bazë të papunësisë - kompensim me para, kontribute nga sigurimi pensional për persona të papunë që kanë më pak se 15 vjet stazh pensional, sigurim shëndetësor për përfituesit e kompensimit me para dhe sigurim material. Në kompetencë të APRMV është implementimi i Planit Operacional për programe aktive dhe masa për punësim dhe shërbime në tregun e punës, të cilat do të sigurojë krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e punësimit të të papunëve, veçanërisht të rinjve dhe përfituesve të së drejtës për ndihmë financiare. Bartës i Planit Operacional për programe aktive dhe masa për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2018 është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, dhe zbatimi i tij është nën juridiksionin e APRMV dhe zyrave të saj rajonale - Qendrat e punësimit.

Me revizionin e elementeve të raporteve financiare për vitin 2018 të APRMV, me përfshirjen e: Pagave dhe kompensimeve dhe përfitimeve sociale në pjesën e pagesës së kompensimeve nga Agjencia e Punësimit, janë konstatuar dobësi në sistemin e kontrolleve të brendshme në procesin e zbatimit dhe pagimit të mjeteve për programet aktive dhe masat për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës, që krijon rrezik nga mosrespektimi i rregullave dhe udhëzimeve operative në pjesën e:

- politikave të papranuara të kontabilitetit me metodat e përcaktuara për kontrollin e pagesës së mjeteve për programet aktive dhe masat e punësimit në Qendrat e Punësimit dhe Shërbimin Qendror, si dhe mënyrën e regjistrimit dhe raportimit mbi to;

- nuk është hartuar analizë gjithëpërfshirëse e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të programeve aktive dhe masave të punësimit dhe analiza afatgjata të statusit të përdoruesve pas skadimit të afateve të parashikuara dhe punësimit të tyre;
- mungon sistem i integruar plotësisht i evidencës së të dhënave për pagesën e përfitimeve në bazë të papunësisë dhe evidenca e programeve dhe masave aktive me bazën e të dhënave për kontabilitetit financiar, gjë që e bën të pamundur monitorimin dhe kontrollin e regjistrimit dhe arkivimit të të dhënave.

Për realizimin e gjithsej 10 programeve dhe masave të punësimit të parashikuara nga Plani Operacional për programet aktive dhe masat për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës në vitin 2018, nga llogaria e APRMV janë paguar gjithsej 974.419 mijë denarë ose 39% e shpenzimeve totale për periudhën raportuese.

Shpërndarja e shpenzimeve sipas programeve dhe masave është paraqitur në grafikun vijues:




Struktura e shpenzimeve për realizimin e masave dhe politikave aktive sipas qëllimit dhe shfrytëzuesit, si dhe pagesa e tyre është dhënë në pasqyrimin vijues.




Në pjesën e zbatimit të programeve aktive dhe masave të punësimit, janë identifikuar gjendje që mund të kontribuojnë në reterime të caktuara në drejtim të konfirmimit të arritjes së objektivit të masave, si dhe pamundësisë për të vendosur kontrollet e dokumentacionit dhe për pagesën me dedikim për masën, si vijon:

- kompletimi i pamjaftueshëm dhe jo i plotë i dokumentacionit në lëndën / skedarin në varësi të masës dhe pa prova për monitorim me kontrollet në terren te punëdhënësit dhe përfituesit e mjeteve,

pamundësi për të vendosur kontrolle mbi dokumentacioni dhe për pagesën me dedikim për masën, kështu që në tërësi nuk veprohet në pajtim me Udhëzimet Operative për vitin 2018;

- dokumentacioni i pasiguruar nga ana e Sektorit për Masat Aktive dhe Programe të cilat, sipas Udhëzimeve Operative, në bazë të të cilave do të konfirmojnë zbatimin e programeve aktive të punësimit dhe masave për punësim të zbatuara me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në implementimin nga ana e UNDP-së, siç është plani i biznesit dhe specifikimet bashkangjitur marrëveshjeve të përfunduara, dokumentacionin financiar për prokurim, dokumentacionin për kryerjen e trajnimeve dhe aktivitetet e monitorimit të kryera nga UNDP dhe koordinatorët e APRMV;
- për realizimin e projektit «Krijimi i mundësive për punë për të gjithë III» në vitin 2018, APRMV ka bërë pagesa të mjeteve të UNDP-së në shumën totale prej 405.881 mijë denarë për të cilat nuk është siguruar asnjë dokumentacion i plotë, me të cilën do të konfirmohej prokurimi nga shfrytëzuesit e grantit, dhe për shkak të mënyrës së paraqitjes së shpenzimeve dhe detyrimeve, si dhe kursimet nga UNDP, revizioni nuk ka shprehur opinion për mjetet e shpenzuara nga llogaria e APRMV dhe shpenzimet e paraqitura në Bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2018.

Në këtë mënyrë është pamundësuar menaxhimi i sigurt financiar dhe realizimi i buxhetit në bazë të kontrollit të brendshëm efektiv dhe efikas, si një proces i cili aplikohet në të gjitha nivelet e menaxhimit të mjeteve financiare, që është paraparë si një nga parimet e parashikuara në Ligjin për buxhetet.

Gjatë revizionit, aktivitetet e përbashkëta u iniciuan nga grupi i punës i APRMV dhe UNDP për ndërtimin e




kapaciteteve të APRMV duke filluar nga viti 2020.

Për gjendjet e konstatuara nga revizioni janë dhënë rekomandime në drejtim të tejkalimit të tyre nga Agjencia është parashtruar sugjerim me shkrim për mënyrën e veprimit nga qendrat e punësimit gjatë zbatimit të programeve aktive dhe masave të punësimit dhe sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe kryerjen e kontrolleve të rregullta në terren.

*Qeveria e RMV në mars të vitit 2020 angazhoi APRMV që të përgatisë një plan veprimi me aktivitete, afate të përcaktuara saktësisht dhe bartës të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportet përfundimtare të revizorit shtetëror të autorizuar.*

*Më datë 24.02.2020, te Enti Shtetëror për Revizion është dorëzuar informacion për masat e ndërmarra nga Agjencia e Punësimit të RMV në lidhje me Raportin Përfundimtar, me çka na informojnë se në pjesën më të madhe është vepruar ose është në rrjedhë veprimi në lidhje me rekomandimet e dhëna.*

# FONDI PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror për Revizion ka kryer revizion të rregullshmërisë për vitin 2018 të Detyrimeve, Të ardhurave tatimore, Transferimeve dhe Donacioneve dhe Benificioneve sociale që janë pjesë e raporteve financiare, gjatë çka i konstaton gjendjet në vijim:

- Në të ardhurat totale të Fondit në vitin 2018 që kapin shifrën prej 68.645.000 mijë denarë, pjesa e të ardhurave nga kontributet e arkëtuara zvogëlohet vazhdimisht në lidhje me fondet e alokuara nga Buxheti Themelor i RMV, me ç 'rast pjesa e mjeteve të transferuara në të ardhurat e përgjithshme lëviz nga 35,7% në vitin 2011 në 43% në vitin 2018. Pjesëmarrja e zmadhuar e transferimeve nga Buxheti Themelor është rezultat i shkallës së papunësisë, lartësisë së shkallës së kontributit për sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor, zgjidhjeve ligjore për lirim nga pagesa e kontributeve dhe pagesë të kontributeve me shkallë të favorizuar, raport i pafavorshëm i numrit të të punësuarve dhe pensionistëve.




- Sistemi i vendosur për përcaktimin, kontrollin dhe arkëtimin e kontributeve nuk bazohet në integrimin e përditësuar dhe të plotë të të dhënave nga institucionet, gjë që ndikon në tërësinë e të ardhurave, si dhe likuiditetin e Fondit dhe qëndrueshmërinë e sistemit pensional. Përkatësisht, institucionet në sistemin e detyrueshëm të sigurimeve sociale, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor dhe Sigurim Shëndetësor dhe Agjencia e Punësimit, kanë baza të veçanta që funksionojnë paralelisht dhe ndryshojnë nga njëra-tjetra në numrin dhe trajtimin e ndryshëm të bonove dhe të personave të siguruar. Marrëveshja midis tyre nuk parashikon detyrim për Drejtorinë e të Ardhurave Publike të paraqesë të gjitha të dhënat e përcaktuara me ligj, në lidhje me kontributet. Në kushte të tilla, Drejtoria e të Ardhurave Publike paraqet informacione vetëm për pjesën e arkëtimit të detyrimeve.
- Me Projektin e mbështetur nga Banka Botërore bëhet analizë për vendosjen e sistemit të vetëm të përbashkët qendror dhe bazës së të dhënave për të gjithë personat e siguruar, të cilin do ta përdorin të gjitha institucionet.
- Për shkak të papajtueshmërisë së bazave të të dhënave dhe shkëmbimit joadekuat të të dhënave midis institucioneve, si dhe gabimeve gjatë regjistrimit, në llogarinë e Fondit vazhdimisht paraqiten numër i madh i pagesave jo-konsistente të kontributeve, si dhe aplikime të pavlefshme që kanë bërë që disa persona të siguruar të mos shpërndahen në shtyllën e dytë pensionale disa vite me radhë. Shuma e përgjithshme e pagesave të paidentifikuara dhe të palokalizuara më datë 31.12.2018 është 111.407 mijë denarë, numri i konstatuar i të siguruarve të pa shpërndarë në shtyllën e dytë është 12.103 persona, dhe kontributi i paguar për ta është 918.534 mijë denarë. Për të kapërcyer gjendjet e përcaktuara, u miratuan ndryshime ligjore, të cilat u zbatuan në vitin 2019, dhe iu mundësua Fondit të bëjë korrigjime me detyrë zyrtare në sistemin e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, me çka pritet të zgjidhen disa prej problemeve dhe të zvogëlohen pagesat jo konsistente.
- Për shkak të mos-sinkronizimit dhe të dhënave jo të plota nga institucionet që paraqesin informacionin hyrës, detyrimet në bazë të kontributit të papaguar shfaqen jo realisht dhe për disa prej tyre nuk ka gjasa për arkëtim. Këto kërkesa në vlerë prej 10.764.399 mijë denarë marrin pjesë me 83% në totalin e arkëtimeve të Fondit dhe u referohen kërkesave të arkëtueshme deri më datë 31.12.2008, ndërsa struktura dhe kompetenca për arkëtimin e tyre janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm..




- Fondi nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për arkëtimin e detyrimeve të shkaktuara deri më 31.12.2008, dhe shumica e tyre janë nga obligacione në likuidim ose falimentim ose me llogari të bllokuara, për shkak të të cilave në vitin 2018 detyrimet janë shlyer në shumën prej 1.203.999 mijë denarë. Të dhënat për kontributet e papaguara të cilat Drejtoria e të Ardhurave Publike ja paraqet Fondit janë jo të plota dhe i referohen vetëm kontributit të papaguar të tatim paguesve që kanë paraqitur përllogaritje, gjë që ndikon në tërësinë e detyrimeve të paraqitura.
- Pensionet e paguara në vitin 2018 arrijnë shumën prej 53.912.048 mijë denarë dhe marrin pjesë me 79% në Benificionet Sociale, të cilat përfaqësojnë 99% të shpenzimeve të përgjithshme të Fondit. Me analizën e ligjshmërisë së procedurave për përcaktimin e të drejtave dhe pagesën e të ardhurave nga pensionet dhe saktësinë e të dhënave të paraqitura, kemi konstatuar disa gjendje:
  - Përdorimi i llojeve të ndryshme të teknologjive gjatë evidentimit të të dhënave dhe dobësitë në ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit në regjistrin amë në të kaluarën, e bëjnë të pamundur verifikimin e besueshmërisë dhe tërësisë së të dhënave të kërkuara për realizimin e të drejtave;;
  - Sistemi i vendosur i realizimit të të drejtave dhe pagesa e pensioneve nuk siguron gjithmonë saktësi dhe afat të saktë në procedurën dhe nuk ka kontrolle të mjaftueshme për të mbuluar rrezikun nga zbatimit jo përkatës i dispozitave të akteve ligjore, të akteve nënligjore dhe akteve të brendshme;
  - Institucionet kompetente jo gjithmonë paraqesin dokumentacionin e nevojshëm në kohën e duhur dhe të kompletuar, në kushte kur kontrolli për përfundimin e të drejtave të caktuara, nuk është vendosur. Për rastet e përcaktuara të pagesave të bëra pas skadimit të së drejtës së përcaktuar me ligj, janë evidentuar detyrime, por kthimi i të njëjtave është me dinamikë të ngadalësuar dhe
  - Për shkak të komunikimit të ngadaltë dhe shkëmbimit të informacionit me fondet e pensioneve jashtë vendit, vendimet për realizimin e të drejtave në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim social miratohen me vonese prej disa vitesh.

Për gjendjet e konstatuara, revizioni dha rekomandime që Fondi në bashkëpunim me ministrinë kompetente të vazhdojë me zbatimin e projekteve dhe të marrë në konsideratë mundësitë për pjesëmarrje më aktive të Fondit në hartimin e politikave dhe zbatimin e ligjit, si dhe për përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet në periudhën e ardhshme, me qëllim të tejkalimi të gjendjeve të konstatuara.

Revizioni potencon nevojën që ministria kompetente të ndërmarrë veprime për të rishikuar zgjidhjet ligjore për përcaktimin e shumave të pensioneve më të ulëta dhe më të larta, sigurimin e sigurisë sociale të fermerëve, me qëllim respektim konsekuent të së drejtësisë sociale.

Duke filluar nga data 01.01.2020, do të hyjnë në fuqi normat e rritura të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurim shëndetësor, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e të ardhurave burimore të fondeve.

*Pas dorëzimit të Raportit Përfundimtar te autoriteteve kompetente, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i dorëzoi mendim Qeverisë së RMV-së me të cilën e informoi se Ministria në bashkëpunim me FSPIM përcaktoi plan veprimi me aktivitete dhe afate të nevojshme.*

*Qeveria e RMV në mars të vitit 2020 angazhoi FSPIMV të përpilojë plan veprimi me aktivitete, afate të përcaktuara saktësisht dhe bartës të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportet përfundimtare të revizorit shtetëror të autorizuar.*

## FONDI PËR SIGURIM SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e rregullshmërisë së shërbimeve kontraktuese në pjesën e llogarisë Shërbime shëndetësore dhe beneficione sociale që janë pjesë e raportit financiar Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat në vitin 2018 arritën shumën prej 28.947.155 mijë denarë, ose 98,44% të shpenzimet totale.

Me revizionin e kryer u konstatuan dobësi në pjesën e kontrolleve të brendshme që kanë të bëjnë me konfirmimin e realitetit dhe objektivitetit të numrit të faturuar dhe llojeve të ndërhyrjeve mjekësore të kryera nga institucione shëndetësore private, me të cilat Fondi ka lidhur marrëveshje.

Janë konstatuar parregullsi dhe dobësi në zbatimin e procedurave të shërimit jashtë vendit, për të cilat gjatë vitit 2018 janë paguar gjithsej 407.881 mijë denarë. Lëvizja e lartësisë së mjeteve të paguara për këtë qëllim për 5 vitet e fundit është dhënë në grafikun e mëposhtëm.




Procedura e shërimit jashtë vendit është mjaft komplekse dhe afatgjatë, nuk siguron mbrojtje të përshtatshme juridike për aplikantët dhe për të njëjtën nuk është parashikuar formë organizative me kompetenca të deleguara, monitorim dhe kontroll të aktiviteteve të këtij procesi, veçanërisht në kushtet kur nuk është vendosur kontrolli ex-post. Për këtë procedurë, nuk është vendosur sistem për monitorimin e statusit të shërimit jashtë vendit dhe sigurimin e dokumenteve të rregullta dhe të besueshme dhe nuk bëhen analiza për suksesin e shërimit në spitale individuale.

Në pjesën e zbulimit, janë identifikuar mospërputhje në lidhje me mënyrën e përcaktimit të buxhetit vjetor të institucioneve shëndetësore publike, dhe në lidhje me raportin të pa përcaktuar ndërmjet nivelit të shërbimeve të kryera dhe kompensimit të tyre nga Fondi, për çka nuk është siguruar blerja e vërtetë

e shërbime nga institucionet shëndetësore publike në mënyrën të parashikuar me Ligjin për sigurim shëndetësor. Përkatësisht, Fondi detyrohet të sigurojë mjete për funksionimin e plotë të atyre institucioneve shëndetësore publike që nuk janë në gjendje të arrijnë vëllim të mjaftueshëm të shërbimeve ose të përshtaten në sistemin ekzistues të vlerësimit të shërbimeve shëndetësore, në vend që të kompensojnë shërbimet shëndetësore të kryera realisht. Si rezultat, institucionet e shëndetit publik nuk janë në gjendje plotësisht dhe me kohë të servisojnë shërbimet ndaj furnizuesve që rezulton në krijimin e borxheve.

Lëvizja e shumës së borxheve të institucioneve shëndetësore publike për periudhën nga viti 2014-2018 është paraqitur në grafikun më poshtë.




## BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Me Programin Vjetor të Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2019, është kryer revizion i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e Planit për investime në mjete themelore dhe Planin Financiar të shpenzimeve operative për vitin 2018 dhe realizimin e tyre, së bashku me revizionin e pajtueshmërisëështëdhënë opinion pa rezervë. Me qëllim kryerjen e vazhdueshme dhe efikase të funksioneve, Banka Popullore miratoi Plan për investimin e mjeteve themelore, i cili paraqet Plan Vjetor të Investimeve dhe Plan Analitik i Investimeve për një periudhë tre vjeçare. Investimi më i rëndësishëm është ndërtimi i objektit të ri të Bankës Popullore për të cilin është lidhur marrëveshje në tetor të vitit 2016 në shumën totale prej 1.477.332 mijë denarë, për të cilin në vitin 2018 janë realizuar mjete në vlerë prej 128.060 mijë denarë. Ndërtimi është ende në rrjedhë dhe në pajtim me aneksin e vitit 2019, afati përfundimtar për kryerjen e punimeve është caktuar për mars të vitit 2021.

Banka Popullore miraton gjithashtu edhe Plan Vjetor Financiar i cili paraqet kornizë për financimin e shpenzimeve të Bankës Popullore. Plani financiar përbëhet nga plani i të ardhurave dhe shpenzimeve që rrjedhin nga aktivitetet monetare, operacionet operative dhe aktivitetet e tjera që lidhen me arritjen e qëllimeve të përcaktuara me ligj.

Shpenzimet operative të Bankës Popullore në vitin 2018 janë realizuar në vlerë prej 654.961 mijë denarë, që në krahasim me vitin 2017 është për 17% më pak, kur ato janë realizuar në vlerë prej 792.792 mijë denarë.

Revizioni konstatoi se zbatimi i aktiviteteve nga Plani për investime në mjete themelore dhe nga Plani Financiar në pjesën e shpenzimeve operative për vitin 2018, janë në përputhje me rregulloret përkatëse.

## MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATËS

Me revizionin e raporteve financiare të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës për vitin 2018, së bashku me revizionin e përputhshmërisë, janë përcaktuar gjendje për të cilat u dhanë rekomandime për tejkalimin e tyre, si vijon: sigurimi i dokumentacionit të plotë për të konfirmuar të drejtën e përdorimit të të gjitha objekteve afariste të cilat i përdor Ministria, sigurimi i tërë pasurisë së Ministrisë, efektivitet më i madh i revizionit të brendshëm, si dhe evidentimi në kohë, i plotë dhe kronologjik i detyrimeve ndaj furnizuesve.

Në funksion të zhvillimit të teknologjisë informatike dhe të komunikimit dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike, Ministria vazhdimisht zbaton projekte të financuara me mjete të parashikuara në Nën-Programin NA-Zhvillim dhe zbatim i teknologjive informatike dhe të komunikimit nga pjesa zhvillimore e Buxhetit të RMV-së.

Me revizionin është konstatuar se në Sistemin e integruar për menaxhim me burimet njerëzore, i cili ka për qëllim menaxhimin cilësor të burimeve njerëzore si në nivel të institucionit ashtu edhe në sektorin publik, zvogëlimin e shpenzimeve në lidhje me menaxhimin e të punësuarve, planifikimin e zhvillimit dhe promovimit të tyre, por nuk bëhet regjistrimi në kohë dhe i plotë i të dhënave në sistem nga ana e institucioneve, nuk bëhet përditësimi i tyre, për çka Regjistri i të punësuarve në sektorin publik ende nuk ofron të dhëna të plota, në kohë dhe të plota, me qëllim të arritjes së qëllimeve themelore për të cilat është krijuar.

Sistemi i inter -operabilitetit përkatësisht Magjistralja Informative e Maqedonisë - paraqet «rrugë», përkatësisht kanal për shkëmbim e informacioneve dhe të dhënave midis institucioneve që janë të lidhura në të. Konstatuam se gjithsej 32 institucione janë të lidhura me platformën e ndërveprimit, por vetëm gjysma e tyre shkëmbejnë të dhëna. Sugjeruam nevojën që Ministria të rishqyrtojë arsyet e përdorimit jo të plotë të platformës nga disa institucione që tashmë janë të lidhura, nevojën e tyre reale për të dhënat dhe informacionet që e njëjta i ofron, si dhe mundësia për lidhjen e institucioneve të tjera që kanë nevojë për shkëmbim të tillë të të dhënave dhe informacione.




Sistemi për menaxhim me dokumente është një sistem i unifikuar që duhet të mundësojë përpunimi i dokumenteve në institucionet shtetërore të jetë plotësisht elektronik. Situata në lidhje me përdorimin e sistemit në institucionet ku është implementuar tregon nevojën për të ndërmarrë aktivitete për të rritur përdorimin e moduleve në të gjitha institucionet ku është vendosur, veçanërisht pasi Ministria ka për obligim për mirëmbajtje të vazhdueshme që shkakton shpenzime buxhetore.

Ministria përdor platformë re me qira (Cloud) për hostim të sistemeve, për të cilën gjatë vitit 2018 ka lidhur marrëveshje për qiramarrje dhe realizimi i saj është në proces.

Regjistri Qendror i Popullsisë është projekt që duhet të mundësojë krijimin e një baze të vetme të të dhënave, që do të sigurojë informacione të përditësuara për popullatën në RMV. Në Shtator të vitit 2018, u krijua versioni i parë i Regjistrit Qendror të Popullsisë, por implementimi i tij i plotë është ende në vazhdim.

Qëllimi i projektit Një pikë shërbimi është të mundësojë që qytetarët në një vend të mund të marrin informacione dhe shërbime nga institucione të ndryshme shtetërore dhe publike. Projekti filloi me realizim

në vitin 2015. Në shkurt të vitit 2019 u hap Qendra e parë për Shërbime në Shkup, në mënyrë që qytetarët në një vend të marrin shërbime nga 10 institucione të ndryshme. Ministria vazhdon me aktivitete që synojnë zhvillimin dhe formësimin e të gjithë konceptit për krijimin e parimit të «sistemit një sportel», përmes Qendrave për Shërbime në qytetet kryesore në shtet.

*Enti Shtetëror për Revizion, sugjeron nevojën për të intensifikuar masat dhe aktivitetet e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës për zbatimin e plotë të projekteve të filluara, me qëllim harmonizimin me standardet ndërkombëtare të funksionimit të organeve të administratës shtetërore, zhvillimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së TI dhe forcimin e aspekteve të sigurisë, përmirësimin e funksionimit të institucioneve dhe vendosjen e efektivitetit dhe efikasitetit të e-menaxhimit në shtet.*

## MINISTRIA E EKONOMISË

Me revizionin e kryer të rregullshmërisë së Ministrisë së Ekonomisë për vitin 2018, është konstatuar se shpërndarja e mjeteve financiare në 16 shoqata klaster për zbatimin e projekteve, nuk është në përputhje me pikët e përcaktuara nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e mjeteve për mbështetje dhe zhvillim të shoqatave klaster, me ç 'rast tre shoqata klaster, të cilave u janë alokuar mjete për realizimin e projekteve për të cilat ata kishin aplikuan, nuk i realizuan projektet, ndërkaq mjetet e pa shfrytëzuara nuk i kanë kthyer në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda afatit të caktuar.

Ministria e Ekonomisë përdor automjete motorike për udhëtim për qëllime zyrtare, por në kushtet kur është konstatuar përdorimi i pa dedikim i mjeteve, nuk respektohet Procedura e Brendshme për mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së të njëjtave.

Impianti për pastrim si pjesë e kompleksit «Fshati Maqedonas» ende shënohet në librat afariste të Ministrisë, sepse nuk është marrë Vendim për ndalimin dhe dhënie në përdorim të përhershëm të sendeve të patundshme, si bazë për kryerjen e transferimin te Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nuk është kryer transferimi i plotë i dokumentacionit gjeologjik nga Ministria e Ekonomisë në Entin Gjeologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si subjekt juridik kompetent që arkivon, administron dhe lëshon dokumentacionet gjeologjike.

Në pjesën, Theksimi i çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësisë, revizioni i zbardh kushtet që janë theksuar në më shumë raporte të revizionit të mëparshme te ky subjekt, ndërkaq kanë të bëjnë me shlyerjen e principalit / kryegjësë dhe pagesën e normës së interesit të kredisë nga Banka Botërore që nga viti 2005 për Projektin për Reformën e Biznesit dhe forcimin institucional, në vlerë prej 8,8 milion euro, për të cilët përdoruesit janë më shumë institucione, ku pagesa bëhet vetëm nga mjetet e parashikuara në Buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, megjithëse sipas marrëveshjes, një pjesë duhet të paguhet edhe nga përdoruesit e mjeteve të kredisë, Banka Popullore e RMV-së dhe Regjistri Qendror i RMV-së.

*Bazuar në konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria ka përgatitur plan veprimi me aktivitete saktësisht të përcaktuara, afate dhe bartës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të revizorit shtetëror të autorizuar.*

*Gjatë vitit 2020, nga revizioni është kryer kontroll mbi masat e ndërmarra në lidhje me gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna të përfshira në raportin përfundimtar, gjatë së cilës konstatuar se nga personi përgjegjës i Ministrisë janë ndërmarrë masa dhe pjesa më e madhe e dobësive të identifikuara janë tejkaluar.*

## MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2018 për llogarin e buxhetit themelor të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve përmes të cilit janë realizuar programet e mëposhtme:

Me revizionin e kryer janë konstatuan këto gjendje:

- në pasqyrat financiare, në kuadër të pozicionit mjete materiale në përgatitje, janë evidentuar ndërtime të financuara përmes Programeve për ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe ndërtimin e plazheve dhe programe të tjera, të cilat kanë përfunduar dhe kanë vite që janë në përdorim, por për të cilat nuk është bërë dorëzim - pranimi me komunat ku janë ndërtuar;
- është evidentuar një pjesë e hapësirës afariste me të cilën disponon ministria, por për të nuk është siguruar listë pronësore nga Agjencia për Kadastër të Patundshmërive, ndërsa në librat afaristë nuk është evidentuar hapësira afariste Kapetanija në portin në Ohër për të cilën kanë siguruar listë pronësore.

Duke pasur parasysh rëndësinë e realizimit të të ardhurave nga arkëtimi i shpenzimeve nga shitja e tokës ndërtimore në pronësi të RMV-së, Ministria duhet të miratojë Procedurë për evidentimin e të ardhurave të deklaruara.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, revizioni dha rekomandime për marrjen e masave dhe aktiviteteve.

Përveç kushteve të përcaktuara, revizioni i theksoi edhe gjendjet që kanë ndikim mbi funksionimin e MTL, si më poshtë:

- në gusht të vitit 2018, me Vendim të Qeverisë së RMV-së për transferimin e aksioneve, për shkak të ndarjes së pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (SHA MEPSO) nga Qeveria e RMV-së, Ministria u bë pronare e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (SHA MEPSO);




- mjetet e parashikuara në Buxhetin e RMV-së për subvencionimin e shërbimit publik për transport të udhëtarëve në komunikacionin hekurudhor nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për shërbimet e transportit të transportuesit në pronësi shtetërore, gjë që vë në pikëpyetje sigurimin e shërbimi cilësor me interes publik - transportin në komunikacionin hekurudhor;
- në kushte kur nuk është miratuar Programi Kombëtar i Infrastrukturës Hekurudhore për vitin 2017-2019, për infrastrukturën hekurudhore janë akorduar më pak mjete, në krahasim me të drejtën e parashikuar me ligj dhe
- për fondet e paguara ndaj komunave nga Buxheti i Ministrisë, për realizimin e projektit Mbështetje dhe Zbatim të Dekadës dhe Strategjisë së Romëve, në përputhje me Vendimin e Qeverisë së RMV-së, nuk janë lidhur marrëveshje për përdorimin me dedikim të mjeteve, me komunat.

*Bazuar në konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria ka përgatitur plan veprimi me aktivitete saktësisht të përcaktuara, afate dhe bartës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të revizorit shtetëror të autorizuar.*

*Gjatë vitit 2020, nga revizioni është kryer kontroll mbi masat e ndërmarra në lidhje me gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna të përfshira në raportin përfundimtar, gjatë së cilës është konstatuar se nga personi përgjegjës i Ministrisë janë ndërmarrë masa dhe pjesa më e madhe e dobësive të identifikuara janë tejkaluar.*

## MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

Me revizionin e kryer të rregullshmërisë së Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për vitin 2018, u konstatuan gjendjet e si më poshtë:

- të dhënat në evidencën e kontabilitetit dhe bruto bilanci nuk janë harmonizuar me llogarinë vjetore të Ministrisë për vitin 2018, për shkak të së cilës të dhënat në llogarinë vjetore pasqyrojnë jorealisht situatën aktuale të punës;
- janë përcaktuar mospërputhje në kryerjen e regjistrimit të inventarit, arkëtimeve dhe detyrimeve, si dhe në harmonizimin e situatës së shprehur në kontabilitet me gjendjen faktike të përcaktuar;
- nuk është vendosur evidencë e saktë dhe e përditësuar për ndryshimet dhe kushtet në mjetet e përhershme, detyrimet dhe arkëtimet;
- respektim jo konsistent i kritereve gjatë shpërndarjes së bllok dotacioneve për mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nëpër komuna, si dhe mungesën e kritereve specifike, të qarta dhe të zbatueshme në alokimin e mjeteve nga Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese për organizatat dhe shoqatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes sociale.

Struktura e shpenzimeve të bëra për pagimin e mjeteve për ndihmë me para nga mbrojtja sociale kryesisht i referohet kompensimit me para për: ndihmë dhe kujdes nga person tjetër (kujdes për njeri tjetër), ndihmë e përhershme me para, shtesë për mobilitet dhe verbërisë dhe ndihmë sociale me para. Në drejtim të ndërmarrjes së aktivitete të mëtutjeshme nga autoritetet kompetente në planifikimin dhe sigurimin e mjeteve për pagimin e të drejtave të përdoruesve, revizioni me prezantim grafik paraqet lëvizjen e pagesave për periudhën nëntë vjeçare.



## ENTI SHTETËROR PËR STATISTIKË

Me revizionin e kryer të rregullshmërisë së Entit Shtetëror për Statistikë, për vitin 2018 janë konstatuar dobësi në kontrollet e brendshme në sistemin e pagesave pa para në dorë, në operacionet e thesarit dhe në monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura. Janë dhënë rekomandime për miratimin e akteve të brendshme që do të përcaktojnë dhe krijojnë sistem të kontrolleve të brendshme, duke pasur parasysh Enti Shtetëror i Statistikës është e organizuar si Drejtori e Përgjithshme me tetë njësi rajonale. Janë konstatuar dobësi në regjistrimin e inventarit të librave në bibliotekë, pikturat artistike dhe stoqet e materialeve, për të cilat u dhanë rekomandime për përmirësimin e mënyrës së kryerjes së inventarit.

Enti Shtetëror i Statistikës, përcakton instrumente për kërkime statistikore, përgatit standarde kombëtare statistikore, për të cilat grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore, i analizon ato, përgatit parashikime statistikore, tendencat dhe modelet, për të cilat aktivitete i angazhon personat që të kryejnë punë intelektuale në bazë kontratës në vepër. Në vitin 2018, gjithsej 227 persona u punësuan mbi këtë bazë për 12 hulumtime me anketë, pa kritere të përcaktuara për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, si bazë për angazhimin e tyre për hulumtim të caktuat me anketë. Rekomandohet të përcaktohet procedurë për mënyrën e zgjedhjes së të anketuarve, në mënyrë që të rritet transparenca dhe qëndrueshmëria në procedurat.

## DREJTORIA PËR REZERVA TË DETYRUESHME TË NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS

Është kryer revizion i rregullshmërisë së Drejtorisë për Rezerva të Detyrueshme të Naftës dhe Derivateve të Naftës për vitin 2018. Me të cilën është përcaktuar se rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës formohen me prokurime të zbatuara nga Drejtoria, bazuar në dinamikën e formimit të përcaktuar në programin afatmesëm pesë-vjeçar dhe programin vjetor për vitin 2018. Dinamika e formimit të rezervave të detyrueshme është çrregulluar, për faktin se gjatë vitit 2018 nuk janë realizuar procedurat e planifikuara për prokurimin e rezervave të detyrueshme, për shkak të faktit se nuk është paraqitur asnjë ofertë.

Mjetet e parashikuara për mbulimin e shpenzimeve për funksionimin e rregullt të Drejtorisë sigurohen nga kompensimi për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës që paguhen gjatë importimit të derivateve të naftës dhe gjatë prodhimit të derivateve të naftës.

Gjatë vitit 2018, Drejtoria ka gjeneruar të ardhura vetëm në bazë të arkëtimit të kompensimit për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës që paguhet gjatë importimit të produkteve të naftës, në shumën totale prej 584.482 mijë denarë. Të ardhurat në bazë të kompensimit të paguar për lëshim në qarkullim, përkatësisht dorëzimin e derivateve të naftës së prodhuar nga depot e prodhuesit nuk është realizuar, për shkak të faktit se që nga viti 2015 nuk ka asnjë proces prodhimi të derivateve të naftës në RMV.

Është konstatuar se në Drejtori nuk është vendosur evidenca e arkëtimeve totale nga detyrimet e përgjithshme për pagimin e kompensimit për rezervat e detyrueshme të derivateve të naftës dhe derivateve të naftës dhe nuk është bërë harmonizimi tremujor ndërmjet Drejtorisë dhe Drejtorisë Doganore të RMV-së për të dhënat në lidhje me kompensimin e paguar nga obliguesit.

Për të përmbushur detyrimin ligjor për ruajtjen dhe rinovimin e rezervave të detyrueshme, Drejtoria ka lidhur marrëveshje me tre kompani tregtare - depo, të cilat janë të detyruara të rinovojnë rezervat duke zëvendësuar stoqet e përhershme të derivateve të naftës me sasi të reja, me qëllim ruajtjen e vetive të tyre fizike - kimike. Në vitin 2014, njëra prej kompanive tregtare anuloi menaxhimin e dy depove, për shkak të kësaj duke filluar nga viti 2015, përgjegjësia për ruajtjen dhe rinovimin e tyre i mbetet Drejtorisë. Përskaj iniciativave të ndërmarra për rinovimin e naftës dhe derivateve të naftës në këto dy depo, rinovimi i tyre nuk u krye deri në ditën e raportimit të revizionit.

Në periudhën e kaluar, një pjesë e rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës lëshohen në bazë të Vendimeve të Qeverisë së RMV-së, në rastet kur ekziston nevojë urgjente për derivate të naftës për organet shtetërore, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat e tjerë juridikë dhe institucionet e themeluara nga shteti që kryejnë veprimtari me interes publik edhe për komunat, me qëllim të kryerjes së pandërprerë të veprimtarive të tyre të përcaktuara me ligj.

Në vitin 2014, u miratua një Ligj i ri për Rezervat e Detyrueshme të Naftës, në mënyrë që të harmonizohet legjislacioni maqedonas me Direktivën 2009/119 / BE të Këshillit të Bashkimit Evropian për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rezervave minimale të derivateve të naftës. Zbatimi i këtij ligji është shtyrë disa herë dhe me ndryshimin e fundit të miratuar në dhjetor të vitit 2019, ligji do të zbatohet nga data 01.01.2021. Sipas dispozitave të këtij ligji, nuk është e mundur të përdoren rezervat e detyrueshme për qëllime dhe nevoja të tjera, me çka do të parandalohet zvogëlimi i sasive të naftës dhe të derivateve naftës me të cilat duhet disponojë Drejtoria.

## AGJENCIA INFORMATIVE MEDIATIKE

Është kryer revizion i raporteve financiare së bashku me Revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2018 të Shoqërisë Aksionare «Agjencia Informative Mediatike» - Shkup në pronësi shtetërore (MIA).

MIA funksionon pa sistem të dizajnuar në mënyrë përkatëse për kontrolle të brendshme, para së gjithash në pjesën e punës së thesarit dhe në llogaritjen dhe pagesës së rrogave.

Janë konstatuar dobësi në inventarin e kryer të detyrimeve për shkak të bazës juridike të papërcaktuar për ekzistencën e tyre dhe strukturës së moshës së tyre, me qëllim të iniciohen procedura për arkëtimin e tyre.

Për kryerjen e papenguar të shërbimeve gazetareske dhe të korrespodencës nga qytete të tjera në RMV dhe jashtë saj dhe përpunimin e lajmeve, MIA angazhon bashkëpunëtorë të jashtëm për çka lidhen marrëveshje për të drejtat e autorit nëpërmjet agjencisë, e cila llogarit dhe paguan honorarët. Gjatë revizionit, me kërkesë, u bë rimbursim i mjeteve në llogarinë e MIA-s, në bazë të tatimit mbi të ardhurat personale të llogaritura më tepër dhe të paguara. Rekomanduam kryerjen e kontrollit të të gjithë dokumentacionit mbi këtë bazë.

MIA është themeluar me Vendim të Kuvendit të RMV nga viti 1992, i cili parashikon që financimi të bëhet nga Buxheti i RMV në shumë prej 50.000 mijë denarë dhe nga të ardhurat vetanake nga shitja e produkteve dhe shërbimeve. Financimi i deritanishëm i MIA-s, sugjeron në nevojën për rregullim sistematik të mënyrës së financimit të operacioneve të MIA-s, si një shërbim gazetaresk-mediatik me interes shtetëror dhe publik.

## INSTITUCIONE NACIONALE NGA FUSHA E KULTURËS

Në vitin 2019, sipas Programit Vjetor të Punës së Entit Shtetëror për Revizion, janë kryer revizione të rregullshmërisë në tre institucione nacionale në fushën e kulturës, përkatësisht: „Teatri Kombëtar i Maqedonisë", Muzeu i Luftës së Maqedonisë për Pavarësi„ në Shkup dhe „Institucioni Nacional Qendra e Kulturës Ivo Antevski Smok" në Tetovë. Këto institucione nacionale janë themeluar për realizimin e interesit nacional në fushën e kulturës.



Disa nga gjendjet e përcaktuara janë të përbashkëta për tre institucionet nacionale dhe ato janë të rëndësishme për secilin institucion në veçanti:

- nuk është vendosur sistemi i kontrolleve dhe procedurave të shkruara për lëvizjen e dokumentacionit, në të cilat do të përkufizohen dhe përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë në lidhje me konfirmimin e kompletësisë dhe besueshmërisë së dokumentacionit;
- pozicionet e bilancit në raportet financiare janë vlerësuar në mënyrë joreale, dhe inventari i mjeteve, arkëtimeve dhe detyrimeve me gjendjen përfshirë datën 31 dhjetor 2018 është i paplotë dhe gjendja e kontabilitet nuk e harmonizuar me gjendjen aktuale në kushte kur institucionet nuk kanë emëruar kontabilistë përgjegjës;
- planifikimi i prokurimeve publike është joefikas dhe nuk kryhet në bazë të nevojave reale dhe shpenzimeve dhe janë identifikuar parregullsitë në zbatimin e procedurave të prokurimit publik;
- nuk është siguruar dokumentacioni mbështetës përkatës për realitetin dhe objektivitetin e një pjese të shpenzimeve të evidentuara;
- në IN Teatri Popullor i Maqedonisë për të njëjtin vend pune me të njëjtën shkallë të kompleksitetit, realizuesve të ndryshëm u paguhen paga me koeficientë të ndryshëm të kompleksitetit, gjë që i vë të punësuarit në pozitë të pabarabartë;
- në IN Teatri Popullor i Maqedonisë vitet e kaluara janë ndërmarrë detyrime financiare mbi mjetet e siguruara nga Ministria e Kulturës dhe burime të tjera, gjë që vë në pikëpyetje shlyerjen e tyre si dhe zbatimin e plotë të Programit Vjetor;
- të ardhurat nga marrja me qira e sallave të IN Teatri Popullor i Maqedonisë u realizuan pa një listë çmimesh për llojin e shërbimit dhe kompensimin për realizimin e saj;
- në IN QK Ivo Antevski Smok Tetovë, Bordi drejtues nuk është i konstituuar dhe nuk funksionon në përbërje të plotë, për shkak të të cilit nuk është aprovuar Draft Programi Vjetor për vitin 2018 dhe nuk është miratuar Raporti Vjetor për punën dhe Llogaria Përfundimtare për vitin 2018 e institucionit;
- në IN QK Ivo Antevski Smok Tetovë për të ardhurat e realizuara nga qiradhënia e hapësirës afariste, nuk është realizuar asnjë procedurë për ankand publik në përputhje me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të objekteve afariste dhe hapësirave afariste të RMV, me çka të ardhurat janë realizuar në shumë më të vogël, sepse është realizohet në bazë të marrëveshjeve të vjetra nga viti 2004 dhe 2005 dhe me një çmim më të ulët se ai i përcaktuar me ligj;
- detyrimet në bazë të TVSH-së që paraqesin detyrime të transferuara të institucionit nuk janë evidentuar në evidencën kontabiliste, nuk janë deklaruar në deklaratën tatimore dhe pagesa e tyre nuk është bërë. Detyrimet për TVSH-në rrjedhin nga investimi kapital - ndërtimi i Teatrit dhe Bibliotekës në Tetovë, për të cilat nga fillimi i investimit deri në periudhën e revizionit, pas situatave të përkohshme, janë paguar mjete në vlerë prej 750.139 mijë denarë;
- muzeu i Luftës së Maqedonisë për Pavarësi nuk ka kryer revizion të sendeve muzeore në përputhje me Ligjin për Muzetë, i cili përcakton se muzetë kërkohet të kryejnë revizion të sendeve muzeore të paktën çdo 5 vjet, në mënyrë që të përcaktojnë gjendjen e objekteve muzeale dhe nevojën për të marrë përsipër masat e duhura për mbrojtjen e tyre efektive dhe
- Në Muze, në procesin e realizimit dhe evidentimit të të ardhurave nga shitja e biletave, janë identifikuar rreziqe që mund të ndikojnë në saktësinë dhe tërësinë e të ardhurave.

Për tejkalimin e gjendjeve, janë dhënë rekomandime me zbatimin e të cilave do të tejkalohen gjendjet e konstatuara.

*Në vitin 2019, nga Ministria e Kulturës është bërë nivelizimi i pagave të të punësuarve në institucionet në fushën e kulturës në nivelin e veprimtarive, me lidhjen e Aneksit të Marrëveshjeve Kolektive për zbatimin e koeficientëve të nivelizuar.*

# BYROJA PËR ZHVILLIM RAJONAL

Me revizionin e raporteve financiare për vitin 2018 me revizionin e pajtueshmërisë së Byrosë për Zhvillimin Rajonal janë konstatuar gjetjet që kanë të bëjnë me sistemin e kontrolleve të brendshme, pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret dhe raportet financiare, si vijon:

- Nuk është vendosur sistem i kontrollit të brendshëm dhe nuk është miratuar asnjë procedurë për lëvizjen e dokumentacionit dhe sistem për monitorimin dhe kontrollin e dokumentacionit të kontabilitetit;
- Byroja nuk ka procedurë të brendshme për mënyrën dhe procedurën e pranimit të projekteve, përgatitjen e Listave për propozim projektet, dëshmi për nivelin e përcjelljes së tyre në Komisionin e Vlerësimit të Projekteve, si dhe mënyrën e kryerjes së kontrollit në terren, që rezulton në rrezik në besueshmërinë, tërësinë dhe realitetin në veprimet e Byrosë në lidhje me projektet e pranuara;
- Avanset janë paguar në bazë të dy Programeve për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2018 me përfundimin e Aneksit ndaj marrëveshjeve themelore në dhjetor të vitit 2018, me ç 'rast fondet u janë paguar Qendrave për Zhvillim Rajonal me detyrimin të njëjtat të qëndrojnë në llogarinë e tyre, derisa të marrin me shkrim pëlqimin nga Byroja për të bërë pagesa për furnizuesit;
- Në raportet financiare, janë evidentuar kredi afatgjata dhe hua të dhëna në vlerë prej 132.377 mijë denarë, për të cilat Byroja nuk ka prova, gjendja buron nga vitet e kaluara, dhe i referohet mjeteve të trashëguara nga Fondi Republikan për Kreditimin e Zonave Ekonomikisht të Pazhvilluara.



Janë identifikuar gjendje si pasojë e dobësive në zgjidhjen ligjore për zhvillim të barabartë rajonal si dhe gjendje të mos implementimit të dispozitave ligjore nga organe të tjera kompetente, ndërsa të cilat kanë ndikim mbi punën e subjekteve të reviduara. Këto gjendje, shpresojmë se do të jenë lëndë e interesit të organeve kompetente, me qëllim tejkalimin e tyre dhe përmirësimin e gjendjeve për të inkurajuar zhvillimin e barabartë rajonal. Në këtë drejtim, theksohet si vijon:

- Qeveria e RMV-së ka miratuar dy programe për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2018, për të cilat janë planifikuar mjete në buxhetet e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe Byrosë për Zhvillimin Rajonal për të njëjtat aktivitete, personi përgjegjës i Byrosë lidh marrëveshje në emër dhe për llogari të MVL, nga Byroja bëhet monitorimi mbi zbatimin e projekteve nga të dy programet, që rezulton me përputhjen e veprimtarive dhe rrezik nga gabime të mundshme në pagesën në bazë të Programeve për zhvillim të barabartë rajonal. Revizioni konsideron që Qeveria e RMV-së duhet të marrë parasysh mundësinë e miratimit të vetëm një Programi për zhvillim të barabartë rajonal për realizimin e të cilit Byroja do të jetë përgjegjëse.
- Për vitin 2018, për inkurajimin e zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i RMV-së nuk janë akorduar mjete të paktën 1% nga BPV, të përcaktuar me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal. Revizioni thekson se nëse merren parasysh mjetet për zhvillim të parashikuara në programet sektoriale të shfrytëzuesve të tjerë të buxhetit, përqindja do të jetë afër kufirit ligjor, por duhet të merret parasysh fakti se shpërndarja e mjeteve nuk bëhet sipas Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal dhe shkalla e zhvillimit të rajoneve planore, përkatësisht nuk respektohet parimi i «barazisë» gjatë shpërndarjes së mjeteve në të gjitha rajonet planore, gjatë çka nuk ka këqyrje në mënyrën e realizimit të të njëjtave. Kjo mënyrë e ndarjes së mjeteve nga Buxheti i RMV-së nuk mundëson realizimin e masave dhe instrumenteve specifike që synojnë uljen e pabarazive rajonale dhe arritjen e një zhvillimi rajonal të barabartë dhe të qëndrueshëm në RMV-së.

## DREJTORIA PËR PUNË HIDROMETEOROLOGJIKE

Është kryer revizion i rregullshmërisë për vitin 2018 u në Drejtorinë për Punë Hidrometeorologjike dhe u konstatuan gjendje të caktuara.

Në drejtori, puna karakterizohet me mospërputhje gjatë përllogaritjes dhe pagesës së rrogave. Për gjendjen e mjeteve, obligimeve dhe detyrimeve, është kryer një inventar i pa plotë, me çka pjesërisht është konfirmuar gjendja e pronës. Në disa procedura është konstatuar respektim jo i plotë i dispozitave të Ligjit për prokurime publike Mjetet e realizuara të shërbimeve për meteorologji, matje hidrologjike, shërbime për monitorimin e gjendjes me mjedisin jetësor të ndotur janë paguar në llogarinë e Drejtorisë edhe pse në pajtim me rregullativën ligjore paraqesin të ardhura të Buxhetit të RMV-së.

*Qeveria e RMV-së, në mars të vitit 2020, e angazhoi Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave - Drejtorinë për Punë Hidrometeorologjike, t'i qasen përpilimit të Planit të Veprimit me aktivitete saktësisht të përcaktuara, afate dhe bartës të implementimit të rekomandime të dhëna në Raportet përfundimtare të Revizorit të autorizuar shtetëror.*

*Më datë 18.03. 2020 Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike dorëzoi informacion te Enti Shtetëror për Revizion, me çka informoi se në pjesën më të madhe është vepruar ose është në rrjedhë veprimi në lidhje me rekomandimet e Raportit përfundimtar të Revizorit të autorizuar shtetëror.*

## ARSIMI I LARTË

Në fushën e arsimit të lartë, është kryer revizion i raporteve financiare për vitin 2018 me revizion të pajtueshmërisë në Universitetin «Nënë Tereza» në Shkup.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 25.12.2015, miratoi Ligjin për themelimin e Universitetit «Nënë Tereza» në Shkup, si institucioni më i lartë i arsimit të lartë autonom dhe shkencor me 5 njësi në përbërjen e tij, përkatësisht: Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, Fakulteti i Shkencave të Informatikës, Fakulteti i Shkencave Teknike, Fakulteti i Shkencave Teknologjike dhe Fakulteti i Shkencave Sociale.

Që nga fillimi i kunstituimit me Senatin e Universitetit e deri në gjysmën e parë të vitit 2019, udhëheq dhe kryeson Rektori i Universitetit, megjithëse sipas Ligjit për Arsimin e Lartë Rektori dhe Prorektorët nuk kanë të drejtë të zgjidhen Kryetarë të Senatit. Moszbatimi i dispozitave ligjore për zgjedhjen e Kryetarit të Senatit ka një ndikim në ligjshmërinë dhe funksionimin statutor të Senatit, si dhe në vendimmarrjen. Nga Universiteti nuk është themeluar Këshilli Universitar si organ kompetent në mbikëqyrjen e kryerjes së veprimtarive të Universitetit.

Në kuadër të Universitetit për tre fakultete, nuk plotësohet kushti që të paktën 10 persona me tituj shkencorë arsimor, të punësohen me orar të plotë për mësimin e programeve studimore, për të cilat është siguruar akrediti mi. Gjendja e këtillë ka ndikim mbi funksionimin e përgjithshëm të procesit mësimor dhe realizimin e planit zhvillimor për mbajtjen e mësimit.

Me këqyrjen e kryer në një pjesë të dosjeve personale të kuadrit shkencor arsimor, revizioni konstatoi se të njëjtat nuk përmbajnë dokumentacionin e plotë dhe të vlefshëm me të cilin do të vërtetohej plotësimi i kushteve dhe kritereve për zgjedhje në tituj shkencor arsimor.

Në një pjesë e vendime për zgjedhjen e titullit mësimor - shkencor nuk është specifikuar afati për zgjedhjen e parashikuar me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, i cili rregullon se docent, profesor in ordinar dhe profesori ordinar, zgjidhen për periudhë prej pesë vjet. Pas përzgjedhjes së kryer, me personat janë lidhur kontrata pune në titullin për të cilin janë zgjedhur për kohë të pacaktuar.

Sa i përket përdorimit të mjeteve, është konstatuar pagesa e kompensimit të pagës për aktivitete të kryera jashtë detyrimeve të zakonshme të punës, bazuar në vendimet e miratuara nga Rektori me shuma kuturu, pa kritere / pikë të sakta për shpërndarjen e mjeteve, në varësi të vëllimit dhe shkallës së kompleksitetit të punëve të kryera dhe detyrat e punës.

Shpërndarja e mjeteve në bazë të participacionit dhe bashkëfinancimit për studim kryhet pa Rregullore për shpërndarjen e brendshme të financave.

Inventari i mjeteve dhe detyrimeve me gjendjen përfshirë datën 31 dhjetor 2018 nuk është kryer në mënyrën e parashikuar me rregullativën ligjore.

Është siguruar objekt me Vendim për dhënien në përdorimit të përhershëm të pasurive të patundshme, por për të njëjtin objekt nuk ka evidencë në kontabilitet, që ka ndikim në realitetin dhe objektivitetin e gjendjeve të paraqitura të mjeteve në librat afariste.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime tek shërbimet dhe organet kompetente.

## INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE



Mbrojtja shëndetësore përfshin sistem të masave shoqërore dhe individuale, aktivitete dhe procedura për: ruajtjen dhe promovimin e shëndetit, parandalimin, zbulimin e hershëm dhe ç 'rrënjosjen e sëmundjeve, lëndime dhe çrregullimeve të tjera shëndetësore, trajtim në kohë dhe efektiv, kujdes shëndetësor dhe rehabilitimit. Veprimtaria shëndetësor është me interes publik dhe kryhet në nivelin primar, sekondar dhe terciar të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private.

Me revizionet e kryera për rregullshmërinë e sistemit shëndetësor, janë konstatuar gjendje të cilat në masën më të madhe përsëriten si edhe në periudhën e kaluar raportuese, dhe ndër të tjerat u referohen:

- akteve të pa harmonizuara për organizim të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës me legjislacionin përkatës;
- inventarizimi i kryer jo plotësisht i mjeteve dhe detyrimeve;
- mungesa e regjistrave të plotë dhe të azhurnuar të pajisjeve mjekësore dhe krijimi i një sistemi efikas për monitorimin dhe mirëmbajtjen e tij;
- parregullsi në mënyrën e regjistrimit të mjeteve të siguruara nga donacione;
- evidencë jo adekuate e pranimit dhe konsumit të stoqeve të ilaçeve dhe furnizimeve mjekësore për njësi organizative dhe për pacient;
- mos sigurimi i plotësisë së të ardhurave për shërbimet shëndetësore të kryera;
- mos ndërmarrja e aktiviteteve për arkëtimin në kohë të detyrimeve për shërbime të kryera shëndetësore;
- shlyerja selektive dhe jo-kronologjike e detyrimeve të maturuara;
- sistem elektronik i vendosur jo plotësisht për regjistrimin e orarit të punës dhe mospërputhjet në përllogaritjet dhe pagesat e pagave dhe kompensimeve nga paga;
- pagesa të paligjshme të shpërblimeve me para për të punësuarit dhe
- zbatimi jo konsekuent i dispozitave të Ligjit për prokurime publike në procedurat për dhënien e kontratave për prokurim publik dhe monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura.

Janë dhënë rekomandime për gjendjet e konstatuara, zbatimi i të cilave do të tejkalojë këto gjendje.

*Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të gjitha raportet e paraqitura të revizionit, miratoi konkluzione me të cilat Ministria e Shëndetësisë duhet të detyrojë Institucionet e Shëndetit Publik, lëndë e revizionit të përgatisin plan veprim, me aktivitete saktësisht të përkufizuara, afate dhe bartës të implementimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror.*

## VETËQEVERISJA LOKALE

Gjatë vitit 2019 është kryer revizion i rregullshmërisë për vitin 2018, në dy njësi të vetëqeverisjes lokale, në Komunën e Strugës dhe Gostivarit, ku janë konstatuar gjendjet si më poshtë:

Gjatë vlerësimit të sistemit të kontrolleve të brendshme në procese të caktuara, në komunat ku është kryer revizioni u përcaktua se i njëjti është vendosur pjesërisht ose nuk është vendosur ose nuk funksionon në procesin e grumbullimit të të ardhurave dhe realizimin e shpenzimeve dhe në procesin e planifikimit të buxhetit komunal, për shkak të të cilit, ekziston rrezik për mungesën e tërësisë dhe afatit të realizimit të të ardhurave në pjesën e tatimeve mbi pronën dhe taksën komunale për theksimin e firmës, si dhe rrezik për miratimin e buxhetit bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara në mënyrë joreale.

Në kushte të reterimit të konsiderueshëm ndërmjet të ardhurave të planifikuara dhe të realizuara dhe shpenzimeve të buxhetit, nuk është vepruar në përputhje me rregullativën ligjore dhe nuk është miratuar ribalanci (ndryshime dhe plotësime të buxhetit) ose edhe në kushte të miratimit të ribalancit të buxhetit nuk është kryer harmonizimi i tyre, që krijon mundësi për ndërmarrjen e obligimeve për të cilat realisht nuk janë siguruar mjete në buxhet dhe transferimi i tyre në vitin e ardhshëm fiskal. Për këtë dukuri të buxhetimit jo real në pjesën e njësive të vetëqeverisjes lokale, Enti Shtetëror për Revizion, raportoi në raportet individuale të revizionit, si dhe në raportet vjetore të mëparshme.

Te njësitë e vetëqeverisjes lokale ku është kryer revizion, buxheti nuk përmban pjesën zhvillimore, përkatësisht plane të programeve për zhvillim, nuk janë miratuar programe vjetore për rregullimin e tokës ndërtimore dhe për punë nga fusha e disponimit me tokën ndërtimore në pronësi të RMV-së, nuk janë përpiluar raporte vjetore për shfrytëzimin e mjeteve nga kompensimi për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, ndërsa raportet vjetore për punën e komunës për vitin 2018 nuk janë kompletuar.

Regjistrat e pronës së tundshme dhe të patundshme të tatim paguesve nuk janë të plota ose mbahen në mënyrë jo përkatëse, dhe është kryer inventari jo i plotë i detyrimeve (baza juridike dhe struktura e vjetërsisë), për të cilat raporti i inventarit nuk është miratuar në kohë, nuk janë paraqitur në mënyrë reale detyrimet në bazë të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, tatimet mbi pronën dhe taksat komunale në librat afariste dhe raportet financiare, nuk janë ndërmarrë masa dhe aktivitete në kohë për arkëtimin e detyrimeve për sçka një pjesë e tyre maturohen dhe nuk ka mundësi për arkëtim.

Në Komunën e Gostivarit, përcaktimi i arkëtimit të tatimit mbi pronën të tokës ndërtimore dhe bujqësore kryhet në pajtim me Vendimin e miratuat për përcaktimin e zonave për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme - tokë ndërtimore, oborr dhe tokë bujqësore, e cila nuk është harmonizuar me Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të tregut të pronës së patundshme që shkakton më pak të ardhura të realizuara mbi këtë bazë.

Nuk është kryer inspektim mbi arkëtimin e taksës për qëndrim të përkohshëm për vitin 2018, nuk realizohen të ardhura nga kompensimi për mirëmbajtjen e pastërtisë publike dhe të ardhura nga taksa komunale për përdorimin e muzikës në lokalet publike, ndërsa taksa komunale për përdorimin e sheshit dhe hapësirës tjetër në qytetet dhe vendbanimet të tjera me qëllim ekspozimin e sendeve, organizimin e ekspozitave dhe manifestimeve argëtuese për kryerjen e veprimtarive nuk arkëtohen në pajtim me Vendimin për lartësinë e taksave komunale.

Për tokën ndërtimore të ndarë për qira për plazhe nga komuna e Strugës, nuk janë ndërmarrë masa për veprim në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe për mos respektimin e dispozitave nga marrëveshjet e lidhura me qiramarrësit, për çka jepet mundësia për shfrytëzim të pa drejtë të tyre dhe bëhet mos realizmi i plotë i të ardhurave mbi këtë bazë.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku është kryer revizioni, janë konstatuar raste të mos respektimit të dispozitave ligjore dhe akteve të brendshme, ndërsa kanë të bëjnë me mënyrën e mbajtjes së librave afariste, dokumenteve të kontabilitetit, inventarizimi, prezantimi i të dhënave në raportet financiare, shpenzime kapitale, pagesa të mjeteve mbi baza të ndryshme, prona e pa evidentuar, mos sigurimi i fletës pronësore për pronë të fituar me ndarjen e bilanceve.

Për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm ndërmjet Komunës dhe njësive shfrytëzuese të mjeteve nga bllok dotacionet, jo transparenca gjatë shpërndarjes së bllok dotacioneve sipas njësive shfrytëzuese, në llogari të të ardhurave të buxhetit të dotacioneve, në fund të vitit 2018 ka mjete pagesore të pa përdorura, ndërsa njëkohësisht njësitë shfrytëzuese kanë detyrime të pa shlyera.

*Gjatë vitit 2020, nga revizioni është kryer kontroll mbi masat e ndërmarra në lidhje me gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna të përfshira në raportin përfundimtar, gjatë çka është konstatuar se nga personi përgjegjës i Komunës së Strugës dhe Komunës së Gostivarit janë ndërmarrë masa dhe pjesa më e madhe e dobësive të identifikuara janë tejkaluar.*

## NP PARKINGU I QYTETIT TETOVË

Gjatë vitit 2019, është kryer revizion i rregullshmërisë për vitin 2018, në Ndërmarrjen Publike Parkingu i Qytetit Tetovë. Ndërmarrja Publike gjatë vitit 2018 punon në kushte kur drejtori i NP «Parkingu i Qytetit - Tetovë» nuk është përzgjedhur në konkurs publik, dhe ndërmarrja drejtohet nga ushtruesi i detyrës, drejtor, që nga themelimi i ndërmarrjes në vitin 2014. Numri i anëtarëve të Bordit drejtues është zgjedhur me Vendim të Këshillit të Komunës së Tetovës, është më i madh se numri i përcaktuar me Statutin.

Kompetencat e veta i kryen pa sistem të vendosur mirë të kontrollit të brendshëm, me çka është zmadhuar rreziku në pjesën e pranimit dhe lëvizjes së dokumentacionit, përllogaritjes së pagës dhe arkëtimit të plotë dhe në kohë të të ardhurave.

Gjatë vitit 2018 ndërmarrja publike është ngarkuar me borxh përmes marrëveshjeve të huas pa miratimin e aktit nga Bordi Drejtues dhe themeluesi Komuna e Tetovës.

Për patundshmëritë, stabilimentet, pajisjen, mjetet jo materiale, mjetet pagesore dhe mjetet të tjera rrjedhëse dhe obligimet rrjedhëse nuk është kryer inventarizimi me çka është rritur rreziku nga evidentimi i plotë dhe në kohë i shfrytëzimit me dedikim të mjeteve dhe konfirmimin e detyrimeve të pa arkëtuara dhe të pa paguara. Ndërmarrja publike funksionon me rrezik të lartë kontrollues për shkak të faktit se nuk është vendosur puna arkëtuese në pajtim me rregullativën ligjore, që ka shkaktuar dallime ndërmjet mjeteve pagesore te paraqitura në raportet financiare - Bilanc i gjendjes dhe i llogarisë në bankë.

Për tejkalimin e gjendjeve janë dhënë rekomandime me implementimin e të cilave, gjatë periudhës së ardhshme pritet të tejkalohen gjendjet e konstatuara.



## SHOQËRIA AKSIONARE NË PRONËS SHTETËRORE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE NË NAVIGACIONIN AJROR M - NAV SHA SHKUP

Është kryer revizion i rregullshmërisë për vitin 2018 i shoqërisë aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë ofrim të shërbimeve në navigacionin ajror M-NAV SHA Shkup, me të cilin janë përcaktuar gjendjet si vijon:

- Shoqëria aksionare për financimin e «Projektit për përmirësimin e sistemit maqedonas për navigim ajror - faza e dytë» në shumë prej 11.150.000 euro përdori mjete në bazë të Marrëveshjes së Huasë me BERZH-in, por afatet për implementimin e komponentëve të projektit prolongohen vazhdimisht, me përdorim minimal të fondeve të kredisë brenda periudhës së parashikuar, kështu që sistemet e nevojshme ende nuk janë në funksion operativ, që e rrit rrezikun për sigurimin jo në kohë të mbindërtimeve sistemore të nevojshme.
- Kriteret për punësim, mënyra e rishpërndarjes së punonjësve ekzistues, llogaritja dhe pagesa e shtesës për punë jashtë orarit nuk janë në përputhje me rregullat ligjore dhe aktet e brendshme të shoqërisë.
- Për ndërtesën administrative të ndërtuar aktivitetet e së cilës kanë përfunduar në prill të vitit 2017, dhe për të cilën shoqëria paraqitet si bashkë-investitor, janë konstatuar parregullsi në lidhje me sipërfaqen faktike që i përket shoqërisë, nuk është kryer inspektim teknik i konstruksionit, nuk është dhënë aprovim për përdorim si dhe nuk është kryer regjistrimin e tij në librin publik të patundshmërive.
- Raportet financiare nuk shpalosin në mënyrë reale dhe objektive mjetet me të cilat disponon shoqëria. Përkatësisht, në librat tregtarë nuk është evidentuar toka në pronë të shoqërisë, ndërsa objektet që i përdor për punën e saj ende janë në procedurë te legalizimit dhe regjistrimit të së drejtës për përdorim. Gjatë përllogaritjes së amortizimit të mjeteve jo materiale nuk është marrë parasysh koha e përdorimit, ndërsa inventarizimi i mjeteve dhe detyrimeve për vitin 2018 nuk është realizuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt.
- Në lidhje me detyrimet e pa arkëtuara është konstatuar se një pjesë e detyrimeve të pa paguara nuk janë shlyer, një pjesë janë shlyer pa Vendim të Bordit drejtues, ndërsa për një pjesë të tyre nuk janë ndërmarrë masa për pagesën ë tyre dhe për kthimin e tatimit të paguar si tepricë.
- Gjatë prokurimit të mallrave dhe shërbimeve nuk është vepruar në tërësi në pajtim me Ligjin për prokurime publike në lidhje me nevojat e planifikuara dhe reale.

Për tejkalimin e gjendjeve në fjalë janë dhënë rekomandime me implementimin e të cilave pritet të tejkalohen gjendjet e konstatuara.

Në pjesën, Theksimi i çështjeve për pavarësinë edhe vazhdimësinë e zbulimit është se Bordi drejtues i shoqërisë, nga marsi i vitit 2018 punon me përbërje jo të plotë, që ka pasur ndikim mbi kryerjen e kompetencave të tij, në veçanti në pjesën e miratimit të Vendimeve ligjore dhe të besueshme.

M-HAB

## SH.A. POSTA E MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me Ligjin për shërbime postare, SHA «Posta e Maqedonisë së Veriut» është subjekti i vetëm i cili nga Agjencia për Posta ka fituar lejen individuale për sigurimin e Shërbimit postar universal, përfshirë shërbimet e rezervuara postare dhe shërbimet postare të cilat kryhen në tregun e lirë postar.

Ndarja e pronës që ka filluar në vitin 2000 ndërmjet SHA Posta dhe Telekomit të Maqedonisë ende nuk ka përfunduar që ka ndikim mbi të dhënat e paraqitura në raportet financiare për vitin 2018.

Të ardhurat nga shërbimet postare të cilat realizohen në të gjithë territorin e shtetit, janë organizuar në 15 njësi rajonale, në kuadër të të cilave ka 326 njësi të rrjetit postar me 502 sportele, nuk është fituar bindja se janë paraqitur në tërësi në raportet financiare dhe vlerësimin e rregullt të shkaqeve që flet për sistem kompleks për të cilin nuk është dizajnuar zgjidhje aplikative përkatëse.

Për kryerjen e revizionit të shërbimeve postare të cilat kanë të bëjnë me dërgesa deri më 20 gram, për shfrytëzues të madh me vëllim prej rreth 800 mijë dërgesa, duke filluar nga viti 2010 është aprovuar lirim prej 50% të çmimit të rregulluar për shfrytëzues të madh për të cilët SHA Posta ka ekskluzivitet dhe çmim të garantuar.

Në raportet financiare janë pranuar detyrimet në bazë të shkurtimeve nga puna arkëtare në njësitë e rrjeteve postare të cilat kanë të bëjnë me shkurtime nga mashtrimet nga të punësuarit, vjedhje ose plaçkitje, por nuk është bërë vlerësimi përkatës edhe përskaj asaj se ekzistojnë indikacione për zhvlerësimin e këtyre mjeteve, përkatësisht të njëjtat nuk mund të arkëtohen.

Për tejkalimin e gjendjeve, janë dhënë rekomandime me zbatimin e të cilave do të tejkalohen gjendjet e konstatuara.

Në pjesën Çështje të tjera janë theksuar gjendjet të cilat kanë të bëjnë me marrëveshjen e re për bashkëpunim afarist teknik dhe marrëveshjen për kompensime ndërmjet SHA Posta dhe bankës afariste, trashëgimtar juridik i Bankës postare. Marrëveshja është specifike dhe komplekse, negociatat janë zhvilluar për dy vjet, është përcaktuar një bashkëpunim afatgjatë prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh dhe ai ka një ndikim të rëndësishëm në funksionimin e SHA Posta.

# REALIZIMI I KUADRIT ME ARSIMI TË LARTË NË TREGUN E PUNËS NË RMV

Kryem revizion të suksesit me temë «Realizimi i kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës në RMV» për periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2018, si pilot revizion në kuadër të tvining projektit në bashkëpunim me ILR të Republikës së Bullgarisë.

Qëllimi i revizionit ishte të japim përgjigje në pyetjen nëse aktivitetet e organeve shtetërore për zbatimin e politikës së arsimit të lartë dhe promovimin e punësimit, mundësojnë efikasitet gjatë punësimit të kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës në RMV.




Aktivitetet kryesore në zbatimin e politikës për arsimin e lartë dhe promovimin e punësimit kryhen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Bordi për Akreditim dhe Vlerësim të Arsimit të Lartë (BAVAL) është përgjegjës për akreditimin dhe vlerësimin e arsimit të lartë, ndërsa Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV) është përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive në lidhje me ndërmjetësimin gjatë punësimit. Për qëllimet e revizionit, kemi analizuar informacionin dhe të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat (IAL).

Në lidhje me rregullativën ligjore dhe dokumentet strategjike, u përcaktua se:

- në dokumentet strategjike nacionale të miratuara të MASH dhe MPPS janë parashikuar aktivitete dhe masa të cilat sigurojnë vizion për zhvillim të arsimit të lartë dhe realizimin e kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës në RMV;
- ka nevojë për rregullim plotësues të kompetencave të MASH si organ shtetëror për zbatimin e politikës nacionale për arsim të lartë dhe themelimin e trupave të rëndësishëm dhe akte në lidhje me arsimin e lartë;
- në përputhje me Ligjin për Punësimin dhe Sigurimin në rast të Papunësisë, miratohen plane operative për masa aktive dhe programe punësimi, si mbështetje, ndihmë dhe shërbime për pjesëmarrësit në tregun e punës.

Në fushën në të cilën i përfshimë masat dhe aktivitetet e institucioneve kompetente për realizimin e kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës në RMV, janë konstatuar këto gjendje:

### Arsim

- Ekziston mungesë e mekanizmave ligjore dhe kritere për vlerësim të nevojës për akreditim në IAL ose program studimor në pajtim me nevojat e tregut të punës, ndërsa mos zbatimi i evaluimit të jashtëm nga BAEAL, nuk mundëson dhënien e rekomandimeve për avancim në punë në IAL;
- numri i përgjithshëm i studentëve për regjistrim në ciklin e parë të studimeve përcaktohet nga Qeveria e RMV vetëm për IAL - publike;
- mekanizmi i vendosur për financimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, pa përcaktimin e masave dhe kritereve reale për përcaktimin dhe shpërndarjen e mjeteve në IAL, nuk siguron transparencë të mjaftueshme dhe objektivitet për financimin e IAL;

- MASH ende nuk e ka vendosur bazën e të dhënave të përcaktuar me ligj, si sistem informimi i cili do të ofrojë informacione të integruara për monitorimin e veprimtarisë së arsimit të lartë dhe analiza në fushën e arsimit të lartë, me qëllim përshtatjen e programeve studimore dhe punësimin më të lehtë të studentëve të diplomuar.
- Në rrjedhë janë aktivitetet për dizajnimin dhe implementimin e sistemit informativ për menaxhim me arsimin e lartë, me të cilin pritet MASH të kryejë monitorimin e suksesshëm dhe analizën e të dhënave në lidhje me arsimin e lartë në RMV, monitorim të proceseve dhe rezultateve të IAL.

## Tregu i punës

- MPPS dhe APRMV, grumbullojnë informacione për nevojat për shkathtësi të cilat duhet t›i posedojnë personat e papunësuar që të jenë konkurrues në tregun e punës, ndërsa përdoren edhe gjatë krijimit dhe implementimit të politikave në tregun e punës;
- analizat treguan se numri i të papunësuarve me arsim të lartë zvogëlohet, por përqindja e pjesëmarrjes së personave me arsim të lartë të cilët presin punësim mbi 36 muaj shënon rritje të butë në raport me numrin e përgjithshëm të personave të papunësuar me arsim të lartë:

Periudha më e gjatë e pritjes për punësim mund të shkaktojë pasoja negative, gjegjësisht margjinalizimin dhe zvogëlimin e mundësive për punësim për njerëzit e papunë me arsim të lartë.

Struktura e të papunësuarve me arsim të lartë-kërkues aktiv të punës pas një periudhe pritjeje për punësim




## Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente




Komunikimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve, ndërmjet institucioneve kompetente është i rëndësishëm për vendimmarrje dhe për marrjen e masave dhe aktiviteteve që synojnë harmonizimin e ofertës dhe kërkesës së kuadrit me arsim të lartë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe të nivelit kombëtar.

- Ligji për Arsimin e Lartë nuk parashikon mekanizëm për bashkëpunim, grumbullimin, shkëmbimin dhe analizën e informacionit në fushën e arsimit të lartë dhe punësimin e studentëve të diplomuar;
- kanë filluar aktivitete për vendosjen dhe zhvillimin e Observimit për aftësi, rezultatet e së cilës do të përdoren gjatë krijimit të politikave arsimore dhe politikave për punësim;
- duhet të bëhet përforcimi i lidhjes ndërmjet Qendrave për Karrierë dhe Alumni asociacioneve për grumbullimin e informatave kthyese nga tregu i punës;
- ende nuk është zhvilluar sistem për monitorimin e realizimit të studentëve në tregun e punës në RMV, pas përfundimit të studimeve.

Si rezultat i revizionit të kryer është konstatuar se aktivitetet e organeve shtetërore kompetente për zbatimin e politikës arsimore dhe politikave për punësim nuk janë mjaftueshëm efektive për sigurimin e punësimit të kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës në RMV. Nuk janë vendosur mekanizma të mjaftueshme rregullatore për përforcimin e lidhjes ndërmjet arsimit dhe nevojave në tregun e punës dhe monitorimin e realizimit të studentëve në tregun e punës në RMV pas përfundimit të studimeve, me qëllim sigurimin e informacioneve të plota për krijimin më real të politikave nacionale arsimore. Ekziston nevoja për përmirësim dhe zhvillim të sistemit për financimin e arsimit të lartë, si dhe për monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit të lartë. Me zbatimin e plotë të aktiviteteve për hartimin dhe zbatimin e modelit të ri të financimit të arsimit të lartë, modelit të sistemit informatik për menaxhimin e arsimit të lartë, si dhe krijimin dhe zhvillimin e Observatorit të Aftësive, pritet krijimi i kushteve të cilat do të sigurojnë punësimin e kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës së RMV-së.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, janë dhënë rekomandime të cilat janë në funksion të avancimit të mekanizmave rregullatore dhe aktiviteteve të organeve shtetërore për zbatim efektiv të politikave për realizimin e kuadrit me arsim të lartë në tregun e punës së RVM-së.

## MASA, POLITIKA DHE PROJEKTE PËR MBROJTJEN DHE AVANCIMIN E BLETARISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Me qëllim krijimin e gjendjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fushën e Bletarisë, është kryer revizion i suksesit që të japim përgjigje në pyetjen: „Nëse masat dhe politikat e miratuara për bletari në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë efektive dhe sigurojnë zhvillimin dhe avancimin e bletarisë".

Me revizionin u përfshi periudha nga viti 2016 deri në vitin 2018, për fusha të caktuara edhe para vitit 2016, si dhe deri në ditën e raportimit nga revizioni në fjalë.

Për fushën e cila ka të bëjë me rregullativën ligjore dhe nënligjore dhe dokumentet strategjike i përcaktuam gjendjet si më poshtë:

- nuk janë miratuar dokumentet strategjike, planore dhe programore, të parashikuara në rregullativën ligjore dhe në Programin Nacional për Bletari;
- për masat dhe aktivitetet e përcaktuara strategjike në lidhje me parandalimin dhe kujdesin shëndetësor të bletëve, nuk merren masa të mjaftueshme për realizimin e tyre,
- nuk është përpiluar kadastër i kullosave të bletëve;
- me rregullativën ligjore është parashikuar edhe obligimi për inventarizim të familjeve të bletëve nga vetë bletarët, që mund të ndikojë në saktësinë e të dhënave për numrin e familjeve të bletëve;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk kryen kontrollet e detyrueshme të inspektimit mbi bletarët;
- ekziston dallim i madh në përcaktimin e numrin të familjeve nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në raport me të dhënat të cilat janë paraqitur nga Enti Shtetëror i Statistikës, që ka ndikim mbi krijimin përkatës dhe të drejtë të politikave dhe masave nga institucionet kompetente.

Në lidhje me masat për bletari të përfshira në Programet vjetore për mbështetje financiare në bujqësi dhe Programet vjetore për mbështetje financiare të zhvillimit rural, i konstatoi gjendjet në vijim:

- ndryshimet dhe plotësimet e shpeshta të programeve vjetore për mbështetje financiare në bujqësi, me ndryshimet e mëdha në mjetet e planifikuara, krijon pasiguri te shfrytëzuesit e mjeteve;

- në programet vjetore është e lartë pjesëmarrja e obligimeve të pa paguara të shfrytëzuesve nga vitet e kaluara, që ndikon në zvogëlimin e mjeteve të cilat arkëtohen në vitin rrjedhës;
- për Programin vjetor për mbështetje financiare në zhvillimin rural për vitin 2017 dhe 2018 nuk janë publikuar thirrje publike për grumbullimin e kërkesave me çka është zvogëluar transparenca te shfrytëzuesit e mjeteve;
- është e pranishme një dukuri e aprovimit jo në kohë të mbështetjes financiare, si dhe pagesës jo në kohë për shfrytëzuesit, që ndikon në planifikimin e mjeteve te bletarët dhe funksionimin e tyre.

Në periudhën nga viti 2016-2018, është paguar një shumë e përgjithshme e mjeteve prej 403.180 mijë denarë, por pagesa e mjeteve është me dinamikë të zvogëluar, mjetet në program nuk paguhen plotësisht në vitin në të cilin ato janë planifikuar përkatësisht realizohen vitin e ardhshëm, gjë që zvogëlon efektivitetin e financimit të bletarëve.

Me revizionin janë përfshirë edhe ndryshimet klimatike, sëmundjet dhe pesticidet dhe ndikimi i tyre mbi bletën dhe mjaltin, të cilat janë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e bletarisë, gjatë çka janë konstatuar gjendjet si vijon:

- Lista kombëtare e produkteve të aprovuara dhe substancave aktive të Komisionit Evropian nuk publikohen në Gazetën Zyrtare të RMV-së;
- Drejtoria Fito-sanitare nuk shkëmben informacione të mjaftueshëm me institucionet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve dhe substancave aktive që janë aprovuar dhe ato që janë të ndaluara për përdorim;
- nuk kryhet asnjë inspektim mbi përdorimin e produkteve të dëmshme për bletët;
- ende nuk është përcaktuar Laboratori Nacional Referent i cili do të kryejë analiza laboratorike nga fusha e mbrojtjes shëndetësore të kafshëve, sigurisë së ushqimit dhe veterinarisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ka nevojë për veprim të koordinuar të institucioneve kompetente, me përfshirje aktive të bletarëve, në mënyrë që të rritet efektiviteti i masave dhe politikave të miratuara nga institucionet kompetente në drejtim të zhvillimit dhe përparimit të bletarisë si një degë e rëndësishme e prodhimtarisë bujqësore dhe intensifikimi i tij në nivel të veprimtarisë profesionale.

## INTERREG - IPA PROGRAMI PËR BASHKËPUNIM NDËRKUFITAR R. E BULLGARISË - R. E MAQEDONISË 2014 – 2020

Interreg - IPA Program për bashkëpunim ndërkufitar Republika e Bullgarisë - Republika e Maqedonisë 2014 - 2020 është program evropian për bashkëpunim, qëllimi themelor i së cilës është përforcimi i bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet popujve dhe institucioneve nga rajoni, bashkëpunim në fushën e sfidave të përbashkëta dhe zhvillim i potencialit të pa shfrytëzuar.

Programi i përfshin rajonet në nivel NUTS III si vijon: 2 rajone (Bllagoevrad dhe Qystendil) në Bullgari dhe 3 rajone (Rajoni Planor Verilindor, Lindor dhe Juglindor) nga ana maqedonase.

Buxheti i përgjithshëm i programit është 19.461.687 euro, me pjesëmarrjen e BE-së në shumë prej 16.542.434 euro, të shpërndarë në shtyllat me prioritet:

1. PO 1 Mjedisi jetësor në shumë prej 5.789.852 euro (35%),
2. PO 2 Turizëm në shumë prej 6.616.974 euro (40%),
3. PO 3 Konkurrencë në shumë prej 2.481.365 euro (15%),
4. PO 4 Ndihmë teknike në shumë prej 1.654.243 euro (10%).







Në drejtim të realizimit të rezultateve dhe arritjes së qëllimeve të politikës kohezive Evropiane, si dhe në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve që është në nivelin më të lartë, ESHR ka kryer revizion të suksesit me temë «Interreg - IPA Programi për bashkëpunim ndërkufitar R. e Bullgarisë - R. e Maqedonisë 2014 - 2020». Revizioni është kryer në pajtim me Programin vjetor për punë të ESHR për vitin 2018 dhe 2019, në kuadër të tvining marrëveshjes me ILR të Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Kroacisë, i financuar nga mjetet e Bashkimit Evropian.

Me revizionin u përfshi periudha nga viti 2015 deri në vitin 2018 dhe organet / trupat e formuara nga RMV-së ndërsa të cilat marrin pjesë në menaxhimin dhe kontrollimin e programit: Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, njësia rajonale e Sekretariatit të Përbashkët në Strumicë dhe vlerësuesit e pavarur.

Qëllimi i revizionit ishte të vlerësojë efikasitetin e menaxhimit me programin, përkatësisht të jepet përgjigje në pyetjen themelore:

„Nëse menaxhimi me Interreg - IPA Programin për bashkëpunim ndërkufitar R. e Bullgarisë - R. e Maqedonisë 2014-2020 është efektiv? "

Si rezultat i gjendjeve të përcaktuara, përfshirjes dhe provave të cilat janë siguruar me anë të zbatimit të teknikave dhe teknologjike përkatëse të revizionit, revizioni doli me konkluzionin në vijim:

*Vendosja strukturore e organeve, cilësia e projekteve të zgjedhura, transparenca e procesit dhe monitorimi i vendosur, sigurojnë menaxhim efektiv me Interreg - IPA Programin për bashkëpunim ndërkufitar R. e Bullgarisë - R. e Maqedonisë 2014 - 2020.*

Parimet e menaxhimit të përbashkët, struktura organizative e organeve nga pala maqedonase dhe shpërndarja e kompetencave, monitorimi elektronik, menaxhimi dhe aprovimi i aktiviteteve operative sigurojnë kushte të mjaftueshme për funksionim, koordinim dhe implementim të programit. Strategjia e komunikimit, faqja e internetit, fushatat informative, ofrojnë që shfrytëzuesit potencial informacionet t›i pranojnë në kohë, në mënyrë të saktë dhe mundësi ato të jenë të qasshme. Në procedurat për zgjedhje të vlerësuesve dhe projekteve, është respektuar parimi i transparencës dhe vlerësimit objektiv, që siguron zgjedhje të projekteve cilësore dhe realizmin e qëllimeve specifike të programit. Monitorimi i vendosur, raportet vjetore, vlerësimi nga ekspertë të jashtëm, vizitat në vendin e ngjarjes, krijojnë kushte për monitorim efektiv të shkallës së realizimit të projekteve dhe programit. Thirrja e parë e programit ka financuar 48 projekte me shumë prej 10.336.443 euro dhe ato kanë një shkallë të lartë të realizimit prej 95,8%.

Për të rritur efektivitetin e menaxhimit të programeve, nevojiten aktivitete në drejtim të sigurimit të një politike të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve njerëzore, forcimin e kapacitetit administrativ të njësisë rajonale në Strumicë, procedurën e brendshme për lëvizjen e dokumentacionit, shpërndarjen e duhur të aplikacioneve ndërmjet vlerësuesve të jashtëm në pajtim me specializimin e tyre dhe përmirësimit të kritereve të caktuara për sa i përket qartësisë, matjes dhe saktësisë së tyre.

*Bazuar në konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale ka përgatitur plan veprimi me aktivitete saktësisht të përcaktuara, afate dhe bartës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të revizorit shtetëror të autorizuar.*

## PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE PËR SPORTE PËR FËMIJËT NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM PROJEKT PËR NDËRTIMIN E SALLAVE TË SPORTIT NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

Revizioni i suksesit është kryer me qëllim të japim përgjigje në pyetjen: Nëse realizmi i Projektit kontribuon drejt zhvillimit dhe përmirësimit të gjendjeve dhe kushteve për sport për fëmijët në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe të japim vlerësim për:

- Realizimi i Projektit ndërtimi i sallave sportive - ndërtojmë 145 salla sportive dhe
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e sallave sportive dhe rehabilitimin e sallave në shkollat fillore dhe të mesme.



Aktivitetet e revizionit të suksesit kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kompetente të përqendrohen në dobësitë në lidhje me zbatimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të Projektit për ndërtimin e sallave sportive në shkollat fillore dhe të mesme.

Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me atë nëse dhe si zbatohet realizimi i Projektit për ndërtimin e sallave sportive në shkollat fillore dhe të mesme janë konstatuar gjendjet në vijim:

- ekziston dallim në dispozitat e kontratës për ndërtimin e ndërtesave me modelin e kontratës nga dokumentacioni i tenderit;
- është rënduar procesi i dinamikës së punimeve ndërtimore, dhe realizimi fizik është vetëm 51,72% për periudhën 2009-2019;
- afatet e zgjatura për realizimin e punëve ndërtimore nga 3 në 15 vjet për shkak të dobësive nga të dy palët;
- është zvogëluar barra financiare e operatorit ekonomik nëpërmjet zvogëlimit të garancinë bankare për ndërtimet e përfunduara;
- nuk ka të dhëna për plotësimin e obligimeve nga marrëveshjet për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella gjatë ndërtimit të sallës sportive në shkollë ndërmjet palëve pjesëmarrëse në marrëveshjet, me çka nuk ka këqyrje në shfrytëzimin ligjor dhe me dedikim të ndërtimeve të realizuara;
- gjatë përcaktimit të burimeve të financimit të projektit, mjetet nga huat dhe nga buxheti, realizimi i Marrëveshjes për ndërtim dhe pajisje në 145 salla sportive shkollore është rreth 60%, huaja e parë për periudhë prej 12 vjet është realizuar 91% ndërsa huaja e dytë për periudhë prej 7 vjet është realizuar vetëm 56%.

Situata me ndërtimin e sallave sportive ndër vite - realizimi fizik tregohet në grafikun në vijim:



Në lidhje me fushën e cila ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe monitorimin e realizimit të Projektit për ndërtimin e sallave sportive dhe rehabilitimin e sallave në shkollat fillore dhe të mesme, janë përcaktuar gjendjet në vijim:

- nuk është miratuar asnjë akt me kritere me të cilat do të rregullohet lartësia e kompensimeve të Ekipit të projektit i përbërë nga persona të cilat janë të angazhuar me kontratë në vepër;
- mungesa e planeve dinamike të performancës përsëritet në të gjitha raportet mujore të mbikëqyrjes;
- organi koordinues përgjegjës për monitorimin e zbatimit të projektit nuk funksionon dhe
- nuk ka indikatorë për rezultatet e projektit me të cilat do të monitorohet suksesi i zbatimit të tij.

Në drejtim të tejkalimit të gjendjeve të përcaktuara, revizioni i dha këto rekomandime: ndërmarrje e aktiviteteve rreth dinamikës së realizmit të punëve të ngelura ndërtimore në afat më të shkurtë të mundshëm në pajtim me sugjerimet e revizionit, mbulimin e periudhës së garantuar me garancinë bankare në pajtim me marrëveshjen themelore, përcaktimin e mënyrës dhe afateve për kryerjen e kontrollit mbi zbatimin e dispozitave të marrëveshjes për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, miratimin e Buxhetit për Projektin në pajtim me kërkesat e organit kompetent dhe vendosjen e indikatorëve real dhe të matshëm për monitorimin e realizmit të Projektit.

## EFEKTIVITETI I POLITIKAVE, MASAVE DHE AKTIVITETEVE GJATË NDARRJES SË MARRËVESHJEVE PËR PROKURIME PUBLIKE NË NIVEL TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE TË QYTETIT SHKUP

Në kuadër të aktiviteteve të përcaktuara me tvining marrëveshjen ndërmjet Entit Shtetëror për Revizion dhe institucioneve të larta të revizionit të Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Kroacisë është kryer revizion me qëllim të jepet përgjigje në pyetjen:

*„Nëse politikat, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente mundësojnë veprim efikas gjatë ndarjes së marrëveshjeve për prokurime publike në ndërmarrjet publike të themeluara nga Qyteti Shkup?"*




Revizioni përfshiu periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2018, ndërsa aktivitetet e revizionit u drejtuan kah hulumtimi i mënyrës së planifikimit të prokurimeve publike, strukturës organizative dhe burimeve njerëzore, mënyrës së ndarjes së marrëveshjeve dhe realizimi i prokurimeve si dhe analiza e sistemit të mbrojtjes juridike dhe janë konstatuar gjendje në fushën e lëndës së revizionit.

Në lidhje me planifikimin e prokurimeve publike, u përcaktua se:

- lanet vjetore të prokurimit publik përmbajnë informacione jorealiste për nevojat, sasitë dhe vlerat e procedurave të parashikuara;
- planet përgatiten në bazë të të ardhurave të planifikuara për vitin aktual, pa një studim të plotë të lëvizjeve të tregut;
- ndryshime të shpeshta dhe shtesa në plane;
- janë realizuar procedura me negociata pa publikimin e shpalljes për shkak të urgjencës në rastin kur të njëjtat kanë mundur të planifikohen në kohë;

- zbatimi i prokurimeve me vlerë të madhe Qyteti Shkup si themelues i ndërmarrjeve publike zakonisht i inicion para realizimit të tyre si dhe prokurimin dhe depozitimin e stoqeve të cilat nuk përdoren.

Kjo që u tha më lartë ka ndikim mbi funksionimin e suksesshëm të ndërmarrjeve publike, realizimin e suksesshëm të veprimtarisë me interes publik dhe ballafaqimin në kohë me problemet e mundshme.

Në lidhje me strukturën organizative, është konstatuar gjendje e numrit të pa plotësuar të vendeve të punës së sistematizuara në njësinë organizative për prokurime publike te ndërmarrjet publike gjë që vështirëson mënyrën e realizimit dhe organizimit të të gjithë punës, gjatë kësaj ekziston nevoja për edukim më të madh të anëtarëve në komisionet për prokurime publike për zbatim të suksesshëm të procedurave për ndarjen e marrëveshjeve për prokurime publike.

Me revizionin në mënyrën e ndarjes së marrëveshjeve për prokurim publik dhe realizmin e tyre është konstatuar:

- çmimi më i ulët si kriteri i vetëm për zgjedhjen e ofertës më të favorshme dhe publikimin e detyrueshëm të vlerës së përllogaritu nuk mundëson konkurrencën dhe përdorimin efikas të mjeteve, veçanërisht në procedurat ku paraqitet një ofertë. Përkatësisht, në vitin 2016 dhe 2017, numri i procedurave në të cilat është paraqitur vetëm një ofertë është 54% nga numri i përgjithshëm i procedurave të zhvilluara, ndërsa numri i tyre në vitin 2018 u ul dhe paraqet 39% të numrit të përgjithshëm të procedurave të kryera;
- pamjaftueshëm përdoret mundësia për zbatimin e prokurimeve grupore ndërmjet ndërmarrjeve publike, si dhe me themeluesin e tyre Qytetin Shkup;
- ekzistojnë kufizime organizative dhe ligjore për dhënien e ndërsjellë të kontratave në mënyrën që do të ishte më e thjeshtë, më efektive dhe më ekonomike për ndërmarrjet publike dhe Qytetin Shkup dhe që do të siguronte respektim të vazhdueshëm të parimeve mbi të cilat bazohet veprimtaria e ndërmarrjeve publike: siguri në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit, disponueshmëri dhe shërbim universal dhe përdorimin racional dhe efikas të mjeteve;
- ekzistenca e pasigurisë tek autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë në lidhje me përcaktimin e saktë dhe provimin e kritereve specifike për përcaktimin e aftësisë për të qenë në përpjesëtim me lëndën e kontratës së prokurimit publik dhe përcaktimin e duhur të specifikimit teknik.

Te procedurat më të rëndësishme individuale ku revizioni konstaton parregullsi janë: punë të paparashikuara dhe plotësuese gjatë realizimit të punëve ndërtimore për Ndërtesën administrative të NP Ujësjellës dhe Kanalizim, prokurimi i pakos së integruar softuerike të ralizuar te katër ndërmarrje publike dhe trajtim mjekësor i qenve endacak.

Në bazë të revizionit të kryer, rezultoi konkluzioni: Politikat, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente për ndarjen e marrëveshjeve për prokurime publike te NP të themeluara nga Qyteti Shkup, japin efekt në lidhje me transparencën gjatë ndarjes së marrëveshjeve, por në pjesën e vendosjes së konkurrencës, trajtimit të barabartë, mos diskriminimit ndërmjet operatorëve ekonomik dhe shfrytëzimit racional dhe efikas të mjeteve, të njëjtat nuk i japin efektet e dëshiruara.

Revizioni dha rekomandime në drejtim të sigurimit të planifikimit në kohë dhe analitik të prokurimeve në funksion të plotësimit të nevojave reale të ndërmarrjeve publike, si dhe tejkalimin e mangësive në zbatimin e procedurave dhe sigurimin e konkurrencës më të madhe dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik, shfrytëzim racional, ekonomik dhe efikas i mjeteve dhe sigurim i vlerës më të mirë për mjetet e investuara.

*Në Mars të vitit 2020, Qeveria e RMV-së i rekomandoi Qytetit Shkup dhe NP të Qytetit Shkup t›i qasen përpilimit të një Plan Veprimi me aktivitete të përcaktuara saktë, afate dhe bartës të implementimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të revizionit shtetëror të autorizuar.*

*Deri te Enti Shtetëror për Revizion një pjesë e Ndërmarrjeve Publike të Qytetit Shkup janë dorëzuar formular RPMN të plotësuar me të cilin njoftojnë për masat e ndërmarra në lidhje me rekomandimet e dhëna në Raportin përfundimtar të revizorit shtetëror të autorizuar.*

# REALIZIMI I MASAVE, AKTIVITETEVE DHE POLITIKAVE PËR SPECIALIZIMIN E PUNËTORËVE SHËNDETËSOR NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE GJATË PERIUDHËS NGA VITI 2015 DERI NË VITIN 2018



Duke pasur parasysh mungesën e specialistëve në shëndetësinë publike dhe rëndësinë e madhe të kësaj çështje për publikun, është kryer revizion i pajtueshmërisë për realizimin e masave, aktiviteteve dhe politikave për specializimin e punëtorëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike gjatë periudhës nga viti 2015 deri në vitin 2018, me qëllim të marrim përgjigje në pyetjen, nëse institucionet e përfshira ndërmarrin aktivitetet e nevojshme që sigurojnë ligjshmëri në planifikimin dhe përgatitjen e Programit për specializime, monitorim të realizimit të aktiviteteve për specializimin e punëtorëve shëndetësor, si dhe pagesa dhe shpërndarja e mjeteve nga kompensimi për specializim. Me revizionin janë përfshirë Ministria e Shëndetësisë, fakultetet mjekësore dhe institucionet shëndetësore publike të cilat kanë kompetencë në këtë proces.

Me revizionin e kryer është përcaktuar:

- ndryshimet e shumta në Ligjin për mbrojtje shëndetësore e kanë bërë më të vështirë zbatimin e tij dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete të mjaftueshme për krijimin e kapaciteteve të duhura institucionale për zbatimin e dispozitave, për çka asnjë nga specializantët e regjistruar në pajtim me Programin për specializim nga viti 2015 nuk ka kaluar provimin për specializant. Gjatë vitit 2019, është bërë ndryshim në Ligj, i cili ofron zgjidhje për tejkalimin e këtyre gjendjeve;
- të dhënat nga regjistri i punëtorëve shëndetësor, të cilin e mban Instituti i Shëndetit Publik, nuk përdoren për analiza afatgjate dhe krijimin e politikave. Nga ana tjetër, të dhënat në regjistrin elektronik të cilin e mban Drejtoria për Shëndetësi Elektronike, janë parciale dhe të paplota dhe nga të njëjtat nuk mund të fitohen të dhëna të sakta për gjendjen dhe ndryshimet në strukturën e kuadrit në institucionet shëndetësore publike. Për shkak të kësaj që u tha më lartë, pamundësohet monitorimi i vazhdueshëm dhe planifikimi i kuadrit;
- përgatitja e Programit për Specializim bazohet në të dhëna dhe analiza të pamjaftueshme dhe koordinim të pamjaftueshëm të institucioneve të përfshira. Prandaj, e njëjta jo tërësisht përkon me nevojat reale të institucioneve shëndetësore publike dhe pjesë e madhe e specializimeve të aprovuara nuk realizohen. Përkatësisht, në çdo konkurs publik vitet e kaluara, janë paraqitur dukshëm më pak kandidatë nga gjithsej vendet e shpallura për specializime. Raporti midis vendeve të shpallura për specializim shtetëror dhe specializantëve të pranuar në periudhën nga viti 2015-2018 është treguar në grafikun më poshtë.



- monitorimi i zbatimit të Programit për Specializim është penguar nga dalja e konsiderueshme e kuadrit nga institucionet e shëndetit publik, duke e bërë të pamundur dhe efektiv planifikimin e personelit të nevojshëm. Në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2018, është regjistruar një dalje prej 10% e numrit të përgjithshëm të mjekëve të punësuar, ndërsa 74% i referohet specialistëve. Dhënia e pëlqimit në mënyrë të pa koordinuar për transferimin e kuadrit shëndetësor, e vështirëson funksionimin e institucioneve të caktuara të shëndetit publik dhe rezulton me shpërndarjen të pa barabartë të shërbimeve shëndetësore, aq më tepër që 25% e numrit të përgjithshëm të specialistëve janë të moshës mbi 69 vjeç;
- aktivitetet e ndërmarra nuk janë të mjaftueshme për të monitoruar specializimet dhe nuk ka siguri specializantët i kalojnë të gjitha procedurat e parashikuara brenda secilës pjesë të praktikës, duke pasur parasysh që formularët për evidentim nuk plotësohen dhe aprovohen;
- pagesa e kompensimeve për specializim nga institucionet e shëndetit publik nuk bëhet në kohë. Gjithashtu, paraqitja dhe përpunimi i formularëve për evidencën e stazhit të specializimit kryhet me vonesë që shkakton monitorim të vështirë dhe shpërndarjen jo në kohë të kompensimit për mentorë, arsimtarë dhe institucionet e shëndetit publik, ku zhvillohen turnet. Si rezultat, në librat amë të Fakultetit të Mjekësisë në Shkup për vitin 2019 janë paraqitur detyrime për pagimin e kompensimit të specializimeve për mentorët, arsimtarët dhe institucionet e shëndetit publik për turne të kryera në shumën totale prej 212.682 mijë denarë, nga të cilat 159.029 mijë denarë është gjendje e transferuar nga viti 2018.

Për më tepër, pas kryerjes së revizionit, Fakulteti i Mjekësisë, Shkupi ka njoftuar Entin Shtetëror për Revizion për veprim, me qëllim të tejkalimit të gjendjeve të përcaktuara dhe përfshirë datën 11.03.2020, detyrimet për pagimin e kompensimit për specializime janë zvogëluar për 73.211 mijë.

Për tejkalimin e gjendjeve të përcaktuara janë dhënë rekomandime tek institucionet e involvuara për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve përkatëse të cilat janë të drejtim të sigurimit të shpërndarjes së balancuar të specialistëve në institucionet e shëndetit publik në territorin e gjithë shtetit.

## AVOKATURA E SHTETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Funksionin e Avokaturës së Shtetit e kryen avokati i shtetit si dhe avokatët e shtetit, të cilët gjatë kryerjes së funksionit të tyre janë të pavarur dhe për punën e tyre përgjigjen para Qeverisë së RMV-së dhe para avokatit shtetëror.

Detyra kryesore e Avokaturës së Shtetit është mbrojtja e të drejtave pronësore dhe interesave të RVM-së, para gjykatave dhe organeve të tjera në vend dhe jashtë saj.

Revizioni i kryer i pajtueshmërisë së kapaciteteve institucionale të Avokatisë Shtetërore të RMV-së, për periudhën nga viti 2016 deri më 30.10.2019, me qëllim të japë përgjigje në pyetjen nëse kapacitetet financiare, kadrovike, hapësinore dhe materiale të Avokatisë Shtetërore janë të mjaftueshme për kryerjen e papenguar të kompetencave të saj.



Sa i përket kornizës ligjore që rregullon funksionin e avokatisë shtetërore dhe dokumentet strategjike që lidhen me sistemin gjyqësor në RMV-së, është konstatuar rregullimi i pamjaftueshëm i kompetencave të avokatisë shtetërore në lidhje me përfaqësimin e organeve shtetërore para gjykatave dhe organeve të tjera në vend dhe jashtë saj, mungesë e aktit në të cilin do të rregullohet pjesëmarrja e secilit prej kritereve të parashikuara në përcaktimin e numrit të Avokatëve Shtetërorë

dhe numrin e vendeve të Avokatëve Shtetërorë, nuk është parashikuar detyrim ligjor për vlerësimin e Avokatëve shtetërorë, për shkarkimin e Avokatit shtetëror të RVM-së dhe Avokatëve shtetërorë dhe nuk është rregulluar procedura disiplinore për avokatët shtetërorë.

Ministria e Drejtësisë ka miratuar Strategji për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 në mënyrë që të krijojë një gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efikas, me cilësi dhe transparent, përgjegjës për mbrojtjen e interesit publik, si dhe Strategji për Teknologjinë Informatike dhe të Komunikimit në Gjyqësorin 2019-2024, qëllimi i së cilës është vendosja e një sistemi të centralizuar të të dhënave të sistemit gjyqësor në RMV-së.

Revizioni thekson se nevojitet parashikimi i aktiviteteve për përforcimin dhe avancimin e kapaciteteve institucionale të Avokaturës Shtetërore.

Sa i përket financimit, organizimit, kompetencave, trajnimeve dhe ekipimit kadrovik, kushtet janë si më poshtë:

- Avokatura e Shtetit e kryen punën e saj me fonde nga Buxheti i RMV-së. Në periudhën nga viti 2016-2019, konstatuam trend të zvogëlimit të mjeteve të kërkuara dhe të aprovuara.




- Përqindja më e madhe e mjeteve të aprovuara mbi 70% janë për pagat e punonjësve, ndërsa shpenzimet kapitale janë zvogëluar në minimum, gjë që kufizon mundësitë për përmirësimin e kapaciteteve të përgjithshme institucionale.
- Në periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2018, Avokatura Shtetërore ka procedurat në lidhje me gjithsej 265.946 raste në 18 lloje të fushave. Në fund të 2018, në procedurë janë 186.754 raste, të cilat janë përfunduar nga Avokatura shtetërore, por ato janë ende në proces te autoritetet e tjera kompetente.

Llëvizja e lëndëve në Avokatinë e Shtetit



- Në periudhën, lëndë e revizionit, është kryer vetëm një trajnim për avokatët e shtetit, ndërsa për punonjësit e tjerë është realizuar një përqindje e vogël e trajnimeve;
- Që nga data 30.10.2019, numri i avokatëve shtetërorë të zgjedhur dhe të emëruar është 35, që paraqet 62% e numrit të përgjithshëm të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë së RMV-së, ndërsa numri i përgjithshëm i vendeve të punës të sistematizuara, janë plotësuar vetëm 62%, me çka imponohet konkluzioni për nevojën e përforcimit kadrovik të resurseve njerëzore.

Me analizën e kapaciteteve hapësinore, kushteve dhe pajisjeve materiale dhe teknike, revizioni përcaktoi gjendjet si më poshtë:

- Avokatura e shtetit kompetencën e saj e kryen në pesëmbëdhjetë zyra rajonale të avokaturës shtetërore, prej të cilave vetëm për katër Qeveria e RMV-së, ka ndarë hapësira për përdorim, ndërsa pjesa tjetër janë të vendosura dhe përdorin lokale në institucione të tjera shtetërore.
- Kushtet materiale - teknike dhe pajisjet janë të vjetruara dhe të dëmtuara. Avokatura e shtetit nuk ka sistem kompjuterik të automatizuar për administrimin e lëndëve që trajton, dhe për këtë shkak regjistrimi dhe shpërndarja e lëndëve ende bëhet me dorë, në pajtim me Programin Vjetor të Punës. Në buxhetin e Avokaturës Shtetërore nuk janë miratuar mjete për prokurim të mjeteve të përhershme për punë.

Sa i përket bashkëpunimit me organe dhe organizata të tjera, është konstatuar nevoja për përforcimin e tij në drejtim të shkëmbimit të informacioneve dhe të dhënave. Avokatia Shtetërore nuk ka vendosur bashkëpunim ndërkombëtar me avokati shtetërore të vendeve të tjera, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, praktika mirë të vendosura dhe zbatimin e tyre në kryerjen e kompetencave të veta.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, janë dhënë rekomandime të cilat janë në funksion të përforcimit, avancimit dhe vendosjes së kapaciteteve institucionale të Avokaturës Shtetërore të RMV-së, për realizimin e kompetencave të tij.

## KAPACITETET INSTITUCIONALE TË PROKURORIVE PUBLIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR REALIZIMIN E KOMPETENCAVE

Roli i prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është realizimi profesional, i drejtë dhe i ndershëm, i paanshëm dhe transparent i vlerave themelore të RMV-së, me zbatimin konsekuent të normave më të larta nacionale dhe standardeve ndërkombëtare gjatë ndjekjes së kryerësve të veprave penale dhe të veprave të tjera të ndëshkueshme me ligj.



Revizioni i kryer i pajtueshmërisë me temë «Kapacitetet institucionale të prokurorive publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e kompetencave», me të cilën e përfshimë periudhën nga viti 2016 - 2018, në institucionet të cilat janë përfshirë në proceset e punës dhe aktivitetet në lidhje me kapacitetet institucionale të prokurorive publike.

Parakusht i rëndësishëm për sigurimin e sistemit publik të prokurorisë ligjore, të pavarur dhe objektive në shtet është ekzistimi i kapaciteteve përkatëse dhe të mjaftueshme institucionale.

Për kornizën ligjore dhe dokumentet strategjike të vendosur, është konstatuar se nuk ka asnjë detyrim ligjor të përcaktuar, për miratimin e aktit për përcaktimin e standardeve minimale për mjete materiale dhe teknike, pajisje dhe akomodim hapësinor të prokurorive publike, nuk është përcaktuar metodologjia për përcaktimin e numrit të kërkuar të prokurorëve publik dhe për numrin e të punësuarve në shërbimet e prokurorive publike, as akt për funksionimin e brendshëm të prokurorive publike, ndërsa zgjedhja e ekspertëve ligjorë kryhet pa kritere të përcaktuara për zgjedhjen e tyre.

Me miratimin e Ligjit të ri për Prokurorinë Publike, në shkurt të vitit 2020, disa prej gjendjeve të konstatuara për periudhën 2016-2018 janë tejkaluar, përkatësisht ruajtja e bazës së vetme metodologjike dhe teknologjike të sistemit informativ të prokurorive publike, sigurimin e kushteve hapësinore dhe kushte të tjera të punës si dhe kryerja e mbikëqyrjes mbi operacionet administrative të Prokurorisë Publike, nuk janë përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë. Me zgjidhjen e re ligjore është bërë harmonizim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale në pjesën e të drejtave, obligimeve dhe kompetencave të prokurorit publik, është parashikuar obligim ligjor për shpërndarjen elektronike të lëndëve, është rregulluar pjesa e vlerësimit të punës së prokurorëve publik nëpërmjet përkufizimit përfundimtar të kritereve cilësore dhe sasiore për vlerësimin e tyre.

Ne lidhje me financimin, organizimin, kompetencat, ekipimin kadrovik dhe trajnimin e prokurorive publike të RMV-së, është konstatuar se është çështje e përkufizimit të kornizës ligjore të mjeteve të cilat duhet të akordohen nga Buxheti i RMV-së, për financimin e prokurorive publike në RMV është rregulluar me miratimin e Ligjit të ri për prokurorinë publike, me të cilin rregullohet se në bazë të politikës fiskale dhe kategorive kryesore për të ardhurat dhe shpenzimet e vlerësuara, lartësia do të jetë të paktën 0,4% nga Buxheti i RMV-së për vitin rrjedhës. Shuma e mjeteve që ndahen nga Buxheti i RMV-së për nevojat e punës së prokurorive publike, në periudhën nga viti 2016-2018 janë më pak se nevojat e parashikuara.

Nuk ka ndarje të saktë të përgjegjësive brenda sistemit të menaxhimit midis Prokurorisë Publike të RMV-së dhe Këshillit të Prokurorëve Publik të RMV-së. Përkatësisht, Këshilli duhet të ketë rol parësor në zhvillimin e politikave në fushën e menaxhimit institucional dhe menaxhimit në prokuroritë publike, ndërsa Prokuroria Publike e RMV-së në zhvillimin e politikave që lidhen me zbatimin e të drejtës penale dhe procedurës nga prokuroritë publike.

Qeveria e RMV-së nuk ka miratuar program për ndërtimin, rikonstruktimin, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjen e prokurorive publike, gjithashtu një numër i madh i prokurorive publike funksionojnë në ambientet e gjykatave themelore dhe të apelit. Një pjesë e prokurorive publike duhet të sigurojnë pajisjet kompjuterike të re, pajisje për audio regjistrim dhe video mbikëqyrje dhe më tej të sigurojnë dhe mirëmbajë burimet e nevojshme për zhvillimin e sistemit të TI të prokurorisë publike në përputhje me teknologjitë dhe standardet e reja.

Me revizionin është konstatuar se numër i pamjaftueshëm i prokurorive publike në njësitë e caktuara të prokurorisë publike, edhe pse në pajtim me Vendimet e Këshillit të Prokurorëve Publik për përcaktimin e numrit të prokurorëve juridik të plotësuar është 80%. Sa i përket kategorisë së nëpunësve në prokuroritë publike, përqindja e plotësimit të vendeve vakante të punës është e ulët dhe është 33%. Gjithashtu është konstatuar se për shtesat e pa paguara të pagës së prokurorëve publik janë ngritur procedura gjyqësore kundër prokurorisë publike të RMV-së, që ka shkaktuar shpenzime plotësuese mbi mjetet buxhetore.

Detyrimet për veprimet e ndërmarra për të mbuluar shpenzimet e bëra në procedurën penale nuk paguhen me kohë, për shkak të mjeteve të pamjaftueshme të parashikuara për këtë qëllim.

Kryerja me kohë dhe cilësore e kompetencave të prokurorive publike në RMV në masë të madhe varet edhe nga bashkëpunimi aktiv dhe koordinimi i të gjitha institucioneve të përfshira në funksionimin e sistemit të prokurorisë publike.

Me revizionin është konstatuar se ekziston nevoja për përforcimin dhe avancimin e komunikimit, koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet prokurorive publike në RMV dhe autoriteteve të tjera kompetente. Duhet të ndërmerren aktivitete për vendosjen e kushteve për komunikim elektronik dhe video konferencë, këmbim elektronik të të dhënave me gjykatat si dhe fillimi me punë i qendra hetuese, për shkak të institucionalizimit të bashkëpunimit ndërmjet prokurorive publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për tejkalimin e gjendjeve të përcaktuara, janë dhënë rekomandime që janë në funksion të përmirësimit të mekanizmave rregullues dhe aktiviteteve të autoriteteve kompetente për të përmirësuar kapacitetet institucionale të prokurorive publike në RMV për realizimin e kompetencave të tyre.

# KAPACITETET INSTITUCIONALE TË NJËSIVE SHFRYTËZUESE TË PUSHTETIT GJYQËSOR PËR REALIZIMIN E KOMPETENCAVE

Pushteti gjyqësor, së bashku me pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, janë pjesë e vlerave themelore të rendit kushtetues të vendit. Në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, gjykatat si organe të pavarura dhe autonome të cilat ushtrojnë pushtetin gjyqësor, duhet të garantojnë zbatimin e paanshëm të ligjit, mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duke siguruar barazi, mos diskriminim mbi të gjitha bazat dhe sigurimin e sigurisë juridike bazuar në sundimin e ligjit.

Baza për sigurimin e pavarësisë dhe mëvetësimit të pushtetit gjyqësor është ekzistimi i kapaciteteve përkatëse dhe të mjaftueshme institucionale, ndër të cilat kornizë juridike qartësisht të përcaktuar dhe qëllime strategjike, strukturë organizative përkatëse dhe kompetenca të institucioneve të caktuara në sistem, qëndrueshmëri financiare, ekipim i kuadrit profesional kapacitete hapësinore, si dhe bashkëpunim i ndërsjellë i të gjithë aktorëve të pushtetit gjyqësor.




Është kryer revizion i pajtueshmërisë së kapaciteteve institucionale të njësive shfrytëzuese të pushtetit gjyqësor për periudhën nga viti 2016 - 2018, me qëllim të fitohet bindje racionale nëse të njëjtat mundësojnë realizimin e papenguar të kompetencave të tyre.

Ekziston nevoja për avancimin e kornizës juridike dhe dokumenteve strategjike të cilat e rregullojnë pushtetin gjyqësor të RVM-së, në pjesën e:

- miratimit të akteve nënligjore të parashikuara në fushën e caktuar;
- përkufizim i qartë i kompetencave të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Buxhetit Gjyqësor në pjesën e sigurimit të kushteve financiare, hapësinore dhe kushteve të tjera për punë të gjykatave;
- vendosja e kritereve për përcaktimin e numrit të nëpunësve gjyqësorë në gjykata në lidhje me numrin e gjyqtarëve dhe kompetencat e gjykatës, si dhe kriteret për përcaktimin e përbërjes së ekipit të gjyqtarëve;
- përcaktimin e numrit optimal të infomraticientëve për shkak të kryerjes efikase të kompetencave dhe funksionimit të pa penguar të sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndët gjyqësore (ACMIS) me mbështetje të duhur informative;
- realizimi i plotë i qëllimeve të parashikuara në dokumentet strategjike, veçanërisht ekipimin kadrovik dhe teknik të shërbimit gjyqësor, sigurimi i kushteve të përshtatshme hapësinore dhe përmirësimi i kapaciteteve të gjyqësorit dhe përmirësimi i Ligjit për shërbimin gjyqësor.

Sa i përket financimit, kompetencave, strukturës organizative, kuadrit dhe zhvillimit profesional të gjyqësorit, janë identifikuar kushtet e mëposhtme:

- Lartësia e mjeteve nga Buxheti i RMV-së për financimin e gjyqësorit përcaktohet në Ligjin për Buxhetin Gjyqësor si shumë vjetore prej 0,8% e bruto prodhimit vendor. Mjetet e siguruara në shumë absolute rriten, me përjashtim të vitit 2017, por janë në nivel nën përqindjen e përcaktuar me ligj, nën të cilin nivel është edhe shuma e mjeteve të kërkuara;
- edhe pse në vitin 2018 ka një rritje në shumën e aprovuar të mjeteve për shpenzime kapitale në krahasim me vitet e kaluara, shuma ende është dukshëm më e ulët se shuma e kërkuar për prokurim, modernizimin e serverëve dhe pajisjeve të tjera të informatike, të nevojshme për funksionimin e pa penguar të AKMIS sistemit si dhe gjykatave;

Mjetë të kërkuara, të aprovuara dhe të realizuara




- në vitin 2018, detyrimet ndaj furnitorëve në krahasim me vitin 2016 janë ulur përafërsisht për 60%;
- ekziston një përqindje e lartë e vendeve vakante të punës në gjykatat, ku janë plotësuar vetëm 14% e vendeve të punës udhëheqëse të parashikuara, ndërsa në kategoritë të tjera janë plotësuar rreth gjysma ndërsa ekipimin e pamjaftueshëm kadrovik e përcaktuam edhe te shërbimi informatik në gjykatat;
- nuk bëhet vlerësimi i nëpunësve gjyqësor, as nuk realizohet e drejta e avancimit të tyre, për shkak të mos miratimit të akteve nënligjore për rregullimin e të njëjtave;
- 20% e gjykatave kanë miratuar plane vjetore për trajnimin e nëpunësve gjyqësorë, në 39% të gjykatave nuk është realizuar detyrimi për arsimim të detyrueshëm profesional të specialistëve të TI-së, dhe ka raste kur gjyqtarët nuk e kanë përmbushur numrin e detyrueshëm të orëve të trajnimit të vazhdueshëm.

Për të rritur efikasitetin dhe shkëmbimin në kohë të informacionit dhe të dhënave, identifikuam nevojën për të përmirësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave si brenda gjykatave ashtu edhe me institucionet e tjera kompetente edhe atë në pjesën e lidhjes elektronike midis gjykatave për shkëmbim të dokumenteve nga dosjet elektronike të krijuara për lëndët në gjykatat e veçanta si dhe sigurimin e kushteve për funksionimin e ndërlidhjes së vendosur për shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet gjykatave dhe prokurorive të RMV-së, gjë që nuk është realizuar sepse Prokuroria Publike nuk kryen shkëmbim elektronik të të dhënave me gjykatat.

Për tejkalimin e gjendjeve të përcaktuara, janë dhënë rekomandime që janë në funksion të përmirësimit të mekanizmave rregullues dhe aktiviteteve të autoriteteve kompetente për të përmirësuar kapacitetin institucional të gjyqësorit në vend.

# EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE QË I KA NDËRMARRË MINISTRIA PËR SHOQËRI INFORMATIKE DHE ADMINISTRATË PËR IMPLEMENTIMIN E PLOTË TË SISTEMIT INFORMATIV PËR MENAXHIM ME BURIMET NJERËZORE NË INSTITUCIONET E SEKTORIT PUBLIK

Si pjesë e aktiviteteve të përcaktuara me tvining marrëveshjen ndërmjet Entit Shtetëror për Revizion dhe Institucioneve të larta të Revizionit të Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Kroacisë, është kryer revizion i sistemit informatik (IT revizion) si revizion i suksesit me qëllim të japë vlerësim për implementimin dhe përdorimin e Sistemit Informativ për Menaxhim me Burimet Njerëzore në Institucionet e Sektorit Publik (SIMBNJ). Revizioni përfshiu periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2018.




Një nga kompetencat e Ministrisë së Shoqërisë së Informatike dhe Administratës (MSHIA), sipas legjislacionit, është krijimi i Regjistrit të Punëtorëve në sektorin publik dhe mbajtja e tij në formë elektronike.

Që nga viti 2016, MSHIA ka implementuar sistemin SIMBNJ, i cili përbëhet nga katër module. Me revizionin kemi konstatuar se shkalla e përdorimit sipas moduleve është si vijon:

- Moduli i evidencës personale nuk përdoret nga të gjitha institucionet megjithëse detyrimit ligjor, dhe të dhënat e regjistruara nuk janë të plota dhe të përditësuara;
- Moduli i llogaritjes së pagave përdoret vetëm në 27 institucione;
- Moduli për raporte përdoret vetëm nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës;
- Moduli për menaxhim të performancës së punëtorëve në sektorin publik nuk përdoret nga asnjë institucion.

Si gjendje të rëndësishme të cilat janë konstatuar gjatë revizionit janë:

- Përdorimi i të gjitha moduleve të sistemit në funksionimin e përditshëm nuk është i detyrueshëm, përveç modulit për evidencë personale dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor që institucionet e sektorit publik të përdorin modulet të tjera;
- Ekzistojnë institucione që nuk regjistrojnë dhe ruajnë të dhënat për burimet njerëzore në sistem, ndërsa të dhënat e evidentuara në sistem janë të pasakta dhe jo të plota. Një pjesë e institucioneve nuk kanë emëruar person përgjegjës për përditësimin e të dhënave në sistem;
- Janë evidentuar 399 përdorues të rinj në sistem, për të cilët nuk është mbajtur asnjë trajnim për përdorimin e sistemit;
- Sistemi nuk jep kontribut të plotë në përgatitjen e raportit vjetor nga Regjistri i të punësuarve në sektorin publik;
- Ekziston mospërputhje dhe diversitet në mënyrën se si përcaktohen dhe llogariten pagat në aktivitetet e sektorit publik. Nuk ekziston bazë e vetme ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e pagave, megjithëse me strategjitë për reformë në administratën publike është planifikuar përcaktimi i një sistemi të unifikuar dhe koherent të pagave për të punësuarit, si parakusht për përdorimin e modulit për paga nga të gjitha institucionet në sektorin publik;
- Regjistrat e ndryshëm shtetërorë përmbajnë të njëjtat të dhëna, të cilat nuk janë të ndërlidhura ndërmjet vete, që krijon mundësinë të dhënat në regjistrat të mos jenë të sakta ose plotësisht të përditësuara;

- Pagat për të punësuarit në sektorit publik u paguhen edhe personave për të cilët nuk ka të dhëna në sistemin informativ për menaxhim me burimet njerëzore në institucionet e sektorit publik, pra procesi i pagimit të pagës nuk konfirmohet / verifikohet me të dhënat nga sistemi.

Qëllimet themelore për të cilat u krijua sistemi nuk janë realizuar në mënyrë efektive. Aktivitetet dhe masat e ndërmarra nga MSHIA, Inspektorati Administrativ Shtetëror dhe institucionet e sektorit publik në fushën e menaxhimit, përdorimit dhe qëndrueshmërisë së sistemit, trajnime të vazhdueshme për përdoruesit e sistemit, menaxhimin e të drejtave të përdoruesve, përdorimin e të gjitha funksionaliteteve të sistemit dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave nuk janë të mjaftueshme për të siguruar të dhëna të plota dhe të përditësuara, veçanërisht një regjistër të saktë për të punësuarit në sektorin publik.

Janë dhënë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit, përdorimit dhe qëndrueshmërisë së sistemit të informimit për menaxhimin me burimet njerëzore në institucionet e sektorit publik, përmirësimin e aftësive të përdoruesve përmes trainimit të vazhdueshëm, menaxhim ne të drejtat e përdoruesve, shfrytëzimi i të gjitha funksioneve të sistemit dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe do të kontribuojnë për të dhëna të plota dhe të përditësuara në sistem, si dhe përmirësimin e menaxhimit me burimet njerëzore.

# NJOFTIM PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE



Enti Shtetëror për Revizion është organ kompetent për monitorimin e financimit të rregullt të partive politike, nëpërmjet sistemit të raportimit financiar, në pajtim me metodologjinë për revizion shtetëror të përcaktuar me Ligjin për revizion shtetëror.

Financimi i punës së partive politike është parakusht për sistemin politik demokratik në vend. Mjetet për funksionimin e tyre të rregullt realizohen nga burime publike të financimit, me mjete të parashikuara në Buxhetin e RMV-së dhe nga burime private të financimit: tarifë anëtarësie, kredi, donacione, dhurata, shtesa, grante, sponsorizime, trashëgimi, shitje e materialit promovues dhe propagandues.

Me Programin vjetor të punës së Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2019 ishin planifikuar dhe kryer revizione të raporteve financiare të katër partive politike: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe Lëvizja BESA, me të cilat përfshimë 60% të burimeve të përgjithshme publike të financimit për partitë politike në vitin 2018.

Revizioni përcaktoi se shuma e mjeteve totale për financimin vjetor të partive politike për vitin 2018 nga Buxheti i RMV-së janë në shumë prej 281.102 mijë denarë, përkatësisht për 162,82% më shumë se në vitin 2017, përkatësisht të njëjtat në vitin 2017 ishin me shumë prej 106.957 mijë denarë. Rritja në fjalë ka të bëjë me ndryshimin e përqindjes së përcaktuar ligjore prej 0,06% në 0,15% të të ardhurave të përgjithshme burimore të Buxhetit të RMV-së. Me analizën e të ardhurave sipas llojeve të burimeve të financimit, u konkludua se një ndryshim i tillë ligjor kishte një ndikim të rëndësishëm në strukturën e të ardhurave në vitin 2018, me çka pjesëmarrja e të ardhurave nga burimet private përkatësisht nga donacione dhe anëtarësim në raport me vitin 2017 është zvogëluar dukshëm. Pjesëmarrja e llojeve të caktuara të të ardhurave sipas viteve dhe sipas partitë politike paraqitet në grafikun vijues.




Me revizionet e kryera janë konstatuar gjendje të cilat sugjerojnë në nevojën për përforcimin e aktiviteteve të personave përgjegjës të partive politike për tejkalimin e tyre, në veçanti në pjesën e sigurimit të dokumentacionit të kompletuar për konfirmimin e vërtetësisë së transaksioneve të evidentuara në kontabilitet, puna e rregullt arkëtare, zbatimi i inventarizimit të plotë dhe tërësor i mjeteve dhe detyrimeve, vendosja e mënyrës së grumbullimit, arkëtimit dhe evidencës së të ardhurave në bazë të anëtarësimit i cili do të mundësojë konfirmimin e tyre të plotë, si dhe evidencë të plotë të pronës me të cilat disponojnë partitë.

# ZGJEDHJET PRESIDENCIALE 2019

Fushata zgjedhore, si prezantim publik i kandidatëve të konfirmuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore, është proces që ka ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e qëndrimit të elektoratit për zgjedhjen e një kandidati të caktuar.

Prandaj, ligjshmëria e burimeve të mjeteve për financimin e fushatës dhe ligjshmëria e mënyrës së shpenzimeve të mjeteve në dispozicion të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore është një parakusht i rëndësishëm për mundësi të barabarta për paraqitjen e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, si dhe një parakusht për kualifikimin e procesit zgjedhor si demokratik.

Gjatë vitit 2019 në RMV, u organizuan dhe u mbajtën Zgjedhjet për President të RMV-së. Në pajtim me Programin Vjetor të Punës për vitin 2019, është kryer revizion i raporteve të përgjithshme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të të gjithë pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019.

Për financimin e fushatës zgjedhore, pjesëmarrësit në zgjedhjet presidenciale shpenzuan gjithsej 321.909 mijë denarë, nga të cilat 68% janë mjete të siguruara nga Buxheti i RMV-së për publikimin e reklamimit të paguar politik.

Shpenzimet për pjesëmarrës në fushatën zgjedhore janë dhënë në grafikun e si më poshtë:




Me revizionin për Zgjedhjet për President të RVM-së është konstatuar se monitorimi i reklamimit të paguar politik nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele është kryer në bazë të të dhënave të paraqitura nga radiodifuzerët, me çka është pamundësuar Agjencia të konfirmojë saktësinë dhe kompletimin e të dhënave të paraqitura në raportet.

Një pjesë e detyrimeve për reklamim të paguar politik në shumë prej 4.741 mijë denarë nuk janë paguar nga KSHZ-ja ndaj radiodifuzerëve dhe internet portaleve, për shkak të dorëzimit jo në kohë të listave të çmimeve, ndërsa te dy pjesëmarrës në raportet e përgjithshme financiare për fushatën zgjedhore, janë paraqitur shpenzimet për detyrimet e paguara për reklamim politik nga KSHZ-ja pas lidhjes së marrëveshjeve për asignacion, si dhe të ardhurat për mjetet e siguruara, por këto transaksione nuk janë kryer përmes llogarisë së transaksionale për fushatën zgjedhore.

## REFERENDUMI NË VITIN 2019

Referendumi është formë e shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendosjen për çështje të caktuara në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për çështje me kompetencë të komunave, qytetit Shkup dhe komunave në Qytetin Shkup, si dhe çështje të tjera me rëndësi lokale.

Kompetenca e Kuvendit për shpalljen e referendumit përcaktohet në Ligjin për Referendum dhe format e tjera të votimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, si dhe në Kushtetutën e RMV-së, ku është rregulluar që Kuvendi vendos për shpalljen e referendumit për çështje të caktuara në kompetencën e tij me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Enti Shtetëror i revizionit ka kryer revizion të raportit të përgjithshëm financiar për të ardhurat dhe shpenzimet, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së «Kuvendit të Republikës së Maqedonisë - Propagandë Publike për referendum, llogari me dedikim 789», që përfshin periudhën nga 07.09.2018 deri më 05.11.2018.

Me revizionin e propagandës publike për referendumin e realizuar, është konstatuar se nuk janë respektuar në tërësi dispozitat e rregullave për veprimin e Trupit Koordinues në lidhje me udhëheqjen e propagandës publike për referendumin, si dhe reterimi ndërmjet vlerës së shërbimeve të kryera për reklamim të paraqitura në faturat dhe vlera e tyre në planet e paraqitura të mediave.

Me analizimin e rregullativës ligjore dhe zbatimin e saj në sistem, është konstatuar se monitorimi nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele është kryer në pjesën e radiodifuzerëve me të cilët Kuvendi ka lidhur marrëveshje. Janë identifikuar dallimet ndërmjet të dhënave nga raportet e Agjencisë për Monitorimin e Raportimit të Radiodifuzerëve gjatë referendumit të vitit 2018 dhe raportet e radiodifuzerëve për shfrytëzimin e hapësirës për reklamim, të Kuvendit.

# BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Enti Shtetëror për Revizion gjatë vitit 2019 ka realizuar bashkëpunim ndërkombëtar të frytshëm, me qëllim avancimin e mëtutjeshëm të nivelit profesional që paraqet një nga përcaktimet strategjike të ESHR-së. Pjesëmarrja në revizione kooperative me institucionet e larta të revizionit nga BE-ja dhe rajonit vazhdoi edhe këtë vit, duke kontribuuar për përforcimin e kapaciteteve profesionale të të punësuarve në Entin Shtetëror për Revizion dhe për cilësinë e revizioneve.

Bazuar në përvojat pozitive nga revizionet e mëparshme kooperative, ESHR në vitin 2019 filloi përgatitjet për pjesëmarrje në dy revizione të reja kooperative në fushën e fuqisë së punës dhe mbeturinave plastike. Përfitimet e këtij lloji të bashkëpunimit janë të shumëfishta, veçanërisht mundësia e ngritjes profesionale të revizorëve përmes veprimtarive kolegiale (peer - to - peer), qasjes fleksibël, përdorimi i përvojave të të tjerëve dhe forcimi i vetëbesimit në aftësitë personale për kryerjen e revizionit të suksesit.

Si pjesë e rrjetit të ILR të vendeve kandidate dhe kandidatëve të mundshëm për pranim në BE dhe Gjykatën Evropiane të Revizorëve, u zhvillua projekti në fushën e revizionit financiar me aspekte të revizionit të pajtueshmërisë, i cili filloi në tetor të vitit 2017 dhe përfundoi në qershor të vitit 2019. Ndihmë profesionale dhe financiare për këtë projekt u sigurua nga ILR të Suedisë, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga Gjykata Evropiane e Revizorëve.

Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të reja në fushën e revizionit shtetëror me IRL të tjera u zhvillua përmes formave standarde të bashkëpunimit dhe në koordinim me INTOSAI dhe EUROSAI. Kontributi i Entit Shtetëror për Revizion për revizion mbi punën e grupeve të punës dhe organeve të këtyre asociacioneve në mënyrë që të promovojë aktivitetet në fushën e mjedisit jetësor, teknologjisë informatike, etikës dhe integritetit në ILR dhe institucionet e administratës publike dhe revizionit të komunave vazhdoi gjatë vitit 2019.

Të punësuarit në Entin Shtetëror për Revizion kanë marrë pjesë në disa ngjarje ndërkombëtare për edukim dhe mbindërtimin e aftësive të tyre në fushat si vijon: bashkëpunimi me parlamentin, revizion i mjedisit jetësor (mbeturinat dhe biodiversiteti), revizion i komunave (funksionet që i ushtrojnë komunat), mbështetja e IT-së dhe revizion mbi sistemet e informimit, promovim i funksionit të revizionit të brendshëm, si dhe të e -trajnimeve (elektronike) për revizionin e suksesit dhe menaxhimin me mbeturinat.

Për më shumë se një dekadë, Enti Shtetëror për Revizion, ka mbajtur pozicionin e një prej institucioneve më me përvojë në rrjetin e ILR të vendeve kandidate dhe kandidatët e mundshëm për pranim në BE dhe në Gjykatën e Revizorëve të BE-së dhe në këtë veti jep kontribut të rëndësishëm në zbatimin e aktiviteteve.

Statusi i kandidatit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pranimin e saj në Bashkimin Evropian, i fituar në fund të vitit 2005, i mundëson Entit Shtetëror për Revizion që rregullisht, në cilësinë e vëzhguesit aktiv, të marrë pjesë në takimet e Komitetit për Kontakt dhe të jetë në hap me zhvillimet më të fundit dhe sfidat me të cilat përballen personat përgjegjës të ILR-ve nga Bashkimi Evropian në kryerjen e funksionit të revizionit.

## Aktivitete në kuadër të EUROSAI, INTOSAI dhe organizata të tjera

Anëtarësimin në Grupet e punës të EUROSAI-t për mjedisin jetësor nga viti 2002 dhe për TI nga viti 2005, Enti Shtetëror për Revizion e mbajti pjesëmarrjen në mënyrë të vazhdueshme dhe aktive në punën e tyre.

Enti Shtetëror për Revizion që nga viti 2011 është anëtare aktive edhe e grupit operativ të EUROSA për revizion dhe etikë, i cili punon në përforcimin e integritetit dhe etikës te institucionet e larta të revizionit dhe institucionet e administratës publike. Në vitin 2017, ESHR iu bashkua familjeve të tre grupeve të tjera të punës, dy prej të cilave janë të EUROSAI: grupi operacional për revizionin e komunave dhe grupi i projektit për rolin e institucioneve të larta të revizionit në përhapjen e kulturës së integritetit. Në kuadër të grupit për revizion të komunave (TFMA) përfaqësuesit e ESHR në cilësinë e liderëve dhanë kontribut në realizimin e aktivitetit - përpilim i pyetësorit dhe Analizës së rezultateve nga anketa e realizuar për financimin e komunave në vendet anëtare të TFMA. Grupi i tretë i punës është për borxhin publik dhe është pjesë e INTOSAI. ESHR dha kontributin e saj në hartimin e Konceptit për përgatitjen e Udhëzimeve të revizion të borxhit publik në pjesën e lidhjes së marrëveshjeve.

Gjatë vitit 2019, delegacione të Entit Shtetëror për Revizion, morën pjesë në disa ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare të nivelit të lartë, ndër të cilat theksojmë: takimi i 3-të i forumit të ILR me model ligjor (Stamboll, Janar 2019); III Konferenca EUROSAI-ASOSAI (Jerusalem, Mars 2019) për të diskutuar çështjet / problemet aktuale globale dhe emergjencat me të cilat përballen shoqëritë e sotme; konferencë në Paris, Mars 2019, për bashkëpunimin me parlamentet në mënyrë që të përmirësohet ndikimi i revizioneve; konferencë ndërkombëtare me temë «Inovacione në revizionet e BE-së dhe forcimi i rolit këshillimor të ILR në dobi të shoqërisë», i organizuar me rastin e Presidencës Rumune me Këshillin e BE-së, Bukuresht maj 2019; konferencë rajonale kushtuar funksionit mbikëqyrës të parlamentit mbi financat publike, Prishtinë maj 2019; takimi i UNDESA-IDI për kontributin e ILR-ve në zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm që synojnë zbatimin e Agjendës 2030, New York korrik 2019; Kongresi XXIII i INTOSAI-t kushtuar dy temave të rëndësishme: IT në zhvillimin e administratës publike dhe rolin i ILR-së në arritjen e prioriteteve dhe qëllimeve kombëtare, Moskë, shtator 2019.

Në kuadër të programit të Bankës Botërore për zhvillimin e kornizës së raportimit financiar në sektorin publik në Ballkanin Perëndimor, dy përfaqësues të ESHR morën pjesë në punëtorinë mbi rregullat fiskale dhe këshillat fiskale në Vjenë.




## Rrjeti i ILR-së i vendeve kandidate dhe kandidatët e mundshëm për aderim në BE dhe Gjykata Evropiane e Revizorëve

Aktivitetet e rrjetit, të cilat përbëjnë ILR-të të Turqisë, R. Maqedonsë së Veriut, Mali të Zi, Serbia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, ESR dhe Kosovës * (si vëzhguese) kanë për qëllim integrimin e plotë të vendeve kandidate në familjen evropiane dhe zhvillohen në koordinim me oficerët për lidhje të ILR-së dhe me mbështetjen e Grupit të punës për aktivitete të përbashkëta për revizion, të formuara nga Komiteti i kontaktit, ILR-të të tjera anëtare të BE-së dhe SIGMA.

Në takimin vjetor të oficerëve për lidhje të ILR të rrjetit, që u mbajt në Bukuresht në prill të vitit 2019, u shqyrtuan aktivitetet e planit kornizë të aktiviteteve të rrjetit (2018-2020). Në vitin 2019, aktivitetet u përqendruan në bashkëpunimin me parlamentet për të përmirësuar ndikimin e revizionit, mbështetjen e IT-së në proceset e revizionit dhe revizion të softuerit dhe vazhdimin e punëtorive nga seria për avancimin e revizionit financiar.

Në kuadër të aktiviteteve të rrjetit, Enti Shtetëror për Revizion ishte mikpritës i punëtorisë për revizion të IT sistemeve - Revizion digjital i cili u mbajt në Shkup, nëntor të vitit 2019. Punëtoria prezantoi qasjen strategjike ndaj revizionit digjital, zhvillimin e revizionit digjital, duke eksploruar sfidat dhe mënyrat për tejkalimin e tyre, në veçanti, integrimin e rrezikut digjital në revizionin financiar dhe revizionin e suksesit.

E katërta nga seria e seminareve për revizion financiar (nga planifikimi deri tek raportimi i kushteve dhe konstatimeve nga revizioni i kontrollit të cilësisë) kushtuar raportimit, u zhvillua në Stokholm në qershor të vitit 2019.

Në vitin 2019, dy revizorë ishin në stazhim në Gjykatën Evropiane të Revizorëve në Luksemburg për pesë muaj, ndërsa njëri realizoi vizitë studimore në Heidelberg, Gjermani, me temë në lidhje me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ESHR-së në takimin e Komitetit për kontakt, të cilin e përbëjnë krerët e ILR-së të BE-së, së bashku me anëtaret të tjera të rrjetit, mundëson monitorimin e vazhdueshëm të ndodhive më të reja në fushën e sundimit / menaxhimit me financat publike në BE, ndikimi i rregullativave të reja të BE-së mbi punën e ESHR-së dhe ILR-së nacionale, si dhe këmbimin e përvojave në fushën e praktikës së revizionit në drejtim të përmirësimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies në shpenzimin e mjeteve të akorduara nga fondet evropiane. Në takimin e mbajtur në Varshavë në qershor të vitit 2019, temë kryesore e seminarit i organizuar rregullisht në kuadër të takimit ishte: „Evropa digjitale: Sfida dhe mundësi për ILR-të, të vendeve anëtare të BE-së''.

## Bashkëpunim bilateral dhe rajonal

Enti Shtetëror për Revizion shënoi 20 vjetorin e funksionimit të saj me organizimin e tryezës së rrumbullakët me temë «Bashkëpunimi me parlamentin» si pjesë e aktiviteteve të tvining projektit të ESHR-së me ILR-së të Bullgarisë dhe Kroacisë. Përpos përfaqësuesve të këtyre dy ILR, në takimin morën pjesë edhe delegacione të ILR-ve nga Turqia, Rumunia, Polonia, Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova dhe Suedia, ndërsa kryetari i Gjykatës Evropiane të Revizorëve, e përshëndeti ngjarjen nëpërmjet video prezantimit.

Delegacion i nivelit të lartë të Entit Shtetëror për Revizion realizoi vizitë pune në Institucionin Kombëtar të Auditimit të Kosovës në shkurt, gjatë të cilit të dy institucionet nënshkruan memorandum bashkëpunimi.

## Bashkëpunimi me OECD - SIGMA dhe Komisionin Evropian

Bashkëpunimi me SIGMA në vitin 2019 u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të rrjetit.

Me mbështetjen logjistike dhe financiare të SIGMA, u realizuan disa një pjesë e aktiviteteve nga Plani Kornizë i Rrjetit (2018-2020), përfshirë Konferencën në Paris për Rritjen e Ndikimit të Raporteve të Revizioni dhe TI Punëtoria në Shkup.




Gjatë vitit 2019, përfaqësuesit e ESHR-së vendosën bashkëpunim me ekspertë të SIGMA për përgatitjen e Udhëzimeve për kryerjen e revizioni të Buxhetit Qendror të RMV-së. Si pjesë e aktiviteteve, u mbajtën disa takime pune dhe punëtori për prezantimin e përvojave të Mbretërisë së Bashkuar dhe Letonisë në këtë fushë.

Bashkëpunimi me SIGMA dhe Komisionin Evropian, si deri më tani, jep efekte pozitive në procesin e ndërtimit të Entit Shtetëror për Revizion në institucionin kompetent për revizion të jashtëm, në përputhje me kriteret e BE-së dhe standardet ndërkombëtare për revizion shtetëror.

# KOMUNIKIMI, TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E ESHR-së

Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Entit Shtetëror për Revizion, paraqet një nga qëllimet kryesore strategjike në „Strategjinë për zhvillim të ESHR-së për periudhën 2018-2022".

Gjatë vitit 2019, Enti Shtetëror për Revizion vazhdoi të informojë publikun për punën dhe aktivitetet e ESHR, si dhe rezultatet dhe efektin e arritur nga revizionet e kryera të subjektet e përfshira në Programin Vjetor për Punën e ESHR-së për vitin 2019. Vend kryesor në informimin e publikut kanë informacionet e përfshira në raportet kryesore të revizionit, të publikuara në ueb faqen e ESHR-së.




Përveç informimit të vazhdueshëm të publikut për përmbajtjen e raporteve të revizionit, ESHR, gjithashtu informoi edhe për të gjitha aktivitetet e tjera të planifikuara, të ndërmarra dhe të realizuara. Në këtë drejtim, publiku u informua për trajnimet dhe punëtoritë e mbajtura për të punësuarit si pjesë e „Planit Vjetor për Zhvillim dhe Trajnim Profesional të Vazhdueshëm për vitin 2019".

Në ueb faqen e Entit Shtetëror për Revizion u ndanë informacione edhe për aktivitetet të cilat u realizuan nëpërmjet takimeve të përfaqësuesve të ESHR-së me përfaqësues dhe delegacione të institucioneve të tjera të larta të revizionit, mori pjesë në takime bilaterale, në grupe të punës në nivel ndërkombëtar, takime, kongrese dhe ngjarje të tjera vendase dhe ndërkombëtare në lidhje me aktivitetet e revizionit. Për këto aktivitete, informacione shtesë janë paraqitur në pjesën për bashkëpunimin ndërkombëtar, nga ky raport.

Interesimi për rezultatet e punës së ESHR-së, nga media dhe gazetarët për vitin 2019 u paraqit përmes informacioneve të publikuara gazetareske, artikujve dhe komenteve, kryesisht të lidhura me gjendjet e konstatuara në raportet përfundimtare të revizionit të Entit Shtetëror për Revizion. Nga mediat e interesuara dhe palë të tjera të interesuara për punën e ESHR-së, gjatë vitit 2019 janë dorëzuar gjithsej 17 kërkesa, në pajtim me Ligjin për qasje të lirë drejt informacioneve me karakter publik, për të cilat u dhanë përgjigje në afatet e përcaktuara me ligj.

Informimi në kohë dhe transparent i mediave është praktikë shumëvjeçare e ESHR-së, e rregulluar me procedura të brendshme. Në këtë drejtim, pas ardhjes së RSHK të ri, kjo praktikë u zgjerua edhe tek palët e tjera të interesuara për raportet e revizionit, kështu që meiling lista u përditësua dhe plotësua me komitentë të rinj nga përbërja siç janë: agjenci të gazetarëve / organizata, TV dhe radio media, gazeta ditore dhe javore, internet portale, gazetarë hulumtues. Theks i veçantë i është kushtuar organizatave të shoqërisë civile që trajtojnë çështje të llojeve të ndryshme (financa, arsim, kulturë, pushtet lokal, urbanizëm dhe ndërtimtari, etj.).

Kështu, duke filluar nga dhjetori i vitit 2019, ESHR-ja informoi drejtpërdrejt 160 palët e interesuara për publikimin e raporteve të revizionit. Për më tepër, ESHR-ja vendosi risi me «Abstraktin e Raportit të

Revizionit» i cili përmban informacionet më të rëndësishme që mund të lexohen dhe kuptohen më lehtë në kontekstin e përmbajtjes së raporteve të revizionit. Me vetë publikimin e raportit të ri të revizionit, menjëherë informohen mediat, agjencitë gazetareske, gazetarët e pavarur hulumtues dhe organizatat qytetare, në shtesë me linkun drejt raportit në webfaqen e ESHR-së dhe apstraktit të raportit.

Me këtë strategji të re të ESHR-së, raporti i publikuar i revizionit të njëjtën ditë i përcillet mediave dhe palëve të tjera të interesuara, në mënyrë që të mund të merret një pamje e plotë e gjendjeve të përcaktuara nga revizioni i kryer te një subjekt i caktuar, i cili ka qenë lëndë e revizionit, si dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve publike të tatimpaguesve.

Pikërisht komunikimi dhe mënyra se si do të zhvillohet me mediat, publiku i përgjithshëm dhe organizatat e shoqërisë civile është paraqitu dhe përpunuar në detaje në detaje në Strategjinë e miratuar të komunikimit të ESHR-së (2020 - 2023), ku proceset e komunikimit me secilin grup të synuar zhvillohen veçmas.

Kjo mënyrë e praktikës së sapokrijuar të përcjelljes së informacionit për raportet përfundimtare të revizionit, të publikuara në faqen e internetit për të gjitha palët e interesuara, tashmë në muajt e parë të vitit 2020 prodhoi rritje të vizitave në faqen e internetit të ri dizajnuar të Entit Shtetëror për Revizion (ri dizajnuar në dhjetor të vitit 2019). Janë regjistruar rreth 4.000 vizita mujore në faqen e ESHR-së, madje 2.000 vizitorë të rinj të cilët për herë të parë kanë hapur faqen e internetit, me rreth 30.000 përmbajtje të shikuara dhe rreth 200.000 raporte të shkarkuara, dokumente, fotografi dhe përmbajtje të tjera të postuara në faqen e Entit Shtetëror për Revizion.

Për të përmbushur kërkesat për transparencë dhe llogaridhënie për punën e ESHR-së, vlen të përmendet se në fund të vitit 2019, Enti Shtetëror për Revizion dhe Fondacioni për Demokraci e Westminster zbatuan fazën e parë të projektit «Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në Maqedoni, përmes zbatimit të përmirësuar të rekomandimeve të Entit Shtetëror për Revizion».

Në kuadër të projektit të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup, u mbajtën disa punëtori me një grup të madh revizorësh të niveleve të ndryshme hierarkike dhe nga sektorë të ndryshëm të ESHR-së.

Bazuar në aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit, u miratua një dokument i ri dhe i përmirësuar me titull «Strategjia e komunikimit e ESHR-së, 2020 - 2023». Dokumenti i përgatitur në mënyrë metodologjike i detekton sfidat dhe rreziqet në praktikën e komunikimit tashmë të zbatuar të institucionit dhe jep rekomandime specifike se si të përmirësohen ato dhe të vendosen mënyra të reja të komunikimit me palët e interesuara.

Si qëllime kryesore dhe primare gjatë implementimit të Strategjisë së komunikimit janë theksuar: roli i ESHR-së si promotor i parimit të transparencës dhe llogaridhënies së mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve publike, përforcimin e bashkëpunimit dhe koordinimin me grupet e interesit, inkurajimi i institucioneve që në kohë, në mënyrë përkatëse dhe të saktë të veprojnë në lidhje me rekomandimet dhe masat e dhëna në raportet përfundimtare të revizionit.

Viti të cilit raportojmë ishte sensitiv për ESHR-në, nga aspekti i informimit të publikut dhe komunikimit me mediat, duke pasur parasysh faktin se Enti Shtetëror për Revizion, deri në fund të vitit 2017, ishte në gjendje të emërimit të revizorit të ri kryesor shtetëror, ndërsa nga data 04.10.2019 edhe me pushimin e funksionit të zëvendës revizorit kryesor shtetëror, për shkak të përfundimit të mandatit, me çka funksionet themelore të institucionit u vunë në pikëpyetje.

Të gjitha këto sfida u kapërcyen në fund të vitit 2019, përkatësisht më datë 12.12.2019, kur me propozimin të Komisionit Parlamentar për Zgjedhje dhe Emërime nga Kuvendi i RMV-së u miratua Vendim me të cilin u zgjodh Revizori Kryesor Shtetëror mr. Maksim Acevski.

Menjëherë pas marrjes së detyrës, Revizori Kryesor Shtetëror, mr. Maksim Acevski, dha intervistën e parë në emisionin Top Tema në Televizionin Telma, pastaj vijuan edhe disa paraqitje dhe intervista të tjera si në kanalin e parë të televizionit kombëtar të RTVM-së, për Agjencinë Informative të Maqedonisë MIA, etj.

Këto paraqitje publike ishin një mundësi e mirë për Revizorin Kryesor Shtetëror, të paraqesë situatën në të cilën gjendjen Enti Shtetëror për Revizion, si Institucion i Lartë i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut për një periudhë dy vjeçare dhe për të paraqitur realisht rezultatet e deritanishme nga puna e ILR-së, por edhe planet e ardhshme dhe qëllimet strategjike për zhvillimin e ESHR, si dhe të paralajmërojë idenë për rritjen e shkallës së transparencës dhe llogaridhënies së ESHR-së si institucion që perceptohet nga publiku si «rojtar i mjeteve publike».

Rritja e komunikimit, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në punën e Entit Shtetëror për Revizion, presim të inkurajojë jo vetëm interesimin më të madh te gazetarët, mediat dhe palët të tjera të interesuara në raportimin profesional dhe objektiv për punën e Entit Shtetëror për Revizion dhe efektet e saj, por edhe përgjegjësi më të madhe dhe vetë-kontroll te subjektet e sektorit publik, shfrytëzues të mjeteve nga tatim paguesit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE

Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror, Enti Shtetëror për Revizion te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afatin e përcaktuar me ligj, dorëzoi për shqyrtim Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2018.

Në seancën e njëqind e nëntë të mbajtur më 30 korrik 2019, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shqyrtoi dhe miratoi Raportin Vjetor për Revizionet e kryera dhe punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2018. Kuvendi miratoi konkluzione në drejtim të mbështetjes së punës së ESHR-së dhe raportet e revizionit, zbatimin e aktiviteteve të tvining projektit, rekomandimet e dhëna dhe kontrolli i shkallës së implementimit të tyre si dhe ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve nga organet kompetente për tejkalimin e dobësive sistemore të përcaktuara në raportet e revizionit.

Bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së, dhe Kuvendit të RMV-së u thellua me realizimin e tvining projektit, në të cilin komponenti 3 e projektit ishte fokusuar në përforcimin e bashkëpunimit ndërmjet Entit Shtetëror për Revizion me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me qëllim të sigurohet shqyrtim i rregullt i raporteve të revizionit nga Kuvendi, ndërsa me këtë edhe përforcimin e rolit të ESHR-së dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe aktivitete për zbatim e rekomandimeve nga revizionet.

Gjatë vitit 2019, dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit, dorëzoi të gjitha raportet përfundimtare të revizionit në Kuvendin e RVM-së.

Bashkëpunimi i Entit Shtetëror për Revizion me autoritetet e tjera kompetente vazhdoi gjatë vitit 2019. Në kuadër të realizimit të Programit Vjetor të Punës së Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2019, deri te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë dorëzuar 3 / tre / raporte përfundimtarë të revizionit, për dy subjekte ky është kryer revizion, nga të cilat për një subjekt është dorëzuar sipas vlerësimit të revizorit shtetëror, ndërsa dy raporte për një subjekt janë dorëzuar me kërkesë të PTHP për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, me kërkesë paraprake nga Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Një raport përfundimtar i revizionit është dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit bazuar në kërkesën e tij paraprake.

Me kërkesë të ESHR-së, me nr. arkivor 18-711 / 1 të datës 26.12.2019, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut me shkresë të arkivuar, të vërtetuar në ESHR me nr. 11-454 / 1, të datës 19.03.2020, dorëzoi informacionin për masat e zbatuara në kompetencën e tij, lidhur me raportet përfundimtare të revizionit, të dorëzuara, në përputhje me Programet Vjetore të Punës së ESHR-së për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Në pajtim me këtë informacion, si dhe njoftimin e parashtruar paraprakisht, në lidhje me gjithsej 44 raporte përfundimtare të revizionit të cilat janë dorëzuar te PP e RMV-së, në pajtim me programet vjetore, 10 raporte përfundimtare të revizionit janë dorëzuar në PTHP për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, ndërsa një raport përfundimtar i revizionit është dorëzuar te Prokuroria Speciale Publike - Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale në Lidhje dhe të cilat Burojnë nga Përmbajtja e Ndjekjes së Paligjshme të Komunikimeve. Për 4 raporte përfundimtare të revizionit është ngritur akt akuzë, ndërsa

20 raporte përfundimtare të revizionit janë në procedurë para hetimore në prokuroritë themelore publike. Lidhur me 3 raportet përfundimtare të revizionit, janë kërkuar informacione/ kontrolle nga Drejtoria e Policisë Financiare. Për 1 raport përfundimtar të revizionit, u miratua një aktgjykim gjyqësor, ndërsa në rrjedhë është një procedurë ankimore. Për 5 raporte përfundimtare të revizionit (për 3 sipas këtij informacioni dhe për 2 sipas raportimit të mëparshëm), u përcaktua se nuk ka asnjë bazë për ndjekje penale.

Enti Shtetëror për Revizion, në mënyrë aktive bashkëpunon me të gjitha organet shtetërore për parandalimin dhe zvogëlimin e korrupsionit, në kuadër të Protokollit për bashkëpunim dhe parandalim dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Enti Shtetëror për Revizion merr pjesë në realizimin e Programit Nacional për Miratimin e të Drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 3.23. Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, Sfera - Politika Kundër Korrupsionit dhe Kapitulli 3.32 Kontrolli Financiar, Sfera- Revizion i Jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe organeve të tjera për parandalimin e korrupsionit.

Enti Shtetëror për Revizion me sukses i realizoi aktivitetet e Plan Veprimit për zbatimin e Programit për reformë të menaxhimit me financat publike për vitin 2019, që kanë të bëjnë me Prioritetin 7. Kontrolli i jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare.

## DOBËSITË SISTEMORE

Ne, të punësuarit në Entin Shtetëror për Revizion, duke i ushtruar kompetencat në pajtim me ligjin dhe me standardet për ILR, në vazhdimësi kryejmë edhe vlerësimin e shkallës së harmonizimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e tyre. Duke vepruar në lidhje me rekomandimet dhe sugjerimet tona, organet kompetente të pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës iu qasën ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore, të prezantuara me detaje në Shtojcën 1.

Njëkohësisht theksojmë se dobësi të caktuara sistemore, nuk janë tejkaluar përkatësisht për të njëjtat duhet të ndërmerren aktivitete në periudhën në vijim, janë prezantuar në Shtojcën 2.

SHTOJCA 1: Aktivitetet e ndërmarra nga pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës për ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore / nënligjore

| Rregullativa | Rekomandim / sugjerim i ESHR-së për dobësitë sistemike | Ndryshimi i kryer / plotësim dhe miratim i ndryshimit të ri |
|---|---|---|
| Ligji për mbrojtje shëndetësore | Në raportin për revizionin e kryer të pajtueshmërisë me temë „Realizimi i masave, aktiviteteve dhe .politikat për specializimin e punonjësve në institucionet e shëndetit publik në periudhën nga viti 2015-2018"konstatohet zbatimi i vështirësuar i ligjit në pjesën e krijimit të kapaciteteve përkatëse institucionale të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të stazhit për specializim dhe mënyrën e kalimit të provimit, për shkak të të cilit asnjë nga specializantët e regjistruar sipas Programit për Specializim nga viti 2015 nuk kaloi provimin për specializim. | Për tejkalimin e këtyre gjendjeve me Ligjin për mbrojtje shëndetësore („Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 275, të datës 27.12.2019) disa dispozita të ligjit janë shfuqizuar, dhe është plotësuar me një dispozitë me të cilën rregullohet me akt nënligjor të përcaktohet mënyra e realizimit të stazhit specialistik dhe mënyra e .kalimit të provimit. |
| Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital (LSDPFK)<br><br>Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (Ligji për SPI)<br><br>Ligji për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm .social | Në raportin e revizionin të kryer të rregullshmërisë së Fondit për SPIRMV-së, është konstatuar mungesa e afatit të përcaktuar me ligj gjatë të cilit Fondi duhet të sigurojë të dhëna për shkarkimin e restrikcioneve të vlefshme dhe të pagesave jo konsistente dhe të kryejë shpërndarjen e të siguruarve dhe transferimin e kontributeve në shtyllën e dytë pensionale, që ka kontribuuar problemi të zvarritet më shumë vite, ndërsa mjetet e paguara në bazë të kontributeve për këta të siguruar të ngelin në llogari të Fondit. | Për të kapërcyer kushtet e përcaktuara në maj të vitit 2018, u krijua .Komisioni për Zbatimin e Reformave në Sistemin Pensional me përfaqësues .nga institucionet e prekura, në bazë të analizave të të cilit dhe Informatës .në fund të vitit 2018, u bënë më tepër ndryshime me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për SPI dhe Ligjin për SDPFK të botuara në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 245/2018), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 247/2018) të cilat .do të zbatohen nga .01.01.2019. |

| | | |
|---|---|---|
| Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë | Në raportin e revizionit të rregullshmërisë së Agjencisë për Punësim të RMV-së janë konstatuar gjendje në pjesën e mënyrës së rregullimit të statusit të të punësuarve në Agjenci me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, përkatësisht me ligjin nuk është bërë kategorizimi dhe nivelimi i vendeve të punës dhe nuk janë përcaktuar pagat e të punësuarve (komponenti bazë dhe i jashtëzakonshëm) si dhe mënyra e përcaktimit të vlerës së pikës. Këto çështje Agjencia i ka rregulluar me miratimin e Akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe me Marrëveshjen Kolektive .në nivel të punëdhënësit.<br><br>Gjithashtu janë konstatuar gjendje me atë që në ligj në mënyrë përkatëse nuk është rregulluar koeficienti për përllogaritjen e pagës së drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë të cilët i emëron Qeveria e RVM-së. | Me ndryshimin dhe .plotësimin e Ligjit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124, të datës 18 qershor 2019) rregullohet statusi i të punësuarve në Agjenci. Për të punësuarit ofrues të shërbimeve publike, personat ndihmës teknik janë përcaktuar kategoritë dhe nivelet e vendeve të punës në vetë ligjin, ndërsa për nëpunësit administrativ kategoritë, nivelet dhe titujt, zbatohet Ligji për nëpunësit administrativ. Çështjet të tjera nga marrëdhënia e punës dhe pagat, rregullohet të zbatohen dispozitat e këtij ligji, Ligji për nëpunësit administrativ, Ligji .për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme nga fusha e marrëdhënieve .të punës.<br><br>Në nenin 91-a rregullohet .lidhja e marrëveshjes menaxheriale ndërmjet drejtorit të emëruar, përkatësisht zëvendësit të drejtorit të Agjencisë dhe Qeverisë së RMV-së. |
| Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë | Në raportin e revizionit të rregullshmërisë së Agjencisë për Punësim është konstatuar gjendja e cila sugjeron se në ligj nuk është rregulluar obligimi i personave të papunësuar të vijnë në .intervistë pune gjatë ndërmjetësimit në procesin e punësimit me punëdhënësin, që kontribuon edhe përskaj angazhimit të agjencisë, numri vogël i personave të punësohen. | Me . Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punësim dhe sigurim në .rast të papunësisë („Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.124 i datës 18 qershor 2019) .në nenin 59-v përcaktohet detyrimi personi nëse dy herë gjatë 2 (dy) .viteve refuzon punësimin përkatës ose të përshtatshëm ose refuzojnë të marrë pjesë ose nuk u paraqitet për intervistë pune në të cilën është udhëzuar nga . Agjencia, të shlyhet nga evidenca e personave të papunësuar. |
| Ligji për prokurime publike | Në raportin e revizionit të suksesit me temë „Efektiviteti i politikave, masave dhe aktiviteteve gjatë ndarjes së marrëveshjeve për prokurime publike në nivel të ndërmarrjeve publike të Qytetit Shkup", vëmendje ju kushtua obligimit të vendosur, me ndryshimet e LPP që ndodhën në janar të vitit 2014, organet kontraktuese në njoftimin për dhënien e kontratës për prokurim publik ta publikojnë shumën e vlerësuar të prokurimit.<br><br>Me dispozitat e LPP, ndarja e marrëveshjeve për prokurime publike bazohet mbi kriteret e çmimit më të ulët. Kriter për dhënien e kontratës për prokurim publik mund të jetë edhe oferta më e favorshme ekonomikisht, e cila në periudhën nga viti 2016-2018, NP nuk e kanë përdorur aspak në procedurat. | Në vitin 2019 u miratua Ligj i ri për prokurime publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/19.) dhe në përputhje me të njëjtin publikimi i shumës së vlerësuar në shpalljen për dhënien e kontratës për prokurim publik është opsionale, përkatësisht i lihet autoriteteve kontraktuese të vendosin vetë nëse do ta publikojnë atë.. Përdorimi i çmimit më të ulët si kriter i vetëm nuk është në përputhje me Direktivat e BE-së, për shkak të të cilit neni 99 i Ligjit, i cili fillon të zbatohet nga prilli i vitit 2019, si kriter për dhënien e kontratës së prokurimit publik, është parashikuar të përdoret oferta ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim kur oferta më e favorshme ekonomikisht, zgjidhet vetëm në bazë të çmimit. |

| | | |
|---|---|---|
| | Me revizionin e Zgjedhjeve lokale të vitit 2017 dhe Zgjedhjeve presidenciale të RMV-së në vitin 2019, konstatuam: | Me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodin Zgjedhor („Gazeta Zyrtare e RMV-së") .nr. 42/2020), janë tejkaluar gjendjet, si vijon: |
| Kodi zgjedhor | ▪ në nenin 71 është dhënë mundësia për transferim të mjeteve nga llogaria për punën e rregullt të partive dhe llogaria dhe mjeteve nga kredi, në llogarinë zgjedhore, pa u saktësuar nëse mjetet e transferuara do të jenë burim i financimit të fushatës zgjedhore ose pjesëmarrësit do të kenë obligim t'i kthejnë mjetet:<br>▪ në nenin 76-d është rregulluar se shpenzimet e fushatës zgjedhore të cilat kanë të bëjnë me reklamimin e paguar politik, janë në barë të Buxhetit të RMV-së ndërsa pagesën do ta kryejë Komisioni Shtetëror Zgjedhor, pa u përcaktuar limiti, përkatësisht korniza e mjeteve financiare nga Buxheti i RMV-së, as mënyra dhe kriteret e shpërndarjes së këtyre mjeteve tek pjesëmarrës të caktuar në fushatën zgjedhore;<br>▪ me ndryshimet dhe plotësimet në Kodin zgjedhor në shkurt të vitit 2019, aktivitetet në lidhje me mbikëqyrjen e internet portaleve shlyhen, pa përcaktimin e institucionit kompetentë për monitorimin dhe mbikëqyrjen e prezantimit mediatik zgjedhor nëpërmjet internet portaleve;<br>▪ në nenin 71 është rregulluar mënyra e hapjes dhe mbylljes së llogarisë transaksionale, obligimi për sigurimin e NVT me shënim „për fushatën zgjedhore, por nuk rregullohet shlyerja e NVT, pas përfundimit të aktiviteteve zgjedhore;<br>▪ pagesa e donacioneve deri në afatin përfundimtar të përcaktuar në raportin financiar nuk mund të realizohet, sepse llogaria për fushatën zgjedhore mund të mbyllet;<br>▪ nevoja për përcaktimin e obligimit për dorëzimin e listës së çmimeve dhe raport për shfrytëzimin e panove reklamuese dhe bilbordeve nga subjektet juridike të cilët ekonomizojnë me panotë dhe bilbordet për reklama, komunat në RMV dhe qyteti Shkup. | ▪ me nenin 20 dhe nenin 34 është bërë harmonizim, (është ndryshuar neni 71, paragrafi 7 dhe neni 83 paragrafi 2) me çka është rregulluar se fushata zgjedhore mund të financohet nga mjetet e llogarisë së rregullt të partisë politike dhe kredive të partisë politike të dedikuara për fushatë zgjedhore;<br>▪ me nenin 31 është bërë ndryshim dhe plotësim i nenit 76-d, dhe është përcaktuar vëllimi i mjeteve financiare për reklamim të paguar politik, të cilat nuk guxojnë të tejkalojnë shumën prej 2 (dy) euro në kundërvlerë të denarit pa TVSH të përllogaritur për votues të regjistruar, si dhe është përcaktuar mënyra e shpërndarjes së tyre në partitë politike;<br>▪ me nenin 27 ndryshon paragrafi 1 i nenit 76-gj, me të cilin si institucion kompetent për monitorimin e prezantimit mediatik zgjedhor, nëpërmjet internet portaleve është përcaktuar Komisioni Shtetëror Zgjedhor;<br>▪ me nenin 20 është bërë ndryshim në nenin 71 paragrafi 12 ku është parashikuar se me mbylljen e llogarisë transaksionale, shlyhet edhe NVA i subjektit të regjistruar para organit kompetent;<br>▪ me nenin 20 është bërë ndryshimi i nenit 71 paragrafi 6, në pajtim me të cilin donacionet mund të paguhen në llogari transaksionale më së voni deri në ditën e mbylljes së saj;<br>▪ me nenin 32 është bërë ndryshimi i nenit 78-a, me të cilin është përcaktuar obligimi për dorëzimin e raportit për panotë dhe bilbordet e përdorura për reklamim vetëm nga subjektet juridike, por jo edhe për komunat në RMV dhe qyteti Shkup. |

| | | |
|---|---|---|
| Ligji për sistemin hekurudhor | Me revizionin e rregullshmërisë te Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për vitin 2018, përcaktuam se për periudhën nga viti 2017 - 2019, Kuvendi i RMV-së, nuk ka miratuar Programin Nacional për Infrastrukturën Hekurudhore, siç është parashikuar me nenin 26 të Ligjit për sistemin hekurudhor, ku duhet të përcaktohet shuma e mjeteve për vite, për financimin e programit. Programi vjetor për vitin 2018 parashikon më pak mjete sesa e drejta e parashikuar ligjore sipas nenit 118 të Ligjit për sistemin hekurudhor. | Në qershor të vitit 2019, nga Kuvendi i RMV-së, është miratuar Programi Nacional për Infrastrukturën Hekurudhore 2019 - 2021, ndërsa për financimin e infrastrukturës hekurudhore për vitin 2019 me programin vjetor janë planifikuar mjete në pajtim me nenin 118 të Ligjit për sistemin hekurudhor, përkatësisht mjete më të larta se 0,3% nga të ardhurat tatimore të planifikuara të Buxhetit Qendror të RMV-së, për vitin rrjedhës. |

SHTOJCA 2: Dobësitë sistemore për të cilat ka nevojë të ndërmerren aktivitete nga organet kompetente, pushteti ekzekutiv / ligjvënës, për tejkalimin e tyre

| Rregullativa | Propozim për ndryshim / miratim |
|---|---|
| Ligji për mbrojtje shëndetësore | Revizioni në vazhdimësi raporton për mungesën e kritereve të shkruara dhe procedurën e përcaktuar për shpërndarjen e mjeteve financiare për programe dhe të njëjtat janë aprovuar në shumën e përgjithshme në nivel të të gjitha institucioneve shëndetësore publike. Për shkak të planifikimit jo të duhur të programeve individuale nga .Ministria e Shëndetësisë dhe mjetet e pamjaftueshme të buxhetit nga ministria kompetente, fondet e përcaktuara në to janë më të vogla se vëllimi i aktiviteteve të përcaktuara dhe .vlera e shërbimeve të kryera nga institucionet shëndetësore publike. Kjo situatë ndikon në solvencën dhe likuiditetin e institucioneve të shëndetit publik dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për përdoruesit e fundit. |
| Ligji për mbrojtje shëndetësore | Revizioni theksoi pavarësinë në pjesën e funksionimit të papenguar të Sistemit nacional për operacionet materialo-financiare dhe të kontabilitetit në institucionet e shëndetit publik i cili u vendos me ndryshimin e këtij Ligji në vitin 2015 dhe është obligim i ministrit të Shëndetësisë. Për shkak të ngecjes në lidhjen e bazave individuale të kontabilitetit në institucionet shëndetësore publike, me këtë sistem si dhe marrëveshja e pasiguruar për mirëmbajtjen e tij, ai nga viti 2018 nuk është në funksion, gjë që e bën të pamundur monitorimin e plotë të pikave kritike të konsumit, kontrollin dhe uljen e shpenzimeve individuale dhe të përgjithshme në institucionet e shëndetit publik, nga ana e ministrisë. |
| Ligji për sigurim shëndetësor | Revizioni në vazhdimësi i thekson mangësitë të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e përcaktimit të kompensimeve kontraktuese të institucioneve shëndetësore publike nga vendosja e konceptit të blerjes së shërbimeve të parashikuar në Ligjin për sigurim shëndetësor. Kemi konstatuar se kriteret e shpërndarjes të përcaktuara me Vendimin e Fondit nuk janë mjaftueshëm konkrete dhe të zbatueshme për përllogaritje dhe në praktikë kompensimi i përcaktuar jo çdo herë është rezultat i përllogaritjeve objektive për vëllimin e shërbimeve të cilat parashihet të kryhen, për çka .nuk është siguruar „blerja e vërtetë e shërbimeve nga institucionet e shëndetit publik". Në praktikë, ekzistojnë institucione shëndetësore publike që kanë fituar statusin të paqëndrueshme sepse niveli i shërbimeve të kryera është më i ulët se niveli i mjeteve të siguruara nga Buxheti i Fondit, dhe nga ana tjetër disa institucione shëndetësore publike vazhdimisht kryejnë shërbime në një shkallë më të madhe se kompensimi i kontraktuar me Fondin, i cili ndikon në likuiditetin dhe aftësinë paguese të të njëjtave. |
| Ligji për kontribute për sigurim të detyrueshëm social | Sistemi i vendosur për përcaktimin, kontrollin dhe arkëtimin e kontributeve nuk bazohet në integrimin dhe integrimin e përditësuar dhe të plotë të të dhënave nga institucionet, që ndikon në tërësinë e të ardhurave, si dhe në likuiditetin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të RMV-së dhe Fondit për Sigurim Shëndetësor të RMV-së, si dhe qëndrueshmërinë e sistemit pensional dhe sistemit për sigurim shëndetësor. Përkatësisht, institucionet në sistemin për sigurim të detyrueshëm social, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të RVM-së; Fondi i Sigurimit Shëndetësor të RMV-së dhe Agjencia e Punësimit kanë baza të veçanta që operojnë paralelisht dhe ndryshojnë nga njëri-tjetri në numër dhe trajtim të ndryshëm të bonove dhe personave të siguruar. Në kushte të këtilla, Drejtoria e të Ardhurave Publike në pajtim me marrëveshjen e lidhur, tek fondet paraqet informacione vetëm për pjesën e papaguar të kontributeve në të cilat nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme për kontributet e përllogaritura dhe të pa paguara dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në pajtim me Ligjin. |
| Ligji për sigurim pensional dhe invalidor | Nevojitet pjesëmarrje më aktive e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të RVM-së, në krijimin e politikave dhe miratimin e zgjidhjeve ligjore në lidhje me sistemin SPI dhe bashkëpunimin me institucionet në sistemin e sigurimeve sociale, si dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për nënshkrimin e marrëveshjes së re me DAP, në të cilën d të përfshihen të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në pajtim me ligjin. |

| | |
|---|---|
| Ligji për nëpunësit administrativ<br>Ligji për të punësuarit në sektorin publik | Me kryerjen e revizionit në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, janë përcaktuar dobësi sistemore në pjesën e përcaktimit të lartësisë dhe mënyrës së përllogaritjes së.pagave të të punësuarve, që nuk kanë statusin e nëpunësit administrativ dhe .këshilltarëve specialë në ministri, gjë që imponon nevojën autoritetet kompetente të ndërmarrin aktivitete për rregullimin plotësues të akteve ligjore në fjalë. |
| Ligji për Buxhetet dhe Udhëzimi për mënyrën e funksionimit të punës së thesarit | Në strukturën e shpenzimeve totale të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për vitin 2018, pjesa më e madhe, përkatësisht 75%, kanë transferimet aktuale në fondet jashtë-buxhetore .(69% për Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të RMV-së dhe 6% për Fondin e Sigurimit Shëndetësor të RMV-së). Lartësinë e këtyre transferimeve e përcaktojnë fondet, ndërsa ministria kryen kontroll formal, duke. mos ndërhyrë në saktësinë dhe realitetin e të dhënave në kërkesat..Situata e deklaruar tregon nevojën për rregullimin plotësues të akteve juridike, me të cilin do të sigurohet transferim i drejtpërdrejtë të mjeteve nga llogaria e Buxhetit Themelor në llogaritë e .fondeve jashtë buxhetore, duke transferuar përgjegjësinë tek shfrytëzuesit / fondet përfundimtare. |
| Ligji për sigurim pensional dhe invalidor | Me revizionin e kryer në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të RMV-së dhe analizën e dispozitave të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, kemi konkluduar se duke filluar nga viti 2004 në nenin 130 paragrafi 6, parashikohet obligimi shfrytëzuesi i pensionit invalidor ose pensionit familjar, në bazë të invaliditetit të paraqitet në ekzaminim kontrollues të detyrueshëm, i cili kryhet në afat prej një dhe më së shumti deri në dy vjet. Deri në përfundimin e aktvendimit, përdoruesit i paguhet pension, ndërsa në rastin kur me ekzaminimin e detyrueshëm kontrollues do të konfirmohet se tek personi nuk ekziston invaliditet, kryhen përllogaritje të dëmit për pagesat e pabazuara të cilat paraqesin shpenzim të konsiderueshëm të mjeteve nga buxheti i Fondit.. Nga ana tjetër, zgjidhjet ligjore nuk rregullojnë pezullimin e punësimit në kushte kur .është dhënë pension i përkohshëm invalidor, për çka të siguruarve të cilëve u revokohet pensionimi invalidor ngelin të pa mbrojtur në pjesën e të drejtave dhe obligimeve nga marrëdhënia e punës. Për tejkalimin e këtyre gjendjeve, Fondi disa herë ka parashtruar iniciativë deri te ministria përkatëse për ndryshimin e këtij Ligji, por deri në ditën e revizionit ndryshimet janë bërë. |
| Ligji për sigurim pensional dhe invalidor | Dispozitat e Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor për sa i përket përcaktimit të shumave për pagesën për pensionet më të ulëta dhe më të larta, parashikojnë pagesa të pensioneve në tre grupe që ndryshojnë në varësi të kohës kur është ushtruar e drejta për shkak të zgjidhjeve ligjore që ishin të vlefshme në atë kohë, si dhe kohëzgjatjes së stazhit të moshës. Për më tepër, pensionet më të larta, duke filluar nga viti 2015, çdo vit përcaktohen në shuma të ndryshme. Prandaj, në dhjetor të vitit 2018, në emër të pensioneve më të ulëta, në mënyrë rrjedhëse paguhen nëntë shuma të ndryshme, ndërsa në emër të shumës më të lartë janë paguar gjashtë shuma të ndryshme të pensioneve. Zgjidhja e këtillë ligjore ndikon, përdoruesit e të drejtave të njëjta të vendosen në pozicion të pabarabartë dhe vë në pikëpyetje respektimin e parimit .të drejtësisë sociale të parashikuar në nenin 3 të këtij Ligji, mbi të cilin bazohet realizimi i të drejtave nga shtylla e parë pensionale. Revizioni rekomandon që të ndërmerren aktivitete për rishikimin e zgjidhjeve ligjore dhe barazimin e shumave për pagesën e pensioneve më të ulëta, si dhe shumat për pensionet më të larta në .funksion të sigurimit të respektimit të parimit të drejtësisë sociale parashikuar me nenin 35 të Kushtetutës së RMV-së. |
| Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë | Revizioni i autorizuar shtetëror raporton se me Ligjin në mënyrë të pamjaftueshme dhe në veçanti nuk është rregulluar pjesa e miratimit të Planit Operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, institucion kompetent dhe periudha për miratimin e tij, me cilin akt dhe cila është procedura e implementimit, monitorimit dhe vlerësimi i efekteve të politikave aktive për punësim. Revizioni është i mendimit se duhet me ligj, në veçanti të rregullohet pjesa e programeve aktive dhe masa për punësim, që është me rëndësi të madhe për rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë në RMV dhe do të japë kontribut drejt rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit ndaj zbatimit të të njëjtave dhe ndaj punës së Agjencisë për Punësim të RVM-së. Gjatë hartimit të ligjit duhet i njëjti të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane dhe të drejtën e zbatueshme të BE-së. |

| | |
|---|---|
| Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë | Me revizionin e kryer të Bankës Popullore të RMV-së, konstatuam nevojën për harmonizim të nenit 67 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë me nenet 22, 30, 31 dhe 32 të Ligjit për Revizion shtetëror, në fushëveprimin e revizionit dhe dorëzimin e raporteve përfundimtare të revizorit të autorizuar shtetëror. |
| Ligji për Drejtorinë e të Ardhurave Publike | Me revizionin e kryer të Buxhetit themelor të RVM-së, konstatuam se për detyrimet dhe obligimet në bazë të TVSH-së, së pa arkëtuar, tatimit mbi fitimin dhe tatimit personal (tatimit mbi të ardhurat personale) nga subjekte juridike dhe fizike, për detyrimet për akcizë dhe detyrimet doganore, të cilat janë në kompetence të administrimit të Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë Doganore, si dhe për obligimet për rimbursimin e tyre, nuk është përcaktuar obligim ligjor për paraqitjen e tyre në raportet financiare të këtyre organeve ose në Buxhetin themelor të RMV-së. |
| Ligji për Drejtorinë Doganore | Duhet të merren masa dhe aktivitete për përcaktimin e mënyrës së evidentimit dhe paraqitjes së tyre në raportet financiare. |
| Kodi zgjedhor | Me revizionin e Zgjedhjeve Presidenciale në vitin 2019, kemi konstatuar se ekziston nevoja për të harmonizuar dhe finalizuar Kodin Zgjedhor, si më poshtë:<br>▪ mënyra e trajtimit në rastet kur Raporti i përgjithshëm financiar tregon detyrime të papaguara, përkatësisht paraqitet shumë më e lartë e shpenzimeve sesa të ardhurave;<br>▪ mënyra e veprimit në rastet kur Raporti i përgjithshëm financiar tregon tepricë të mjeteve të grumbulluara, kur si pjesëmarrës në fushatën zgjedhore paraqitet parti politike ose koalicion;<br>▪ përcaktimin i organit kompetent për monitorimin dhe raportimin mbi prezantimin mediatik zgjedhor në mediat elektronike - internet portalet;<br>▪ rishqyrtimi i afatit përfundimtar për pagimin e donacioneve për financimin e fushatës zgjedhore, përkatësisht mundësi për pagesën e donacioneve edhe pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të fushatës zgjedhore;<br>▪ mënyra në të cilën donatorët e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore do të vërtetojnë se nuk janë persona të lidhur me radiodifuzerët, mediat e shtypura dhe mediat elektronike - internet portalet;<br>▪ përcaktimi i obligimit për të gjitha subjektet të cilat ekonomizojnë me panotë dhe bilbordet reklamuese të paraqesin listën e çmimeve deri te institucionet kompetente për kontroll dhe revizion të procesit zgjedhor, ndërsa për komunat dhe qytetin Shkup edhe obligimi për dorëzimin e raporteve për përdorimin e panove dhe bilbordeve për reklamim dhe mjetet të cilat janë paguar ose janë detyrim mbi këtë bazë dhe<br>▪ me shlyerjen e nenit 86, i cili rregullonte të drejtat e kompensimit për pagesa pas votës së fituar, nga Buxheti i RVM-së nenet 87 dhe 88 paragrafi 3 që kanë të bëjnë me kompensimin e fushatës zgjedhore, si dhe dispozitat e nenit 177-a paragrafi 4 dhe 5 si disa nga dënimet dhe dispozitat kundërvajtëse nuk kanë asnjë bazë ligjore.<br>Gjithashtu, Ministria e Financave duhet të përcaktojë akt për veprimin ndaj tatimimit me TVSH të qarkullimit të fletëve votuese dhe materialit zgjedhor të nevojshëm për realizimin e zgjedhjeve si dhe doganimin e tyre. |
| Ligji për financimin e partive politike | Me revizionet e kryera në lidhje me punën e partive politike për vitin 2018, konstatuam nevojën për rregullim plotësues të rregullativës ligjore dhe nënligjore në lidhje me mënyrën e pagesës dhe evidencës së anëtarësimit si burim financimi, për shkak të veprimit të barabartë te të gjitha partitë politike. |
| Ligji për referendum dhe forma të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve | Me revizionin e kryer të Kuvendit të RM-së, Propaganda publike për referendum, konstatuam nevojën për rregullimin plotësues të Ligjit:<br>▪ caktimi i afatit kohor për fillimin e propagandës publike për referendum;<br>▪ rregullimi i mënyrës së financimit të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve për propagandë publike nga buxheti i shtetit, si dhe shumën e tyre. |

| | |
|---|---|
| Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar | Me revizionin e kryer të Zgjedhjeve presidenciale të vitit 2019, konstatuam nevojën për harmonizim të ligjit me Kodin zgjedhor, ku në nenin 11 është parashikuar se për veprimet, aktet, parashtresat dhe shkresat të tjera në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve, prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të nevojshme për procesin zgjedhor, nuk paguhet doganë dhe tatim, për shkak së në ligjin aktual nuk është rregulluar lirimi tatimor për TVSH në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve, parashikuar në Kodin zgjedhor. |
| Ligji për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore | Me revizionin e kryer në Ministrinë e Financave, konstatuam se gjatë formimit dhe themelimit të organeve dhe institucioneve shtetërore me ligj të veçantë, jo çdo herë bëhet ndryshimi i ligjit. Përkatësisht, duhet të behet ndryshim i nenit 19 të ligjit në fjalë, në të cilin janë përmendur institucionet si organe në përbërje të ministrisë pa cilësinë e subjektit juridik, edhe pse me ligjet e veçanta të njëjtat themelohen si organe në përbërje të ministrisë në vetinë e subjektit juridik ose formohen si organe të pavarura të administratës shtetërore. |
| Ligji për të punësuarit në sektorin publik | Me revizionin e Ministrisë së Financave, konstatuam nevojën për rregullimin e lartësisë dhe mënyrën e llogaritjes së pagës së këshilltarëve specialë në institucione të caktuara, përfshirë ministrinë. |
